A stylized illustration of a woman in a traditional, patterned dress, possibly a sari or a similar garment, standing and holding a large, rectangular tray. The tray contains a label with the text "ASDRENI", "VEPRA", "TË", and "ZGJEDHURA". The background features a red and black textured pattern, resembling a cage or a stylized landscape.

ASDRENI
VEPRA
TË
ZGJEDHURA

891.983-1

D.
UNIVERSITETI SHTETEROR I TIRANËS
INSTITUTI I HISTORISË DHE I GJUHESISE

~~23980~~ 3289

~~8 A-1~~
~~Dr. 8~~

BIBLIOTEKA E SHTETIT
GJIPRAKASTER

ASDRENI

ALEKSANDER STAVRE DRENOVA


VEPRA TË ZGJEDHURA

Mbledhur e redaktuar nga
DHIMITËR FULLANI

(13)

N. SH. BOTIMEVE «NAIM FRASHËRI».
TIRANË, 1958

БУДІВЛЯ І МОНУМЕНТИ СТАРИХІ
І НІВІСІДНІ ВІД ЗАЛОГИ І АУТОРІ



Asdreni (1943)

ALEKSANDËR STAVRE DRENOVA

A S D R E N

(1872 — 1947)

Asdreni është një nga figurat më të njohura të Rilindjes sonë.

Kënga e tij lindi në çastet më të vështira të luftës për një jetë kombëtare të pamvarur dhe vajti e u ngul në zemër të popullit, për ta gjallëruar dhe më shumë lëvizjen tonë të çlirimt kombëtar. Vepra e tij qe një kontribut me vlerë për pasurimin e lartësimin e letërsisë e të gjuhës sonë letrare fill pas Naimit e Samiut.

Lindi më 11 prill 1872 në një familje të vobegët të Drenovës së Korçës. Nëna e la të vogël dhe babai i vdiq porsa kishte mbaruar shkollën filllore greke të fshatit. Në gjimnazin grek të Korçës, të cilin s'e kreua dot, veç greqishtes, kishte filluar të mësojë dhe frengjisht. Mbetur pa mbështetje, Aleksandri që në moshën 17 vjeçare emigroi në Rumani, ku kishin vajtur edhe dy vëllezër të tij më të mëdhej. I rrëmbyer nga atmosfera patriotike e kolonisë shqiptare në Bulquresht, ku shoqëritë «Dituria» dhe «Drita» ishin në kulmin e veprimitarisë së tyre propagandistike e organizative për forcimin e lëvizjes sonë kulturale e patriotike, Asdreni i hyri leximit të librave shqipe që botoheshin aty. Më 1892 u bë anëtar i shoqërisë «Drita», ku filloj të bashkëpunojë me N. Naçan në gazeten «Shqiptari». Nga mesi i dhjetëvjetorit të fundit të shekullit XIX Asdreni studionte në shkollën Normale, që hapi N. Naçan në Bulquresht dhe ndiqte mësimet në një kurs administrative, të cilin e kreua.

Qëllimi i tij ishte të dilte nga gjendja e vështirë ekonomike dhe të zgjeronte kulturën e tij, për t'u bërë sa më i aftë për lëvizjen patriotike. Nga që s'deshi të marrë nënshtetësinë rumune, nuk punoi dot shumë kohë si nëpunës. Nuk qe edhe i zoti për tregëti, prandaj s'u bë kurrrë me para. Edhe kur hapi ndonjë dyqan të vogël, falimentoi me një herë. Mbeti tërë jetën një begar i varfër, por i respektuar e i dashur nga tërë shqiptarët e Kolonisë, që e ndihmuin, kur e panë keq. Librat e tij u botuan me ndih-

mën e «Komunitetit Orthodoks». Një shoqëri tregëtarësh shqiptarë i pati siguruar një pension të vogël. U mësua të jetojë me kursim të madh. Nga gjendja shumë e vështirë ekonomike dhe nga dëshira që kishte për të vazhduar studimet e larta, më 1905 bën përpjekje që të nxjerë një burs për studim n'Austri, por kjo i dështon.

Konditat e vështira të jetesës aspak nuk e penguan Asdrenin ta ndjekë e ta ndihmojë me tërë forcat e veta lëvizjen tonë kombëtare dhe të punojë pa u lodhur si poet i saj. Në procesin e zhvillimit të kësaj lëvizje u brumos edhe talenti letrar i Asdrenit. Në dhjetëvjetorin e fundit të sh. XIX, lëvizja jonë letraro-patriotike ishte zgjeruar mjapt. Nëpër koloni të tjera të shqiptarëve të Bullgarisë, të Misirit dhe më vonë t’Amerikës, ishin formuar shoqëri patriotike, ku botoheshin libra dhe 20-30 gazeta e revista shqip, që u bënë tribunë e mendimit shqiptar e të letërsisë shqipe. Emrat e shkrimtarëve, folkloristëve, dhe të gatatarëve si Th. Mitkos, Sh. Kolonjës, M. Duçit, L. Llogorit, J. Vruhos, A. Z. Çajupit, F. Shirokës, L. Gurakuqit e tjerë, ishin bëre të njohur.

Që në vitin 1900 e tutje edhe firmën e Asdrenit do ta gjemë kudo nëpër revistat e gazetat shqiptare të kohës dhe poezi-të e tij do të botohen njera pas tjetërs. Dalja e Asdrenit në ske-në bash më 1900, kur kolonia e Bukureshtit pësoi një humbje të madhe me vdekjen e Naimit, që e kishte ushqyer me veprat e veta shtypëshkronjën e saj, dhe me ikjen e Vretos, që kishte qënë dora e fortë organizative e shoqërisë, pati një rëndësi të veçantë, sepse ai dha një kontribut të madh, për ta mbajtur gjallë aty traditën e botimeve letrare patriotike dhe lojti një rol të çmueshëm organizativ.

Vjershat e tij të para në revistën «Albania» plot fryshtësim patriotik, tërroqëm me një herë vëmëndjen e shkrimtarëve tanë më të dëgjuar të kohës. Asdreni i lexonte së pari vjershat e veta në mbledhjet e shoqërise patriotike të Kolonisë, sidomos në shoqërinë e rinisë universitare «Shpresa», që u themelua më 1899 me inisiativën e vetë Poetit. Kjo shoqëri, N/Kryetar i së cilës ishte Asdreni, botonte fletoren «Përlindja shqiptare», dhe jepte një kontribut të mirë në përpjekjet për çkëputjen e kishës shqipe nga kisha greke. Asdreni tani e zgjeron aktivitetin e tij dhe lidhet me patriotët e kolonive të tjera shqiptare. Nga çdo anë i kërkojnë shkrime për botim, pajtimtarë për të përkohëshmet shqipe, libra për të mësuar shkrim-këndimin shqip. Që më 1902 patriotë të çquar, si Milo Duçi, kanë filluar ta vënë në një rradhë me Sh. Kolonjën e L. Gurakuqin si shkrimtar patriot.

Që më 1903 Asdreni hidhet edhe në terenin organizativ të kryengritjes. Në marëveshje me Asdrenin, Thoma Avrami që nga Sofja bie në kontakt me komitetin e fshehur të kryengritjes fshatara maqedhone, për të bërë një «causa comune» kundër Turqisë. Me anë të Th. Avramit ai krijon lidhje me njerëzit në Shqipëri, për t'organizuar çeta kryengritëse. Por, me arrestimin e Th. Avramit, këto ndërmarrje të para dështuan.

Që më 1903 Asdreni i mbledhi poezitë e tij të shpërndara nëpër shtyp dhe, bashkë me ato që kishte dorëshkrim, botoi në Bukuresht librin e tij të parë me titull «Reze djelli», që dolli nga shtypi në fillim të janarit 1904. Ishte një botim i hijshëm me një parathënje, ku pasqyrohet qartë ideali patriotik, që e ka udhëhequr autorin për t'u bërë poet. Ky libër me 88 poezi, që vinte fill pas «Baba Tomorit», bëri një përshtypje të madhe dhe u prit me brohoritje nga të gjithë patriotët e kohës. Vetë Çajupi i shkruan plot entuziazëm midis së tjerash: «Të lumtë! ja vjersha që ndrijnë si rrezet e diellit! ja vjershëtor i vërtetë! Nuk mund të them se ç'ndjenj në zemër..... tani besoj se Naim Beu nuk vdiq..... se vendi që la ai bosh, e zure ti, ndaj dua të mbaroj këtë letër si e nisa: Të lumtë, të lumtë.....¹⁾). M. Duçi, duke i shprehur keqardhjen, sepse nuk i ka dërguar një kopje të librit, i thotë: «Më vjen keq, sepse unë digjem për të kënduar çdo që të jetë shqip, jo pastaj vjersha si të tuat..... shumë të bukura..... Puno or vëlla pa prerë, puno pa u lodhur, puno pa frikë, puno për atdhenë, puno për lulëzimin e letërsisë tonë, puno! puno! puno!²⁾. Fletoret shqipe i bëjnë këtij libri reçensione, për ta reklamuar, dhe flasin me entuziazëm. Përhapja e këtij libri e bëri Asdrenin të njojur gjithandej dhe korespondencia e tij me patriotët e tjerë u shtua aq më shumë, sa që nuk e përballonte dot me të ardhurat e veta. Ai ngriti në Bukuresht një degë të shoqërisë «Dija» të universitarëve shqiptarë të Vjenës, e cila, edhe mbas shkrirjes së tri shoqërive të tjera (Drita, Diturija, dhe Shpresa) të Bukureshit më 1906, për të formuar shoqërinë «Bashkimi», qëndroi vëcan dhe vazhdoi veprimitari më vehte.

Mbas botimit të librit të parë, penda e Asdrenit limohet, mprihet e forcohet edhe më shumë. Veç atdheut ai ka filluar t'i këndoje edhe më shumë dashurisë, bukurisë së natyrës dhe punës. Por kënga e atdheut tingllon gjithnjë më e fortë. Hil Mosi djalosh i shkruan më 1907: «Nuk di as unë, more vëlla, se çdo me thanë kjo punë. Tuj këndu vjershat e dashtuna tuejat, gë-

1) Arkivi i Shtetit Dok. Nr. 709, 736 — Kairo 3-II-1904.

2) Po aty Dok. Nr. 709, 951 — Kairo 12-V-1904.

Asdreni tanë kishte fituar kudo admirim si poet i atdheut; Veprat tuaja, zotëri, — i shkruajnë më 1921, — kanë zgjeruar dhe zbuluar leteraturën shqipe. «Endra e lote» të bën të lëshosh lote gazmore dhe kur mbaron së lexuari «Reze djelli» ndodhesh i shkathëtë dhe i ndritur»¹). Me iniciativën e tij drenovarët ngritën shoqërinë patriotike «Bashkimi» dhe e zgjodhën Asdrenin kryetar nderi.

Që nga viti 1922 Asdreni u emërua Sekretar i Konsullatës shqiptare të Bukureshtit, ku shërbeu më perioda të çkëputura deri në okupacionin fashist.

Më 1930 batoi veprën e tretë e të fundit «Psallme Murgume poezi patriotike, erotike, filozofike, të natyrës etj., ku veç gjurmave përparimitare të Rilindjes, duket qartë edhe influenca e artit dekadent të Perëndimit.

Më 1932 shqiptarët e Rumanisë e festuan me shkëlqim gjashtëdhjetëvjetorin e ditëlindjes së Poëtit. Por kjo që një iniciativë spontane e atyre që e çmonin. Shtypi zyrtar i Tiranës heshtि.

Më 1937, me rastin e kremit të 25 vjetorit të pavarsisë, i përmalluar për atdhenë, Asdreni erdhi për të fundit herë në Shqipëri. Njerzit e regjimit nuk e përfillnë, por miqt e tij e rreruan me dashuri dhe e ndihmuani, se kishte mbetur keq. Elementët reaksionarë të klerit katolik dhe tradhëtarët si E. Koliqi me shokë, që po pregeteshin për të krijuar një ambient të favorshëm t'okupacionit fashist, e shfrytëzuan mirë këtë rast. E thirnë Asdrenin në Shkodër dhe e pritnë me nderime të mëdha. Kjo shënonë fillimin e një demagogjije të fëlliqur, për të mbuluar tradhëtinë me rrobën e patriotizmit të pastër, siç ishte patriotizmi i Asdrenit.

Pushtimin fashist Asdreni e priti me urrejtje të thellë, siç tregojnë tërë miqtë që u ndodhën pranë tij ato dit²). Ai shkoi shpejt nga Tirana në fshatin e tij dhe mbas 8 muajësh iku në Rumania. Legata italiane e Bukureshtit, që synonte të shtinte në dorë shqiptarët e Rumanisë, futi në lëvizje tërë agjenturën e saj dhe përdori format më të rafinuara demagogjike, për të fituar besimin e Asdrenit ndaj politikës fashiste. I implakur nga fuqitë e mëndjes dhe i diziluzionuar ngajeta, i gjenyer dhe nga tradhëtija e Fishtës, e Koliqit me shokë, ai besoi më në fund në parullën fashiste të «Shqipërisë së Madhe», që kishte qenë për të një nga pikat më delikate dhe shprehu simpatinë përfashizmin në një poezi të tij.

1) po aty dok. Nr. II 2433, dt. 21.V.1921.

2) Informacion gojor nga Dr. Prof. A. Xhuvani etj.

Q'ahere e më s'u duk gjë e botuar nga Asdreni në shtyp. Plak në moshën 75 vjeç, Asdreni vdiq në Bukuresht me 11.XII.1947 dhe u varros atje.¹⁾

* * *

Vepra e Asdrenit zen një vend me rëndësi në letërsinë shqipe. Ai shkroi gjithsej nja 314 poezi me 14000 vargje, pjesa më e madhe e të cilave u përfshi në tre botimet e tij. Disa mbetën të shpërndara nëpër gazetat e revistat, ose nuk u botuan fare. Veç poesisë, Asdreni shkroi rreth 20 artikuj në formë panfleti a përshkrimi me vlerë letrare. Ai gjithashtu përkëtheu mjaft poezi nga gjuhët e huaja dhe një pjesë t'Odisesë, që mbeti e gjymtë në dorëshkrim. Dyzet vjet prodhimitari letrare të vazduar, pa ndërprerje të gjata, është një rast i rrallë në historinë tonë të letërsisë.

Poezitë e tij të vogla, të thjeshta e të këndëshme u lexuan dhe u recituan aq shumë sa i mban mend edhe sot një gjeneratë e tërë.

Gjuhën letrare shqipe ai e përvetsoi mirë. Më 1905 botonte poezi gregisht, që dëshmojnë se janë shkruar nga një njohës shumë i mirë i gjuhës greke. Rumanishten e përdorte pér ditë dhe frengjishten e njihet mirë që më 1903. Me anë të këtyre gjuhëve ai njoihu kryeveprat e letërsisë botërore dhe fitoi kështu një kulturë të gjërë poetike, siç dëshmon pér këtë edhe poezia e tij.

Krijimtaria e tij filloi me temën e atëdheut, por shpejt u zgjerua n'ate të natyrës, të dashurisë, të punës etj., duke krijuar kështu një nga diapazonet tematike më të gjëra në krahasim me poetët tanë më të njojur.

Para së gjithash Asdreni, si vazhdues i Rilindjes, është një poet i Atëdheut. Një soj si Naimi edhe Asdreni i vuri që në fillim vehtes një mision të lartë patriotik. «Ndër këto, thotë ai (pér poezitë e vëllimit të parë), pasqyrohet më tepër dashuria e atdheut, dashuria e atij vëndi, që të gjithëve zemra na qanë me lot kur e kujtojmë....»²⁾ Edhe në parathënien e librit të tij të dytë ai e thotë qartë se poezia e tij është vënë kryesish në shërbim të lëvizjes sonë kombëtare.

Poezia patriotike e Asdrenit ka gjithë tiparet e poesisë patriotike të Rilindjes sonë.

Që në poezitë e tij të para del e qartë dëshira e madhe e popullit tonë pér liri dhe kumbon kushtrimi pér kryengritje:

1) Gazeta «Universul» dt. 11.XII.1947.

2) Reze djelli. Parathanja f. 9-10.

«Qitni pallén si ju dini
Edhe kordhën në e kini!
Me gjithë zemër e pa ndjesë
Bini qenit të pabesë!»¹⁾

✓ Me urrejtje të thellë kundër shkelësit turk dhe me pasion,
Poeti bërtet bashkë me Çajupin e Gramenon për bashkim në
luftën e lirisë me parullën e Samiut, që u bë moto e gjithë shkrimitarëve tanë të fazës së fundit të Rilindjes.

«Më mirë të vdesim për liri,

.....

Se sa të rrojmë ndë robëri»²⁾

Por kohët janë të vështira, prandaj motivi patriotik në poezinë e Asdrenit herë çfaqet në formën e sulmit, si kushtrim për luftë, herë shpërthen me keqardhje për atdhenë e mjeruar në robëri, herë ngrihet me mburrje kombëtare për traditën e luftës sonë për liri e me urrejtje të thellë kundër shkelësit e shovenistëve fqinj dhe herë herë kumbon si hymn i fitores s'afërt e të sigurtë.

Shpesh zemërimi i Poetit kundër faktorëve që e kanë penguar lëvizjen tonë kombëtare të zhvillohet në drejtimin e një kryengritje të përgjithëshme, kthehet me një herë në kushtrim për luftë:

✓ «Më nj'anë fetë, besët dhe tradhësia,
Më nj'anë gjaku dhe harbutëria,
Poshtë errësira, posht' dhe robëria,
Rroftë bashkimi, rroftë vëllazëria!»³⁾

Ose, duke kënduar me optimizmin e çquar të Rilindjes, për forcën vitale t'Atdheut, që mundi t'u bëjë ballë shekujve të fortunës dhe tani është gadi të ngrihet e të dëftojë namin që ka patur, Poeti synon të ngrejë lart krenarinë kombëtare, duke mbushur zemrat e bashkëatdhatarëve me dashurinë e ngrohtë për atdhenë:

✓ «Sa të dua o Shqipëri,
Sa mall ndjenj e sa dëshirë!
Për ty gas e dashuri
Mu në zemër më ka mbirë.

Se për mua ti o atdhe
Je një lule aq e vyer,
Sa nuk gjendet përmbi dhe,
Shpirtin tim për ta ushqyer!»⁴⁾

1) Reze djelli f. 19 «Ardhi dita».

2) po aty f. 44 «Mjaft».

3) po aty f. 34 «Poshtë errësira».

4) Endra e lote f. 38 «Vlesa e atëdheut».

Sikurse Naimi e Çajupi, edhe Asdreni në mërgim e kaloi thujse tërë jetën, prandaj në poezinë e tij plot mall për vendlindjen ka shumë elemente të përbashkëta jo vetëm me ato të Naimit e të Çajupit, por edhe me ato të shkrimitarëve të tjera bashkë-kohas në mërgim, si me të F. Shirokës, L. Gurakuqit, Mqedës. Sikurse Çajupi (ps.h. në poezinë «Ku kemi lerë») edhe Asdreni i këndon vendlindjes si një fshatar i thjeshtë:

J «Dua edhe Shqipérinë
Se atje kam shtëpinë,
Ku rrinja nëpër ferrat
Dhe losnja me shqerrat

Për këto kam dëshirë
Edhe as dua më mirë,
Veç atje dua të shkronj,
Sa të jem e sa të rronj!».

Shpesh ndjenjat e atëdhedashurisë janë shprehur në lirikat e tij në formë të përgjithëshme, si ndjenja të të gjithë shqiptarëve të mërguar²). Poeti i drejtohet erës ose detarit, ta marrin e ta dërgojnë n'Atëdhe, ose i lutet dallëndysheve, sikurse Shiroka e Gurakuqi, t'i tregojnë mbi natyrën dhe jetën e bukur të Shqipërisë, për të cilën po i digjet shpirti³). I rënduar aq shumë nga jeta private e vëtmuar që bënte në mërgim, në lirikat e mallit për atëdhe, Poeti shkrini dhe dishirimin e tij për vatrën familiare e sidomos për nënën dhe me këtë afsh të zemrës frymëzoi gjithë shqiptarët e mërguar, për t'i mbajtur ata të lidhur me familjen e tyre, me atëdhënë, me luftën për liri kombëtarë⁴). Një pikëllim i thellë i përshkon këto poezi, që ta mbushin shpirtin me dashurinë e ëmbël të një zemre aq të butë, aq të dhëmshur për memën në mjerim:

V «Shqipéri o mëma jime
Lot po derdh prej zemrës sime,
Se je e tretur si qiri.

Hape gjirin, hapi krahtë,
Të të puth gojën e thatë
Me një mall e dashuri.⁵)

Prandaj kudo në këto poezi, Poeti e dënoi kurbetin si edhe Çajupi (poezia «Kurbeti»), si plagë nationale, që po dobësonë bazën e lëvizjes sonë çlirimtare, forcën e vegjëlisë, bash në pragu e kryengritjeve⁶).

1) Reze djelli f. 32 «Dua», po ashtu f. 46 «Atje» etj.

2) Endra e lote f. 28 «Në mërgim».

3) Kalendar kombiar 1907, f. 113 «Malli i atëdhëut» etj.

4) Endra e lote f. 44 «Mallëngjimi»; f. 60 Malli i shkretë; Reze djellit f. 118 «Shtëpija ime», f. 147 «Dheu i huaj» etj.

5) Endra e lote f. 23 «Shqipërisë».

6) Endra e lote, f. 44. «Mallëngjimi»; f. 60 «Mali i shkretë», Reze djelli f. 118 «Shtëpija ime», f. 147 «Dheu i huaj» f. 66 «Larg vatrës»; f. 30 «Gjendja jonë».

Për t'i dhënë më tepër forcë kushtimit, Poeti i prekte bashkëatdhetarët në sedrën kombëtare, duke i kënduar me pasion patriotizmit të hershëm, që tanë ishte venitur nga robëria shekulllore¹). Shembullin e figurave të mëdha historike si të Piros Lekës e Skenderbeut, ai e përdori gjithashtu për t'i qërtuar bashkëatdhetarët, që nuk po hidhen në kryengritje pa ngurrim::

✓

«O s'janë trimat, burrat që një herë,
Që dridhej bota këmbën tek e vinin!
Luanë jishin, frikë kurrë s'kishin,
Armikun s'e peshonin asnë herë»²⁾ DK

Gjithashtu nënë shembëllën e heroje të rrij të pushkës, si Ali Pashës, ose të pendës, si De Radës, Poeti i jepte gjithnjë zjarr lëvizjes çlirimtare në vjershën e tij. Kur i thuri lavdi dëshmorëve të rënë për atëdhe në kryengritjet e 1910-12-tës, bindja përfitore doli gjithnjë e fortë nga vargu i tij:

✓

«Edhe nga varret sot q'i shkel i huaji,
Ka me shkëlqyer djelli i ardhamjes sonë:
Lirija dhe përlindja e Shqipërisë³⁾.

Gjithmonë në polemikë me shovenistët grekë e serbë, që duan të mohojnë kombin shqipëtar, ai i këndon me pasion gjuhës shqipe për cilësitë e saj të larta⁴⁾ dhe shfren kundër aristokracisë shqiptare orthodoxe, që s'don të flasë shqip, gjuhën e vegjëlisë e të gjithë popullit shqiptar:

«Këta janë turp i atëdheut
Edhe plaga e Shqipërisë⁵⁾»

✓ Tema e gjuhës shqipe nuk u nda nga poezia e Asdrenit edhe pas fitores së pavarësisë, kur, me një art mjaft të ngritur, Poeti këndoi për vitalitetin dhe qëndrushmërinë e saj:

«Si deti rahur valash katallane,
Kur vjen shtërngata irrebëtë q'e sulmon.
Dhe ti, pas aqe sulmesh prej çdo ane,
Si shkëmb i fortë shekujt i qëllon...⁶⁾

1) Endra e lote f. 15 «Drini», f. 73 «Tingllinë», f. 93 «Krujës» etj.
2) po aty f. 73 «Tingllimë» etj.

3) Endra e lote f. 104 «Dëshmorët e Kombit».

4) Reze djelli f. 53 «Grekomanaet», f. 49 «Shqiptar i vertetë», f. 63 «Mallkim»; f. 78 «Lutje dhe Mallkim».

5) po aty f. 53 «Grekomanaet».

6) Shqipërija e re. Kostancë Nr. 397 dt. 28.11.1929 «Gjuha Shqipe».

Sikurse tek Çajupi, ndofta edhe më shumë, një vend të madh në poezitë e tij patriotike zanë vargjet me të cilat Poeti sulmon pa mëshirë synimet grabitqare të shovenizmit serb e grek, që ishte bërë një rrezik i sigurtë për Shqipërinë. Sikurse Çajupi, edhe Asdreni e ngriti me të drejtë nevojën e kësaj lufte sa edhe luftën kundër Turqisë, por nuk e quajti aleat shkelsin turk kundër fqinje.

Përkundrazi, jo vetëm në fillim, por vazhdimisht, deri në shpalljen e pavarësisë, Poeti s'e kurseu asnë herë sulmin kundër Turqisë. Duke u kapur me kushtetutën turke të vitit 1908, ai shpërtheu me pasion të madh patriotik kundër shkelësit:

«Mos ardhtë ora, mos e sjellçin vjetët,
Se ne, po i tuntmë shtyllat e shtëpisë,
Të kllasim zjarr, të bëhet hi dhe pisë....
As ne, po dhe jush këmbë më s'ju mbetet!!...¹⁾»

Para pavarësisë, kur Atdheu i robëruar ishte rrëthuar nga gjith anët me armiq dhe forcat e lëvizjes sonë kombëtarë ishin të pamjaftueshme për të përballuar një rrezik kaq të madh, poezia patriotike e Asdrenit, me një vështrim të përgjithshëm, duket fjalë e kushtrim pér luftën e lirisë. Nevoja e çastit pér një poezi sa më luftarake i diktoi atij një formë të re poetike, hymnin e marshin, që ai krijoj i pari në letërsinë tonë, shpesh me shumë sukses²⁾.

Edhe pas shpalljes së pavarësisë poezija patriotike e Asdrenit i ruajti tiparet kryesore të Rilindjes. Megjithse Poeti shpesh përsërit veten, ai tani i zhvillon më gjérë temat e përparëshme dhe aty-këtu i vesh ato me një art më të ngritur.

Në poezitë e frymëzuara nga malli pér atëdhe tani kriohen një kuadër i gjérë e i hollësishëm i natyrës dhe i zakoneve të jetës shqiptare, me vija më të theksuara lokale, ku ndihet aroma e ambientit të fshatit shqiptar³⁾.

Poezitë e tij të vona mbi vendlindjen, sikurse tek Mjeda, çkëputen nga ambienti i fshatit dhe e marin frymëzimin ndër qytete e vende historike, aty ku kishte lulëzuar dikur kultura antike, ose aty ku lufta pér liri kishte lënë gjurmë. Por ndryshe nga Mjeda, që qëndron vetëm n'epokën e lashtë, Asdreni

1) Endra e lote f. 77 «Koshtuta në Shqipëri».

2) Jo vetëm hymni i flamurit, por edhe mjaft hymne dhe marshe të tjera, si «Zëri i Flamurit», «Detyrë kini», «Besa jonë»; «Përpara» etj. u recituan me entuziazzmë nga nxënësit e shkollave, ose u kënduan si këngë.

3) «Djalërija» fror 1928 Nr. 4 f. 3 «Letër prej katundit tim»; Endra e lote faqe 200, «Prej katundit tim», f. 120 «Shega» etj.

D.K.

shpesh krijon lidhje me episodet e afërtë dhe me kohën që ka jetuar vetë.¹⁾ Me kalimin e kohës, me që shtypi nuk lejonte botimin e poeziave të tij, ku dënohet regjimi feudo-borgjez në Shqipëri, tema e lashtësisë pushtoi thuaçse krejt poezinë e tij patriotike, duke u shtyrë edhe më thellë se koha e Skënderbeut dhe e Lekës, për ta nxjerrë sa më të largët origjinën e popullit shqiptar, sikur edhe nga fillimi i jetës e koha e gurit²⁾, ashtu siç bën edhe Mjeda. Por, zgjërimi i temës së lashtësisë aty rrreth viteve 30, nuk u bë në poezinë e Asdrenit vetëm sa pë t'iu larguar problemeve aktuale, siç ngjau me Haxhiademin etj. Poeti e idealizonte të kaluarën e lashtë të popullit të vet, për të luftuar synimet grabitqare dhe gjenjeshtrat e shovenizmit serb e grek, duke kujtuar se kështu jepte një kontribut për sigurimin e bashkimit kombëtar.

Duke e mbajtur vemendjen e tij të ngulur vetëm tek rrëziku i shovenizmit grek e serb, nga fundi, ai e harroi rezikun e ri, që po i kanosej Shqipërisë prej fashizmit italian. Kjo qe sigurisht një shkarje. Por nuk duhet harruar se poezija e Asdrenit qe kryesisht një forcë e gjallë për edukimin patriotik të popullit tonë dhe ashpërsimin e luftës, për lirinë e Atdheut. ³⁾ D.K.

Bir i fshatarësisë sonë të përvuajtur, Asdreni me aktivitetin e vet letrar-publicistik, i bëri jehonë aspiratave politike dhe shoqërore të klasës së vet, jo vetëm për çlirimin e Atdheut nga sundimi turk, por edhe kundër shfrytëzimit feodal e borgjes. Asdreni qe një nga shkrimitarët tanë të parë që e përdori gjérësisht poezinë e tij si armë në shërbim të klasave të shtypura. Kjo është një meritë e veçantë e poeziës së tij politike. Këtë e bënte Poeti me ndërgjegje të plotë. Ai mbajti një qëndrim parimor ndaj artit dhe i njoihu letersisë një rol udhëheqës e revolucionar: «siç duket, — thotë ai, ndër të tjera, — që më 1912, është një fakt i pamohuar, se letersia ka veprimin e saj përmbi shtetin shoqëror e politik të një kombi»³⁾. Por baza e ktyre mendimeve të guximshme ishte botëkuptimi i tij si demokrat, që e shihte lëvizjen tonë nacional-çlirimtare nga pozitat e klasës së vet, nga pozitat e vegjëlisë. Me artikullin e tij më 1902 «Dy-tri fjalë mi Ojhakësinë», për të parën herë në terenin ideologjik të lëvizjes sonë kombëtare, hapet një luftë aq e vendosur për sigurimin e një pushteti pro vegjëlisë në Shqiprinë e nesërme të çliruar, pushtet, që «nuk do ta lejë vegjëlinë në thonjt e mprehta të parësisë» dhe demaskohet pamëshirë parësija për antipatriotiz-

1) «Djalërija», maj 1921 f. 13 «Durrësit» etj.

2) Arkivi i Shtetit Nr. 221, «Gjaku i stërgjyshëve».

3) Endra e lote f. 9. parathënia.

min e saj. «Ajo vegjëli që derdhet kurdoherë në çdo rrezik, kur parësija rrri dhe vështron për së largu..... lëpinë këmbët e anadollakëve për ca ergjent...»¹⁾. *D.K.*

Më vonë, nën ndikimin e ideve demokratike e socialiste të lëvizjes fshatare rumune dhe të aspiratave demokratike të «vegjëlisë» në lëvizjen tonë kombëtare, që tani bëhet masive dhe kthehet në një kryengritje t'armatosur, aq edhe më tepër piqet mendimi i tij demokratik, aq edhe më me pasion e demaskon ai tradhëtinë nationale të parisë dhe shfrytëzimin që i bën ajo vegjëlisë, aq më me forcë e ngre ai lart patriotizmin e kësaj vegjëlige. Asdreni sulet me tërbim kundër të pasurve që, «sytë e mëndjeni i kanë rrreth asaj cope ari...., që bëhen të shurdhër ndë rënkimet e pshëretimat e luanëve të plagosur, të nënave e të foshnjave, që kanë mbetur rrugëve pa një copë bukë, të martyrvë, që derdhin gjakun pa një far interes, po veç për atë qëllim...»²⁾. për lirinë e atëdheut. 9 muaj më vonë, ai shkruante përsëri: «Parësia është ajo që i ka mbajtur punërat në vënd. parësia as është lëvizur, parësia s'ka nxjerrë asnje zë. kur populli thëret, ata u bien ndë këmbë armiqëve»³⁾.

Që në poezitë e tij të para elementet realiste zinin një vend të dukshëm. Poeti dallonte që në fillim, se, lakmia për grumbullimin e kapitalit në shoqërinë borgjeze të kohës së tij, ishte burimi kryesor i çdo ligësie:

✓ «Një pun'e prish njerinë edh'e çpon
Të vritet, t'vrassë e pa turp të vjedhë;
Të ler atëdhe, prindër dhe gjë që s'shëkon:
Se do veç ar ndë taskë t'i rjedhë!»⁴⁾

Ndërsa zhvillohet e përgjakëshme kryengritja e malësorve të Veriut kundër forcave turke, me një thirrje burrërore nga pozitat e vegjëlisë, drejtuar pasanikëve, për të ndihmuar materialisht luftën e lirisë, Poeti më tepër se sa kërkon ndihmë, proteston, akuzon dhe i çjerr maskën feodalëve dhe borgjezisë së pasur, që mënjanohet nga lufta, duke pritur me cinizmë të korrin frutin e gjakut të vegjëlisë, për të përjetësuar pushtetin e tyre gjakatar pas pamvarësisë, pa bërë as më të voglën sakrificë⁵⁾, Kudo pozita të qarta klase, kudo del antiteza që përcaktion

1) Albania, 1902, f. 54 «Dy tri fjalë për Ojhakësinë».

2) Liri e Shqipërisë — Sofje — 25 Korrik 1911 «Mendime të Kodës».

3) Liri e Shqipërisë — Sofje — 21.IV.1912 Parësija e Shqipërisë».

4) Reze djelli f. 131 «Në ëndërr».

5) Endra e lote f. 88, «Zani i kryengritësve».

qëndrumin e dy klasave antagoniste kundrejt lëvizjes sonë nacionale:

✓

«Ne derdhim gjakun lumë, ju veç pasje,
Ne vdekje tmeri presim, ju veç rrojtje...¹⁾»

Kjo urrejtje klase në çastet më kritike të jetës sonë kom-bëtare nuk drejtohet vetëm kundër feodalëve. Vjersha «Zëri i Kryengritësve» u shkrua kryesisht për borgjezinë e pasur shqiptare të Rumanisë. Nga akuza për antipatriotizmë Asdreni kudo në shkrimet e tij të kësaj kohe e përgjithëson shikimin kritik e ndeshkues dhe zbulon me urrejtje shfrytëzimin e egër, që pasanikët i bëjnë vegjëlisë dhe gjithë plagët që i kanë hapur vën-dit: «Po e heqni nepër këmbë edhe popullin duke e bërë pjedes-tal..... parësia e solli vendin tonë në këtë ditë si s'ka më keq.... populli ka marrë botën, duk'u përhapur në të katër anët e dheut....»²⁾ Gjithashitë edhe poezia e kësaj periode kritike, nga protesta për tradhëtinë e parisë kundrejt atdheut, kthehet e tërë në një akuzë të fortë, ku arrinë kulmin urrejtja e klasës së shfrytëzuar:

✓

«Sa lotë s'janë derdhur pa shteruar,
Shtëpi sa s'kanë mbetur sot të shkreta;
Sa zemra s'psherëtijnë sot pa pushuar,
Theror q'u bënë nënë thonjt e mprehta³⁾»

Sikurse tek lirika e Mqedës⁴⁾, ashtu dhe tek ajo e Asdrenit, në të njëjtën kohë, shpërtheu më në fund dëshira për një hak-marje, që zjente në krahërin e klasës së shtypur e të tradhë-tuar:

«Mjaft! mjaft! se u mbush kupa e hidhërimit!
Gjérpinj pushoni, helmin tej e cporrni!
Mos dalim tej kufirit të durimit:
Që më në funt se c'mbuallt ju të korrni!
Ju ligsitë e fajet s'munt t'i mfshehni,
Cdo e keqe këtu poshtë e cperblimin»⁵⁾

DO CLO

1) po aty.

2) Liri e Shqipërisë. Sofje — 24.IV.1912 «Parësia e Shqipërisë».

3) Endra e lote f. 33 «Krerëve tradhëtarë».

4) «Liria», botua më 1937.

5) Endra e lote f. 33 «Krerëve Tradhëtarë».

Poeti nuk besonte se pavarësia do të sillte ndryshime në favor të vegjelisë. Që në pragun e pavarësisë tek poezija e Asdrenit spikat një mendim krejt i qartë realist për të arthmen e Shqipërisë së pavarur, ku shfrytëzimi do të vazhdonte edhe më keq dhe urrejtja e lufta midis dy klasëve antagonistë do të forcohej. Po, duke shfryer tërë revoltën e kësaj vegjelije, Poeti paralajmëron shembjen e pushtetit të «gjakata» rëve të tërë kësaj bote»:

✓ «Po s'dinë se edhe fati i tyre mvaret
Në dor' t'atyre që sot i shqelmojnë!»¹⁾

Veç kësaj baze realiste në marrëdhënjet politike-shoqërore të kohës dhe tonit revolucionar, tek poeziia e tij e fazës së fundit të Rilindjes ka gjurma të sigurta t'ideve socialistë. Me lulëkuqen p.sh. Poeti simbolizon të varfërit, që shtypen pa mëshirë e janë lënë në dorë të fatit. Ngjyra e kuqe e kësaj lulje i kujton atij flamurin e revolucionit proletar:

✓ «Ajo ngjyrë kur ze çfaqet
Mbreti fronë shkon e le,
Njerëz robër fare s'sheh,
Vjen e drejta del në faqe.
Si zot je.....»²⁾

Megjithse Poeti e pati humbur shpresën për një pushtet pro vegjelisë në Shqipërinë e lirë, edhe pas shpalljes së pavarësisë ai nuk e lëshoi kurrë flamurin e luftës kundër «parisë», sa herë që ajo e tradhëtoi Atdynë. Ai nuk prani së luftuari në shkrimet e tij për sigurimin e një regjimit sa më demokratik, që «të mos shkelen principet (les principes) e nalta të drejtave njerëzore, të fituara me gjak të parreshtur dhe mundime titanike..... që vullneti i popullit mos mposhtet e mos shkelet prej atyre që e besonin vehten të fuqishtëhem e të pamundun.....»³⁾

Tek poezitë e disa çasteve të vështira por heroike, që kaloi vendi ynë më vonë, del i qartë motivi shoqëror dhe qëndrimi i Asdrenit në pozita klasiste. I frysmezuar nga patriotizmi i lartë i vegjelisë në luftën e Vlorës, Poeti u shpreh me urrejtje për shfrytëzuesit, që i u reshtën luftës dhe këndoi me simpati e pikëllim të thellë për gjendjen e mjeruar dhe shfrytëzimin e egër, që rën-

1) Po aty f. 68 «Cpérblimi».

2) Po aty f. 51 «Lulekuqeja».

3) Shqypnia e re 21 dhetuer «Disa mendime».

donte mbi shpinën e fshatarësisë, e cila u sakrifikua për lirinë e vëndit:

«Jemi bujq e trual s'kemi,
Zotërijt e mbajnë frerin
.....
As shtëpija s'është e jcna;
Kur u kënda jasht na qesin.
Për një dru në vatrat tonë
Me të rrahir shpesh na vdesin¹⁾
.....»

Gjithmonë në vargun e Pçetit, nga goja e ktyre njerëzve të shfrytëzuar deri në pale, del zemërimi kundër të pasurve, që tradhëtojnë atdhenë, shfrytëzojnë popullin dhe tani kanë kapur frenat e shtetit në dorë:

V

«U Treta për disa,
Q'as njihnin komb, atdhe;
Mbi frone sot ata,
Që shgryhen pa një fre...»²⁾

Gjatë regjimit feudo-borgjes të Zogut poezia e Asdrenit nuk u çkëput fare nga problemet politike e shoqërore bashkë-kohore. Që në fillim pçezia e tij e priti me ironi aparatin burokratik gjysanalfabet të «Parësisë gjakatare»³⁾.

Me gjithse regjimi në fuqi ja mbyti fjalën në grykë Poëtit, sepse ai s'pati mundësi t'i botojë këto poezitë e fundit, edhe dorëshkrim siç u gjetën sot,⁴⁾ ato tregojnë qartë se sa thellë e ndjeu ai në shpirt mjerimin e popullit. Pçeti demaskoi me ironi metodat më t'egra që kanë përdorur feodalët në fuqi, për t'u majuro me gjakun e djersën e popullit në mjerim⁵⁾. Me vargje të përgjakëshme ai zbulon anët më të shëmtuara të jetës sonë dhe, si patriot demokrat, që i dhimset atdheu e populli, shfren me urjetje të thellë jo vetëm kundër klikës në fuqi, por edhe kundër gjithë feudoborgjezisë, që kishte vendosur regjimin e saj të «hurit e të litarit»⁶⁾. Rezultatet e një regjimi të tillë Poeti i pasqyroj

1) Psallme murgu f. 43 «Buri i dheut».

2) Po aty f. 58 «Luftari lypës».

3) Arkivi i Shtetit Nr. 248 «Republika Shqiptare».

4) Në arkivin personal të Asdrenit u gjetën, midis së tjerash, tri poezi dorëshkrim, të pa botuara: «Republika Shqiptare», «Fisnikët e Shqipërisë» dhe «Trashëgimi».

5) Arkivi Shtetit Nr. 247 «Fisnikët e Shqipërisë».

6) po aty Nr. 215 «Trashëgimi».

lakuriq e pa mëshirë me një kontrast të thellë të jetës së dy klasave antagoniste, siç bëri edhe Migjeni në përemën «Mjerimi», ku, më nj'anë të del «lypsi me sy të jeshilta dhe duart e mpita» dhe m'anë tjetër «barkshekullorët gjithmonë të pangishëm»:

«Kur poshtë janë vaje për vojtje dhe mjerime,
Që s'kanë një kafshore të bukës së përditshme,

Të zbatohur e të xhveshur ndër vrima dhe kasolle,
Një lind, pesë vdesin, me kërmat mahin tokën,
Fëmijtë si cirua prej ethesh e prej kolle,
Si fiq të thatë fishkur, mezi e shpien kokën,
Më njanë sheh të ngopur, të ngjallmë, barkalecë,
Dinakë mu si dhelpa, çdo send me grep ta heqin.

Ushqehen parazitë, pa bërë kurrnjë punë,
Që rrojnë me gënjeshtra, që shesin çdo ndërgjegje;
Me kokën plot me krunde, lëkurën mu si gunë,
Shushunja gjak, të thihin, pa dhën' asnjë përgjigje¹⁾

I tmerruar përpara një humnere të tillë, ku po gremiset çdo vlerë nationale dhejeta e popullit është bërë mjerim, Poetit i duket i pamjaftueshëm arti i vet, për të ndalur një rrezik kaq të madh. Ai kërkon ta qëllojë armikun, feodalët e borgjezët në fuqi, me armën më të fortë që ka krijuar gjenija njerëzore në fushën e artit:

V «Të kisha Dante i pendë, penel të Rafaelit,
Me vjersha dhe me ngjyra, me këngë si t'Homerit,
Gjigandët, që po ngrehin sot pircun e Babelit,
Në lavd qellor t'i ngrehnja «herojt e Guliverit»,
Katundesh dhe qytelesh si një rapsod shetitës,
Kurorë do t'i thurnja nér hymne burrërike,
Kërmijve që krenchen se janë hyjt e dritës,
Burim i lumturisë të s'ultës sonë hije....
Gjurmashët e pazotë, të mitur si një dele,
Me veprat burracake dhe me etje madhërije!
Kam frikë, trashëgimi mcs bëhet gjithë fërtele:
Ideali i èndëruar mos zhduket si një hije..»²⁾

Asdreni e kaloi rininë në natyrën e bukur të fshatit shqiptar
dhejeta e qytetit i u duk «si një burg pa mure, që i pengonte

1) po aty.

2) po aty.

lirinë», prandaj natyra u bë për të objekt i parë frymëzimi dhe motivi i natyrës e përshkoi fund e krye poezinë e tij. Në vargjet e tij të para, motivi i natyrës ka tipare shumë t'afërta me atë të Naimit e të Çajupit. Sikurse Naimi, Çajupi e Mjeda edhe Asdreni i këndoi natyrës shqiptare për të ngjallur krenarinë kombëtare, për të forcuar shpresat e lirisë dhe ndërgjegjen patriotike të bashkëatëdhatarëve të tij.

Në fillim natyra paraqitet me vija të përgjithshme; por më vonë, në poezitë e tij krijohet një kuadër më i qartë i natyrës dhe i jetës shqipëtare, me kolorit lokal më të theksuar. Zakonisht, në pasqyrimin e vendlindjes, Asdreni ndoqi më tepër rrugën e Naimit se atë të Çajupit. I rrëmbyer nga malli pér natyrën dhe jetën e fshatit shqiptar dhe nga dëshira pér t'i mbajtur bashkëdhatarët e mërguar të lidhur me Atdhenë e me çështjen tonë kombëtare, Poeti përshkroi peizazhe romantike plot shkëlqim, ku del fshati shqiptar me pamjen e ditëve të festës, me zakone t'i idealizuara, dashuri, harmcni.

Nën influencën e poeziisë së huaj romantike, Asdreni i këndoi jo vetëm natyrës së vendlindjes, por edhe natyrës në përgjithësi. Një nga të parët në letërsinë tonë, Asdreni filloi kriimin e poeziisë për stinat, ose muajët e motit dhe ia arriti këtu qëllimit aq mirë sa edhe Mjeda. Kudo, bashkë me natyrën, pasqyrohet edhe veprimtaria njerëzore. Në fillim, kur penda e tij ende nuk ishte influencuar nga arti dekadent i kohës, motivi i natyrës përshkohet nga optimizmi për jetën. Edhe në çastet më të egërsuara të motit në vjeshtë a në dimër, ai gjen shpesh diçka për t'u gëzuar a kënaqur¹.

Në këto poezi është pasqyruar jo natyra e vdekur, por natyra e gjallë, në zhvillim e sipërm, natyra që lëvis, që hecën bashkë me jetën njerëzore, natyra si burim i jetës. Duke i kënduar natyrës në përtëritje, poezia e tij kthehet në një himn për tërë jetën e gjallë:

Natyra

«Këtu bilbili këndon nëpër gjeth,
Mëllinja e gëzuar rri mi breth
Dhe dallëndyshja rrëthon, fluturon,
Qyqja degë mbi degë vete e qëndron²»

E gjith kjo bukuri e natyrës shpërthen nga zemra e njeriut një gëzim të papërbajtur, që frymëzon miqësinë, dashurinë dhe harmoninë.

1) R. D. f. 126. «Dimri».

2) E. L. f. 114. «Prendvera».

Edhe tek poezitë e mbrame, kur gadi çdo gjë rreth tij po errësohej, për të ndjellë dyshim e humbje shprese, vetëm natyra në pranverë e ringjall, i ep jetë e gjëzim.¹⁾

Pikërisht në këto poezitë e pranverës duket edhe *motivi i punës*. Natyra dhe puna, njeriu në punë e sipër i shohim shpesh të bashkuar në poezinë e tij, sepse Poeti nuk e mendon natyrën pa jetën njerzore dhejeta nuk ka kuptim pa aktivitet frutdhënës, pa punë të gjuar:

«Çunat lozin, vashat qepin,
Plakat e irta tjerrin lesh,
Nuset tundin, shkundin djepin,
Burat shatnë, pleqtë grepin,
Një bën fjalë e tjetri qesh.»²⁾

Me gjithse vjeshta ja ka prishur natyrës bukurinë që ka pasur në prandverë e në verë, gjëzimin Poeti e gjen tek puna që zjen, për të mbledhur frutet e djersës, që rodhi gjatë verës:

«Por e mirë është vjeshta,
Sepse bujku gjith punon;
Për të vjelur sot ka vreshta,
Nesër arat po liron.»³⁾

U bënë shumë të njohura poezitë e para të Asdrenit, ku i këndohej plot gaz punës dhe fshatarit të thjeshtë, që punon pa u lodhur për të siguruar bukën e gojës, sepse me shembëllën e tij, duhej t'edukoheshin tërë bashkatdhetarët⁴⁾. Poeti nuk e la fare në harresë shfrytëzimin, që i bëhej punës së bujkut në rëgimin e feudo-borgjezisë,⁵⁾ por, me që ai ndiqte një qëllim të caktuar edukativ, punën e përpjekjet e njeriut në jetë i paraqiti zakonisht si ligjë të natyrës për çdo gjë të gjallë.⁶⁾

Duke shprehur kudo simpatinë për njeriun punëtor dheurrejtjen për përtacin, strofa e tij mori shpesh formën e proverbit popullor dhe shërbeu për edukimin e shkollarëve me frymën e punës:

1) P. M. f. 147 «Mirë se na erdhe prendverë».

2) E. L. f. 114 «Ditë prendvere».

3) E. L. f. 110 «Vjeshta».

4) R. D. f. 108 «Punëtori i mirë», f. 141 «Puna» etj.

5) P. M. f. 172 «Fyelli».

6) E. L. f. 111 «Shpesët udhëtarë» etj.

V

«Puna është nderë
Për çdo njeri me mënt,
Përtimi është vrerë
Pa fjalë e pa kuvënd»¹⁾

Për të luftuar përtacinë, Asdreni përdori edhe satirën, ku vuri ne lojë njerezit e kotë, që e kalojnë kohën vetëm me fjalë.

Por lirika e natyrës tek Asdreni është shumë e gjërë dhe motivi i punës, veç rasteve kur trajtohet veçan, vetëm sa përshkon nëpër të. E tërë kjo lloj lirike, sidomos ajo e fazës së parë të prodhimtarisë së tij, është një hymn i gëzuar për natyrën dhe jetën. Më vonë, luhatjet e ndjenjës së Poetit, sipas gjendjes në natyrë, bëhen më të theksuara.

Gjithashtu, bashkë me motivin e natyrës, në poezitë e Asdrenit trajtohet edhe *motivi erotik*, sepse szenat e dashurisë zhvillohen në mes të natyrës. Tek poezitë e tij të para erotike ka gjithashtu diçka të përbashkët me erotikën e Naimit. Lirikat e dashurisë tek Asdreni kanë gjithë tiparet e romantizmit përparrimit, sepse dashurisë i këndohet me një notë optimizmi; dashurija për femrën del si forcë e madhe, që e shtynë njeriun ta dojë e ta gëzojë jetën. Mund t'i ndajmë lirikat erotike t'Asdrenit në poezi të thurura sipas formës së poezisë sonë popullore, me kolorit Shqiptar, ku frymëzimi është marrë nga jeta e fshatit të tij, dhe në lirika të tillë, ku ndiehet nota e erotikës së huaj romantike. Por kudo ai i këndon dashurisë midis njerëzve të thjeshtë të punës. Bukuria e burrit, sipas konceptit të popullit punonjës, edhe këtu, qëndron tek shëndeti dhe ashpërsia e tipareve fizike: «symath, mustaqezi». Dhe djali i drejtoshët vashës «Sykaleshe, buzëtrendafile që hecën me çap pëllumbi.....» plot shëndet e gjallëri, me shprehje të thjeshta dashurije, i lutet, e gjérmon dhe, herë-herë «takohet me të nëpër gjeth e çmallet, herë po i shkon mundi kot, i hetojnë, i gjërmojnë, flasin bota che ata mbajnë mëri me shoshojnë, ose ndahan. Jemi pra në një ambient fshati. Duke i kënduar dashurisë në fshat, Pjetri u orientua disa herë drejtë qëllimeve patriotike dhe nuk la pa zbuluar rdonjë problem shoqëror të vendit, lidhur me të. Ai i trajton me urrejtje rastet kur pasuria private, a zakonet prapanike, bëhen shkak e shkatërrojnë lirinë e dashurisë. Por në përgjithësi ai e pasqyroj dashurinë si një nga anët më të këndëshme të jetës së fshatit tonë, se djemt si Koci, Lili etj. përpiken të krijojnë familje dhe të jetojnë të gëzuar në fshat, pa e menduar asnjë herë kurbetin, që vetë Poeti e quante shumë të dëmshëm për vendin.

1) R. D. f. 108 «Punëtori i mirë».

Në lirikat e vona erotike, duke i kënduar dashurisë me një notë të huaj romantiqe, ai e ngrinte bukurinë e vashës mbi ate të çdo luleje, qendiste portretin e bareshës etj. dhe shpesh analizonte thellë procesin psikologjik të çasteve të dashurisë në pleqëri:

✓ Shumë herë e kam mallkuar jetën time,
Shpesh herë thom, që s'dua më të rroj,
Po, kur fëtyrën ty gjith ta vështroj,
Harronj çdo vojtje jete dhe hidhërimë.

Por prap atë fëtyr' un e mallkoj,
Sado ma mbush zemrën me gëzime,
Kur shoh, se, sa më tepër e adhuroj,
Çdo mprehje shpirti, ndrohet në mundime¹⁾

Kjo do të thotë se pëceti i këndoi ndjenjave të tij dhe nuk këndoi një dashuri konvencionale, siç bëri Naimi, nën influencën e pcezisë orientale. Ai e njobhu forcën e madhe të dashurisë, i dha vehtes të drejtën të dashurojë, për ta zbukuar jetën, por e këshilloi rininë «t'i vejë fre çdo endje së tepërt». Asdreni nuk deshi të ndahet nga erotikë; por, kur mori t'i këndojet prap «turtullleshës së malit» në pleqëri, vargu i tij dolli pa shpirt, pa jetë. Me gjithë këtë, edhe në kohët e vona, duke e marrë temën nga folklori, penda e tij shkëlqen prap në fushën e erotikës.

* * *

Siç u vu në dukje, pcezia e Asdrenit, deri aty nga mezi i viteve 20 pati më tepër tiparet e një poezie të romantizmit përparrimitar. Ajo u vu në shërbim të lëvizjes sonë çlirimtare dhe militoi për një regjim demokratik; i këndoi natyrës, dashurisë, punës, të shumtën e herës me një ton entuziast, plot optimizmë, dashuri për jetën e shpresë për t'ardhmen. Kjo ngjau sepse, si bir i vegjëlisë, ai u influencua shpejt nga idetë përparimitare të kryengritësve tanë fshatarë të fazës së fundit të Rilindjes. Prandaj deri sa nuk qe stabilizuar një pushtet reaksionar, Asdrenin si edhe të gjitha shtresat e ulta të vendit, ende i mbante gjallë optimizmi, shpresa për mundësitë e fitores së një regjimi pak a shumë demokratik.

Po dobësítë mikroborgjeze të Asdrenit, sidomos lëkundja dhe pasiguria u pasqyruan gjithashtu në shkrimet e tij. Që tek poezitë e para fillojnë të duken elementet kontradiktore, si koncepti

1) P. M. f. 127 «Fëtyrën tënde».

mbi individualizmin borgjez, prirja pér t'u larguar nga problemet shoqërore, lodhja e disiluzioni, aq sa, herë-herë thua se a po kapitullon. Me gjithë këtë, këto elemente, janë ende të pëdukëshme në fazën e parë kundrejt pjesës së shëndoshë.

Sidomos me restaurimin e pushtetit reakcionar të Zogut, që i errësoi idealet patriotike dhe shoqërore t'Asdrenit, një pjesë e mirë e krijimtarisë së tij, mori gradualisht tiparet e një poezie të romantizmit dekadent. Mjaft poesi të tij u bënë fushë konfuzionesh filosofike, pér t'i gjetur kuptim jetës. Aty duket shpesh habia pér marrëdhënjet e reja shoqërore, që po krijojen, angësh-tia e tij shpirtërore në një botë të tillë «ku njeriu pér njerinë është bërë ujk» dhe ai ka mbetur i vetëm e pa familje. Poeti merr pamjen e një njeriu të martirizuar, e pushton bestydnia, misticizmi dhe shpesh kapitullon.

«Jam bota e re, që vendin ze së vjetrës,
Pushteti em nuk njeh kërrkund kufire...»¹⁾

Kështu, plot optimizmë e gjallëri, e ndjente vehten Poeti në mënë e tij, kur frymëzohej nga idealet e larta patriotike e shoqërore. Por tani, kur idealet e tij u shkelën me këmbë nga një klikë gjakpirësish, ai ra në pellgun e pesimizmit, i humbi shpresat dhe e pa vehten të gremisur.

«I çveshur nga stolitë e bukurisë,
Si çvishet pylli rcbës tij verore,
Me vrer shoh si erret ylli i burrërisë,
Në tym si pshtillet pamja madhështore.»²⁾

Përgjithsisht në poezitë filosofike të bie në sy përpjekja e Poëtit, pér të gjetur mundësitë e shpëtimit nga «kjo botë mundimesh e lotesh». Por me që është larg nga botëkuptimi shkencor mbi zhvillimin shoqëror, ai kërkon ta përbysë shoqërinë me anë të mbinjeriut të huajtur nga Niçaja, ose duke marrë arrati, pér të gjetur një botë ideale, ku jeta ecën e lumtur, pa kontradikta, si në prallë. Përqafon atëhere Biblën dhe i gjenë një zgjidhje të gatëshme këtij problemi që e mundon.

Me gjith këtë edhe në fazën e fundit, poezia e tij nuk e humbi fare karakterin realist e protestues. Siç e pamë, Poëtit i rrahu shpesh me forcë pulsi i klasës së vet dhe poezia e tij, njëkohësisht me këto dobësi, u zhvillua në frymën e urrejtjes kundër aristokracisë feodale dhe dénoi marrëdhënjet e shëmtuara, që polin në Shqipëri.

1) A. SH. Nr. 237; 238; 239 «Kënga e të riut njëzetvjeçar» (dorëshkrim).

2) A. SH. Nr. 240 «Kënga e plakut gjashtëdhjetëvjeçar».

Mjeshteria artistike e Asdrenit.

Me gjithse prodhimtaria e Asdrenit vazhdoi 40 vjet, ajo i rrujti tiparet kryesore të poezisë së Rilindjes. Ajo është një pëczi lirike, romantike. Ndërtimi i pëczeve mbi një sfond të natyrës, luhatja e ndjenjës së Poetit sipas gjendjes në natyrë, idealizimi i së kaluarës së popullit të vet dhe forma zakonisht retorike e vargut, ku ndihet pulsi i poetit etj., këto janë veçori romantike, që i ruan poezia e tij që nga fillimi gjer në fund. Dihet se elementet realiste në letërsinë shqipe shpërthyen së pari kryesisht tek Mjeda, Asdreni, Cajupi, Gramenoja, Siliqi. Por, vepra e Asdrenit, përsa i përket zbulimit të kontradiktave të klasave antagoniste lidhur me problemin tonë kombëtar dhe notës së revoltuar kundër shfrytëzimit, është më konsekiente se veprat e rilindasve të tjera.

Asdreni qe një nga poetët tanë që punuan më shumë për ta zgjeruar kulturën e tyre letrare dhe që u kujdesën më shumë për ta ngritur artin e tyre poetik. Ndryshe nga Çajupi, që u mbështet vazhdimi shtëpia e poezinë popullore, për ta lartësuar poezinë e tij në art, Asdreni, sikurse Mjeda, u largua pak a shumë nga poezia popullore dhe i ndeji më afér poezië së huaj europeane në procesin e formimit t'artit të tij poetik. Duke ecur në këtë rrugë, poezia e tij arriti një nivel mjaft të lartë artistikos sidosmos nga ana e formës, megjithse kjo përpjekje për persosuri forme nuk ndihmoi gjithnjë në qartësinë e idësë dhe në spontaneitetin e fryshtëzimit poetik. Si tek poezitë e Mjedës, ashtu edhe tek ato t'Asdrenit, duket poeti që ka ndenjur me limë në dorë, megjithse poezia e Asdrenit nuk e kapi dot përcosurinë e vargut të Mjedës. Ndërsa Çajupi, duke zgjedhur një metrikë më të lehtë, i dha një rrjedhëshmëri më natyrale, më spontane poezië së vet.

Por Asdreni është një poet me fantazi shumë të zhvilluar dhe me ndjenjë e shije shumë të hollë artistike. Në pëcze të librit të dytë e në disa të librit të fundit, mjeshtria e tij artistike arriti mjaft lartë. Shpesh edhe ku duket mjaft e kërkuar figura e tij artistike, ajo ka dale e tillë vetem si pasojë e çastit të fryshtëzimit, që nuk e lejonte Poetin të shprehej sidokudo, pa ndjenjë, edhe pse i kishte vënë vehtes si detyrë që figurën artistike ta fuste në kallëpet e një metrike aq të vështirë.

Asdreni është një nga mjeshtrit tanë më të mirë të tabllosë së natyrës. Poezitë si «Dite prendevere», p.sh., me një ndërtim të tillë arkitektural, ku gjithë procesi i dites brenda një tabloje kua-të natyrës në këtë stinë, futur midis dy strofash, secila një kua-

DK

dro e plotë më vete për mëngjezin e mbrëmjen, si dy lajtmotive të varjuar me mjeshtëri të hollë arti, dhënë me thjeshtësi e sinqerë, që s'ke ku të luash një fjalë, një poezi të tillë pra rallë e gjen në letërsinë shqipe. Pak a shumë krejt pcezitë e tij e vogla e të thjeshta mbi stinat, që u bënë aq të njoitura, janë të një niveli mjaft të ngritur artistik. Sidomos për pikturimin e natyrës në mbrëmje e në mëngjez ai është mjeshtër i madh.

Po në lirikat e natyrës gjemë që në librin e tij të dytë një figurë interesante edhe origjinale të krijuar me anë të personifikimit të elementeve të natyrës. Hëna, djelli, pyelli, dalin në formë të karikaturuar dhe pcezia përshkohet prej një farë humoritë këndëshëm.

Megjithse Asdreni nuk krijoi dot një portret heroik aq të lartë sa ato që krijuan Noli, Mjeda etj., portreti i gruas ka dalë i piktuar me bukuria të madhe në poezitë e tij erotike. Duke kapur zakonisht çastet më kritike, kur zen fill dashuria në formë idili midis dy të rinjve, Pjetri ka dhënë tërë bukurinë fizike dhe njomësinë e forcën e ndjenjës së fshatares së re.¹⁾ Të tilla portrete dhe caste idilike, dhënë me kaq thjeshtësi dhe vërtetësi, ka mjaft pcezia e Asdrenit, por më të paka janë ato me kolorit të theksuar shqiptar. Një pjesë e mirë e tyre duket se janë influencë e idilikës romantike europiane. Me gjithë këtë nuk janë të paka pcezitë e tij liriko-epike, ku, të riytë drenovarë, si Kcci e Ncnka, Shega e Lili, Leka e Thëllënxa etj., veshur me vjetësi fizike e psiqike të fshatarit tonë, i sillen shoshojt dhe dashurohen, sipas mënyrës dhe zakoneve të tyre të veçanta. Ndonjera prej këtyre ka formën e një poemthi, ku përshkon për bukurinë idil dashuri, që zhvillohet n'ambjentin e Drenovës.

Duke trajtuar tematikën fantastike të folklorit tonë dhe të mitologjisë greke, penda e Poetit shkëlqen shumë herë rë fu-shën e erotikës, veçanërisht tek portreti. Me figura stilistike mjaft origjinale, sidomos me krahësimë dhe epitete, ai të sjell përparrë syve portretin e së bukurës së dheut, me bukuria edhe njerzore edhe fantastike²⁾, ose krijon balladën tip në letërsinë tonë, nën shembëllin e balladës së Gëthe-s³⁾.

Kësi pcezishë të natyrës e të dashurisë, me një art të ngritur, gjemë mjaft në librin e tij të dytë e të tretë. Por në përgjithësi lirikat e fazës së fundit të prodhimtarisë së tij e humbën gjallërinë, jetën dhe u përshkuant nga një notë pësimiste.

1) E. L. f. 192, 211 etj.

2) E. L. f. 183 «E bucura e dheut».

3) P. M. f. 85.

Gjithashtu në poezitë e tij politiko-shoqërore më të mira, sidomos në ato të librit të dytë dhe tek ndonjë e fazës së fundit, ëuket dora e një mjeshtëri të sigurt, që din të gërshtojë në mënyrë organike pathosin agitativ të poetit tribun, mendimet lirike, publistikën e mprehtë, fantastikën dhe idenë e qartë realiste, interesin e gjallë ndaj realitetit dhe protestën e fortë shoqërore.

Castet e frysëzimit janë dhënë me një figurative të ndërtuara me mjeshtëri jo të zakonshme¹⁾. Krahasimin, metoniminë, alegorinë sarkazmën p.sh., të gjitha në një strofë Pjetri i fut në punë, kur turret me gjithë shpirt kundër «krerëve tradhëtarë», për të demaskuar me urrejtje tradhëtinë dhe shtypjen, që i bëjnë ata popullit, vendit:

«Si ferrat jeni, jetën q'e ndalojnë,
Çdo bim' e lule e mbytni nënë gjemba,
Sa as dritë as diell më s'shëkojnë,
As gjaku s'u lëvrin nér dejt a rrembat.

Si bishat malit, gjahut kur i derdhi,
As gjurmë më s'i mbetet në ka rrojtur;
Mëshirë s'kini, drojës ju nuk mverdhi
Për shpirtet, jetën që ua keni shqitur»²⁾

Bukuria e vashës nuk epet vetëm me krahasim të mjeteve të natyrës, por edhe me elementet e mitologjisë greke, për ta bërë të jashtëzakonshme:

«Së largu, Nereidë,
Prej detit sikur dolli,
Si shkumbë plot shkëlqim,
Si një Kareotidë,
Fidas që e polli
Në botë për kujtim.»²⁾

Zakonisht me antitezë të fortë e ndërton ai vargun, kur don të pasqyrojë kontrastin e jetës së klasave antagonistë gjatë reçimit të feudoborgjezisë,³⁾ siç bën edhe Migjeni p.sh. tek «Mjekimi» Alegorinë dhe ironinë ai e përdor gjithashtu me mjeshtëri, si në poezitë politiko-shoqërore, ashtu edhe n'ato të natyrës dhetë dashurisë.

1) E. L. f. 83.

2) po aty f. 210.

3) A. SH. «Trashëgimi».

Mjetet artistike që ka përdorur Poeti janë të shumta shpesh të ndërtuara me mjeshtri të rrallë. Por një gjë është përlu vënë re këtu: se me kalimin e kohës dhe me forcimin e botës kuptimit të tij mistiko-fetar, vinë e shtohen në poezinë e tij si gurat stilistike të ndërtuara me mjete biblike. M'anë tjetër, ngjomania për ta bërë sa më të «thellë» mendimin poetik, siç e këtë konte poezia dekadente, figura e tij artistike erdhi duke u errësuar, ose dolli aty-këtu e pakuptueshme.

Një nga meritat e veçanta të poezisë s'Asdrenit është gjithashtu edhe pasuria e saj metrike. Që në librin e tij të parë Poetë është munduar të dalë me një larmi sa më të madhe vargu përmes para publikut, duke përdorur gjithë llojet e metrave të poezisë sonë popullore dhe mjaft nga të poezisë së huaj (5, 7, 9, 11 rrrokëshet). Që aty ai krijoi gjithfarë strofash dhe përdori jo vetëm rimën e puqur e të kryqëzuar, por edhe gjashtëzën, treshen, terrenaren etj. Megjithse kjo larmi që u mundua t'i japë ai merit, strofës e rimës, që në fillim solli të meta të mëdha, sepse u detyrua të bëjë shpesh përdhunime morfolologjike e sintaktike, ose gaboi rëndë, sidomos tek ritmi (shpesh theksi ritmik nuk akordohet me theksin tonik), prap, që në librin e parë, na gjjejnë mjaft poezi, ku kërkесat e mëdha teknike nuk janë bërë shkak për ta prishur figurën e frymëzimin e tij poetik.

Duke qënë që në fillim kaqë këmbëngulës për një metrikë të pasur, Poeti shpejt arriti ta fitojë këtë aftësi dhe doli që në librin e dytë si mjeshtër i çquar. Jo vetëm që e konsolidoi vargun, e pasuroi rimën dhe e bëri atë të rrjedhëshme, duke i çdukur kështu gjitha ato të meta, që më parë ishin të rëndomta, por si-guroi tani një akord të plotë në punë të ritmit, duke i dhënë një rrjedhshmëri dhe harmoni të çquar poezisë, një larmi edhe më të madhe metri, strofe, rime. Sigurisht që rrallë herë edhe të kap syu këtu ndonjë përdhunim, por zakonisht çdo fjalë e varg, çdo figurë stilistike rrjedh me spontaneitet të tillë që rrallë e gjennë ndonjë poezi tonën para saj. Duke patur parasyshë gjendjen e poezisë sonë më 1912, mund të themi me siguri, se ky vëllim shënoi një sukses të dukshëm në fushën e metrikës. Ai solli forma të reja metri, strofe e rime nga poezitë e huaja, duke e pasuruar kështu metrikën e poezisë sonë. Këtu nuk është fjala më tepër për novitetin, se sa për mjeshtërinë e aplikimit, se edhe të tjerë para tij bënë përpjekje të tillë, por asnjieri deri në këtë kohë s'arriti t'aplikojë një metrikë kaq të vështirë në poezinë e vet pa përdhunime të ndjeshme, si tek libri «Endra e lot».

Me kalimin e kohës metrika e letërsisë sonë shkoi gjithnjë duke u pasuruar. Një kontribut i mirë në këtë drejtim që edhe

DK

vepra poetike e Asdrenit. Ai i dha strofës e rimës një larmi edhe më të madhe, duke futur kështu në poezinë e tij një muzikalitet futi në përdorim të gjërë vargjet e gjata e strofat e kombinuar me gjithëfarë vargjesh e rimash. Strofat 5, 6, 8 vargjesh p.sh. nuk i gjenë gadi asnje herë me të njejtën skemë rime.

Asdreni provoi i pari vargun e lirë në poezinë shqipe, gjithse ky qe i lirë vetëm në metër. Ai e ruajti rimën por gjithmonë një rimë me distancë të madhe.

Mund të thohet se nga faza e fundit, përpjekja për një formë sa më të përsosur, u bë një nga shkaqet që edhe e dëmtoi aty-këtu mendimin e tij poetik. Influencia e «artit për art» u duk tek disa nga tingllimet e tij të fundit, që duallnë fare pa jetë, të vdekura. Në këto raste duket se forma është bërë qëllim në vete. Një nga poezitë e tij të fundit p.sh. «Jam një bçem» është një përsëritje fjalësh, pa ide, që nxjerrin një farë tingulli kur rrëmojnë dhe asgjë tjetër.

Gjuha e Asdrenit me gjithë të metat që i gjejmë na sot, përkohën kur u shkrojt, qe një nga të mirat. Sigurisht që gjatë 40 vjetëve gjuha e tij pësoi një evolucion të madh, por gjuhëtarët tanë më të mirë gjithmonë e lëvduan gjuhën e Asdrenit¹). Ai e çmonte shumë lart gjuhën. Asdreni mori pjesë në debatet, që u bënë në fillim të shekullit tonë mbi problemet tona gjuhësore, veçanërisht mbi alfabetin. Poeti nuk qe në Kongresin e Manastirit më 1908, ku u vendos alfabeti që përdorim sot, por patriotët më të pastër si Çerçiz Topulli, Bajo Topulli, Thoma Avrami, Mihal Grameno, etj., u shprehën me keqardhje përmungesën e tij². I DK.

Ai filloi të shkruajë me një gjuhë të thjeshtë, me konstrukt e leksik popullor, që mban vulën e të folmes së Korçës. Por më vonë, gjuha e tij erdhi duke u pasuruar me fjalë e konstrukte të gjithë Shqipërisë. Asdreni bëri përpjekje të mëdha për të kontribuar me shkrimet e veta në formimin e një gjuhe të përbashkët letrare. Por ai nuk ndoqi një kriter shkencor në këtë punë. Sikurse edhe disa të tjerë, ai kujtoi se mund t'arrihet tek gjuha letrare e përbashkët me anë të një përzjerje artificiale të dy dialektave.

1 Kuvendi 13.IX.1918 (Scarpentis) K. Cipo: Ky libër (E. L. na mbush me gjith shpresë e gzhim, se gjuha jonë, kishte mujt me u përkulun fare mirë, e aftë me shprehë mendime të nalta...». Vullneti 21.X.1913 Nr. 411. «Asdreni është një nga ata të pakë që e njohin gjuhën tonë me rrënjë....» etj.

2) A. Shtetit: Nr. 709 869. Manastir 17.XI.1908. Në një postale që i dërgonin ata Asdrenit, midis të tjerash shkruhet: Shumë na ardhia keq që nuk të kemi në mes tonë, po kënduam këngën tënde. «Ardhi Koha».

lekteve tona. Prandaj përdori pa kursim forma gege në toskërishten e tij, sidomos infinitin, që bije shumë ndër sy në librë e parë e të dytë. Në librin e fundit shihet se Asdreni ka filluar të largohet nga një përzjerje kaq pa kriter, duke ruajtur në bazë gjuhës së tij një toskërishte pak a shumë të përgjithësuar, me gjithse rallë bien në sy edhe këtu forma idiomatike korçare. Edhe pse ai nuk e kurseu ndonjë fjalë të huaj në pcezinë e tij, përgjithësisht qëndroi besnik i purizmit të Rilindjes sonë, duke u përfjekur ta japë mendimin pçetik me fjalë e fraza shqipe. Asdreni u mundua ta pasurojë gjuhën me fjalë të rralla e me ndonjë neologizëm të vetën, por, po të bësh një krahasim me shkrimtarëtanë të tjerë të këtij kalibri, mund të thuash me siguri, se, në këtë fushë, kontributi i tij qe i vogël. Me gjithë këtë, sidomos në fazën e phekurisë, gadi kudo në shkrimet e tij, të bije në sy mjeshtrija e artistit, që din të zgjedhë fjalë dhe shprehje të bukurë popullore, për t'i dhënë gjallëri artit pçetik.

* * *

Figura e Asdrenit u bë aq e dashur, sepse emëri i tij ishte lidhur ngushtë me tërë punën e madhe organizative dhe propagandistike, që bëri kolonia shqiptare e Bukureshtit, sidomos vjetët e fundit të Rilindjes sonë. Gjatë kohëve më të vështira të lëvizjes sonë kombëtare ai militante në krye të saj dhe u çuan nga të parët.

Asdreni hyri në letërsinë shqipe në pragun e kryengritjeve, që u kurorëzuan me shpalljen e pavarësisë. Ai është një poet romantik që e vuri artin e tij në shërbim të lëvizjes sonë kombëtare. Por, duke zgjeruar motivin patriotik të Rilindjes me motivin shoqëror, ai shkrini me mjeshtëri tek romantizmi i tij mjaft elemente realiste. Poezia e tij zbuloi me urrejtje tradhëtinë nacionale e shfrytëzimin e klasave të larta, «të parisë», siç i quante ai, dhe qëndroi me ngulm në pozitat e vegjëlisë. Vargu i tij pati një forcë të veçantë propagandistike në shërbim t'interesave të vegjëlisë, sidomos gjatë kësaj periode. Aty rrahu me forcë pulsi i shtresave t'ulta, që mbushën rradhët e kryengritjes, përnjë Shqipëri të pavarur me një regjim demokratik.

Poezia e tij u bë gjithashtu një himn i këndëshëm dhe i gëzuar për punën, natyrën e dashurinë. Ajo është edhe sot një themë i çmuar për arësimin dhe edukatën shkollore.

Asdreni provoi me sukses edhe satirën dhe që një përkthenjës i talentuar.

Me poezinë e Asdrenit hynë në letërsinë shqipe mjaft elemente nga letërsia romantike europiane. Ndënë ndikimin e saj, u

futi sidomos në lirikën e tij erotike e të natyrës mjete të reja artistike, që e zbutën ndjenjën e i dhanë figurës një finesë të veçantë.

Ai thuri pcema të vogla dhe ndonjë balladë të përsosur. Sidcmos kontributi, që dha Asdreni në fushën e prozodisë, që mjaft i çmueshëm për letërsinë tonë. Veçanërisht në librin e tij të dytë, duke e ndërtuar poezinë me një metrikë të pasur, ai shërbeu si shëmbell për të tjerët.

Në fazën e dytë të prodhimtarisë së tij poetike, ndën ndikimin e artit dekadent të Perëndimit, sidomos duke parë se si po gremiseshin idealet e tij patriotike e shoqërore ndënë shtypjen e një regjimi reaksionar, Asdreni u krrus, u shua gradualisht tek ai gjallëria e optimizmi. Edhe pse u ngrit rallë e me forcë të madhe kundër këtij regjimi, ai ra në pesimizmë, penda e tij e humbi orientimin, shkau edhe në gabime.

Megjithëse Asdreni u çqua vetëm në çerekun e parë të shekullit tonë e pastaj, sidcmos nga fundi i viteve 30, zhvillimi historik i ngjarjeve e la mbrapa, as prapambetja e kësaj periode së dytë, as edhe ndonjë gabim që bëri nga fundi i jetës, nuk e shuajnë dot vlerën e madhe të tij si patriot demokrat dhe si poet. Me poezitë e Asdrenit u edukua një gjeneratë e tërë.

Në Shqipërinë e re, ku po vihen bazat e socializmit dhe idealet e tij për një atdhe të vegjëlisë u bënë realitet, trashëgimi i shëndoshë letrar, që na la Asdreni dhe veprimtaria e tij patriotike gjatë Rilindjes, do t'i shërbejnë gjithënjë popullit tonë si mjet për edukimin patriotik.

DHIMITËR FULLANI

Janar 1958

Shënim: I. Për këtë studim janë shfrytëzuar burimet arkivale dhe gjithë informacionet gojore të mundëshme rrëth jetës dhe veprimtarisë së Asdrenit. Këto do të shënohen me hollësi në një studim të plotë monografik, që do të botohet më vonë mbi Asdrenin. Falënderojmë veçanërisht poitin L. Poradeci dhe shokët Z. Stave (i nipi i Asdrenit) e Dh. Pasko për informata që na dhanë.

II. Ky vëllim përbledh vetëm një pjesë të veprës së Asdrenit, disa nga poezitë e ndonjë shkrim në prozë, që na u dukën më interesante për publikun.

Materiali i zgjedhur u muar nga tre botimet e tij poetike, nga shtypi dhe nga dorëshkrimet e pabotuara. Poezitë u renditën në bazë të tematikës.

Puna redaktuese solli disa ndryshime me karakter grafik, por në përgjithësi nuk e preku trajtën fonetike të fjalëve, p. sh.:

1) Disa nga fjalët e shkruara damas si *për-veç*, *por-se nga-dalë*, *për-dhe* etj. janë bashkuar.

2) Është hequr ndonjë *h* epentetike, si tek fjalët: *shtrihnë* (shtrinë) vehtë (vetë), ose proklitike, si tek *hijet* (ijet) etj., kur është parë se këto idiotizma fonetike e ngatrhojnë, ose e vështirësojnë të kuptuarit e fjalës.

3) Nga dy gërmat bashkë që përdor auktori, për të theksuar zakonisht një fonemë, është hequr njera, p. sh. *korrë korë*, *bleera blera*, *gjerra*, gjera etj.

4) Përemrat e mbiemrat pronorë e të pakufishëm, të shkruar me apostrofë (t'ím, c'do), janë bashkuar (çdo, tim).

5) Ndonjë fjalë e shkruar kot me gërmë të madhe, është bërë me të vogël.


6) Rrallë e tek është ndrekur ndonjë gabim i hasur, p. sh. *e* në vend të *i-së* etj., ose ndonjë grafi e tillë si *tund-u* për «tundu», *sul-u* për «sulu».

7) Janë lënë gjithë llojet e flaktuacioneve dhe përzjerjet dialektale të gjuhës s'aktorit.

8) Pikësimi u desh të ndreget thua jse në çdo varg, mbasi ashtu siç ishte, i shrregullt e pa kriter, e rëndonte leximin dhe e vështirësonë të kuptuarit e frazës.

U dhanë shënimë vetëm n'ato vënde ku u pa e domosdoshme.

Në fund të këtij vëllimi është vënë një pasqyrë bibliografike e poeziave të Asdrenit, të botuara dhe të pabotuara, për të formuar një ide të qartë jo vetëm mbi sasinë e prodhimit të tij, por edhe mbi përhapjen që ka pasur poezia e tij në shtypin tonë.



Asdreni (1926)

— Asdreni — Veprat

VJERSHAVE TË MIJA¹⁾

Prap ju kujtova, vjetesh krejt harruar,
Si gjë të vjejtur rall e tek q'e gjen.
Ju shkunda, letra, dorës sime shkruar,
Njëj gjumit, munt q'as juve s'ju pëlqen.

Ju mbloida, vjersha, nga ju kisha lënë
E një nga një ju pashë prap me mall.
Më dridhet dora si njëj të pangrënë,
Që dridhet pas ca buke q'e sheh rall.

Ca jush prej kohësh gjith me skajet brejtur,
Qysh brehet zemra keq kur send e pik,²⁾
Disa me faqet shuar, sërët mvrejtur,
Si shenjtër kishe, moti q'i ka fik.

Me ju përmenda jetën e kaluar,
Në radhët shkruar pashë shpirtin tim,
Me pikë lotesh zemre së lënduar
Mi ju të thara, mbetur si kujtim.

Ndër ju sa çaste gazi dhe pikllimi,
Sa drithma trupi s'pata ndjehur plot,
Kur shihnjë në çdo radhë dorëshkrimi
Hir dashamiri, hir që s'e gjej dot.

* * *

Kur nj' ankth përbrenda do s'më le qetuar
Dhe dua ta përball që në fillim,
Fët pendën marr, e vargut duk' i a shtruar,
Pa dashur vargu ndrohet në këndim.

Nër këngë dhembjes barin i a kam gjetur,
Me 'to trishtimin munda që ta shter,
Qysh zeri-i njëj vjolije tingëllfjetur
Çdo brengë si me dorë që ta merr.

Ju pata në kujdes si fletë lulesh,
Nër libra q'i vendos me dhempshuri,
Dhe si njëj korës herë q'i përkulesh,
Nj'ashtu dhe jush përpara po ju rri.

1) Kjo poezi është vënë në krye të vëllimit të tij të fundit: «Psallme murgu».

2) Kur send e pik = kur ndonjë send e pikëllon.

Si gjë të shtrenjtë, vjersha, ju kam mbledhur.
Nuk doja zjarrit jush t'i jap ushqim,
As copë-copë n'erë për t'ju hedhur,
Ta shoh të tretur kaqë mallëngjim.

Ju rojta si dhe vehten çdo reziku;
Nga palat mos ju dalë më rënkim,
Sa kini përkujdesjet njëj kreshniku,
Që veç nér ju ka gjetur ngushëllim.

Jo, kurr' o vjersha s'kam për t'ju harruar,
Se jush ka dalë tinglli-i zërit tem,
Dëshir' e zemrës sime dhempshuruar,
Nér ju q'e le si peng kur të mos jem.

KËNDONJ...

Kur mallit zemra më lëndohet,
prehje s'shijonj,
A prej njëj ngjarje më trishtohet,
unë këndonj.
Një dhëmbbbe kur më bën të vuaj,
s'shoh pik gëzim,
S'kam ndryshe zjarin si ta shuaj,
veç ndë këndim.
Kur brenga shpirtin ma pushtojnë,
s'ndjej pak qetim;
S'e gjej shërimin të më shkojnë
veç ndë këndim.
Kur ndë rezik atdheu ndodhet.
tym më çdo mur,
E athere zemra kurrë s'lodhet,
këngës ja thur.
Kur bukurisë dashurinë
un' i dëshmoj,
Dhe të më doj' a t'i mbaj zinë,
prapë këndojo...
Ndo gaze qofshin, ndo trishtime, ,
qesh a lotoj;
Ndo këngë qofshin, ndo vajtime,
unë këndojo.

POËZI PATRIOTIKE DHE SHOQËRORE

VLESA E ATDHEUT

Sa të dua o Shqipëri,
Sa mall ndjenj e sa dëshirë,
Për ty gas e dashuri
Mu ndë zëmrë më ka mbirë.
Se për mua ti o atdhe
Je një lule aqë e vyer,
Sa nuk gjendet përmbi dhe,
Shpirtin tem për te ushqyer,
Qindra vjete gjith në zi,
Qindra vjetësh i helmuar,
Po një vlerë pate ti,
Që s'ka shëmbell s'ësht dëgjuar;
Vala shkuan përmi ty,
Kombe shkelnë pa mëshirë,
Po një s'pati faq' e sy,
Të të shohë prej dheut fshirë.
Se ke trima si më s'ka,
Se ke burra të pa vdirë,
Droja syrin s'jau ha,¹⁾
Sisën tënde kanë pirë.
Mos ki frikë, mos vajto,
Mos me kryet²⁾, trupin zgjatur,
Tunde krahun u forco,
Dëfto namin që ke patur!

1912

PËRPARA! Marsh kombëtar

Lart Shqipëri,
Ti je e zonja,
Nga lufta sot mos ndalesh;
Me trimëri
Porsi shqiponja

1) droja syrin s'jau ha = frika syrin nuk ua kap; nuk u trembet syrl
2) mos me krye = mos me kryet ulur, mos e mbaj kryet poshtë.

Armiqve mos j'u falesh!
Si burr' u sul, ata dërmoji.
Me gjak të drejtat mprojë;
Përpara shko, përpara!

Ne bijt' e tu,
Për tyn, o memë
Forcojmë krahun tonë;
Që ti kështu,
Në lot e gjemë
Mos jeshë për gjithëmonë.
Luanët, trimat sot po presin,
Me nder për ty të vdesin.
Përpara shko, përpara!

Mos kij kujdes,
Mos trembesh kurrë,
Jij trime si qëmoti,,
Se sot ti s'vdes,
Kur djal' e burrë
Me armë del i zoti
E drejta sheshit do të dalë
Na thot' e shenja fjalë;
Përpara shko, përpara!

1912

BETIMI MI FLAMUR

(Hymn patriotik)

Reth flamurit të përbashkuar
Me një dëshir' e një qëllim,
Të gjith atij duk' j'u betuar,
Të lidhim besën për shpëtim.
Prej lufte veç ay largohet,
Që është lindur tradhëtor.
Kush është burrë nuk frikohet,
Po vdes, po vdes si një dëshmor!

Në dorë armët do t'i mbajmë,
Të mprojmë atdhenë më çdo kënt.
Të drejtat tonë ne s'i ndajmë,
Këtu armiqjtë s'kanë vent.

Se zoti vetë e tha me gojë,
Që kombe shuhën përmbi dhe
Po Shqipëria do të rojë;
Për 'te, për 'te luftojmë ne!

O flamur, flamur shenj' e shenjtë,
Te ty betonemi këtu,
Për Shqipërin' atdhen' e shtrenjtë,
Për nder' edhe lavdimn' e tu.
Trim burrë quhet dhe nderohet,
Atdheut kush i u bë terror;
Për jet' ay do të kujtohet
Mi dhet, mi dhet si një shënjtor!

FLAMURI KOMBËTAR

(Fragment)

Ngjyr' e kuqe si e zjarit
Dhe shqiponja me dy krerë,
I qendisur me fill t'arit,
Gjer' e gjatë bukur prerë.

Qindra vjete kanë shkuar,
Dit' të zeza e plot me zi,
Po ty fama s't'është shuar,
M'gjith q'u-trete, u-bëre hi.

Ti je yll' i mirësisë
Edhe engjell' i shpëtimit,
Se ti i dhe djelmurisë
Lulen bukur të Kujtimit.

Ndënë ty pra djelmuria,
Me dëshirë e me shpresë,
Do të luftonjë, që Shqipëria
Të rojë e të mos vdesë.

ZĒRI I FLAMURIT

Përpara, përpara, flamuri u-ngrit!
Zini brigjet, shtigjet, malet përpjetë!
Atje, atje ngjituni të gjith me nxit,
E ndënë valat e tij sicilit t'jetë!
Se atdheu me mall nga bijt' e tij pret
Shpëtim me të vërtet.

Të gjithëve sa gjaku që u lëvrin
Edhe nxehjtë ndë zemër i u valon,
Lini më nj'anë fetë dhe mërin'
E ngrihi, mblidhi, se koha kalon,
Ndënë flamurin e shënjtë me shpejtim,
Për t'atdheut lirim!

Ay, ay është flamuri ynë,
Që stërgjyshërit tanë e nderuan,
Me atë kudo që van' edhe hynë,
Armiqt' i shuan, Shqipërin' e zgjeruan.
Pra, ay është shënj' e trimërisë
Dh' engjëll i lirisë!

Oh, veç aher' ka vlerë trimëria,
Kur për atdhen' ajo derdhet pa kursim,
Kur armiqqtë shuhën si mizëria
E flamuri është ndë nder e lavdim!
Pra përpara djem, se s'do Perëndia
T'vdesë Shqipëria!

Sa jetë ka djelli qì në qìell çkëlqen,
Ashtu dhe Shqipëria me bijt' e saj
Do të improhet dhe qëllimin s'e këmben;
Kurrë s'mposhtohet, kurrë s'bie n'vaj
Se shqiponja, sa her' hidhet me zemrim,
Kudo fiton lavdim!

DRINIT

Drin o lumë, o i math lumë,
 Që sjell vala, gurë shumë,
 Që shkon udhës me buçime
 Dhe mbush malet me gjëmime,
 Që lak anës fusha, fshatra,
 Kur ti rendën më të katra,
 Pse je sot ti i egërsuar,
 Vetullmvrojtur, zemëruar?
 Vall' e ndjen ti robërinë,
 Që e ka mbytur Shqipërinë,
 Q'ësht' e shkelur, cepëtuar,
 Vargonj lidhur këmb' e duar?
 Nga të huajt q'e dërmuan,
 Krejt që e çveshnë, që e ropnë
 Dhe e thëthijtnë gjer sa u-ngopnë?
 Që kur Zoti të ka bërë
 Drin o lumë i gjat' i gjerë,
 Shqipërisë ç'i ka ngjarë,
 Ti të gjitha i ke parë!
 Se çdo luftë që ka krisur,
 Kundr' armiqve q'ësht' e nisur,
 I pe mundjet plot çkëlqime,
 Që përmenden si kujtime.
 Ata trimat e vërtetë,
 Që dëftonin se ndë jetë
 Kurrë s'trembet Shqipëtari,,
 Që ka zemër, gjak si zjari.
 Koh' e keqe apo e mirë,
 Mot i bukur apo i nxirë;
 Qoftë natë, qoftë ditë,
 Si ndë t'errët e ndë dritë;
 I ke parë, i ke dëgjuar,
 Kur ty pranë kanë shkuar,
 Dhe kaluar dhe me kembë,
 T'armatisur gjer më dhembë,
 Luanë e trima të pavdirë,
 Kryelartër, zemërlirë.
 Burrë e grua, plak e djalë,
 Gjith me zemër, jo me fjalë;
 Si fatosa që luftonin,
 Shqipërinë të shpëtonin.

Dhe të lirë, dhe të mirë,
Plot me gaze, plot me hirë
Në mes tyre rronin, shkonin,
Dashurinë s'e harronin.

Po sot vallë, sot si janë?
Kryeunjur an' e mb'anë.
Sot më s'është ay zjari,
Që e kishte shqipëtari?
Ay gjaku që valonte,
Kur detyra ja kërkonte,
Me një fjal' e me një besë,
Për atdhen' ay të vdesë.
Pasjen, gjënë mos kursejë,
Trimierinë të rëfejë.
Sot një heshtje, një përtesë
Me një rojtje në shërbesë.
Esht i ftetur, është i ngirë,
Pa një ndjenjë, porsi i mpirë;
Dhe nga feja i verbuar,
Ron ndë t'errët i mbuluar.

Drin! që rjeth gjith shkumb' e valë,
Her' i rrebtë, her' ngadalë,
Kur i turbullt', kur kulluar,
Kur i qetë, kur trazuar!
Që ke parë aq të ngjara
Dhe gëzime dhe të qara,
Nd'aqë vjete, aqë kohë
Dhe me diellë, dhe me llohë,
Kur shqiptari i vrapuar,
Për në luftët i gatuar,
Me balashin kryelartë,
Sy kulluar,, sy të kjartë,
Po dëfrente, po këndonte,
Këngë trimash kur kujtonte;
Kur bari dhe bleqtoreshë,
Porsi mbret e mbretëreshë,
Pranë teje shumë dendur,
Fjalë, këngë kanë endur,
Kur me fyell, kur me lote,
Duk' i puthur vala jote;

Këngë e bukur, këngë malli,
Që gjëmonte i tërë zalli,
Sa edhe qelli qeshte, fliste,
Dielli, hëna rinte, priste;
Më s'dëgjohet sot u shua
Më të qarë çdo gjë u ndrua
Nd'ujën tënde të valuar,
Atje brënda ka pikuar
Loti i mëmës që ka qarë
Djem të dashur q'i jan' vrarë.
Ndë atë ujet kaq të çgryer,
Që po duket gjith' i ngjyer,
Atje brënda është trazuar,
Në çdo kohë të tmeruar,
Gjaku e djers' e ushtëtarit
Dhe të fundit dhe të parit,
Që për emër të lirisë
I dha shpirtin Perëndisë;
Me mjaftim q'e dhuroj jetën
Për të drejtën, të vërtetën,
Për lavdimin'e kombësisë
Dhe për nder të Shqipërisë.

Ndale, ndale Drin vrapimin,
Qëndro pak e hith vështrimin!
Rotull teje duke i parë,
Se sa janë për t'u qarë
Viset tonë që rënkojnë,
Kur të parat i kujtojnë!
Ardhi dita pra të zgjohesh,
Si më parë ti të çohesh,
Burrat, trimat duk' i mbledhur,
Gjith me armët mi krah hedhur;
Të përpiken, të luftojnë,
Shqipërinë ta shpëtojnë;
Zgjedhen, turpin, që po e mbajnë,
Posht' ta hedhim, ta çpërlajnë,
Sepse turp është një shërbesë
Për atë q'e mban me besë.
Ashtu pra emrin pagëzoje,
Jepi famë lartësoje,
Dëfto botës pa të druhesh,
Do se i Bardhë, i Zi quhesh,

Se, lavdim për të fituar,
Koha edhe më s'ka shkuar,
Po sot dita, Drin, të ka ardhë,
Prap të dalësh faqebardhë!!

1912

ARDHI DITA

Ardhi koha, ardhi dita,
Iku nata dolli drita!

Ngrihi trima mos përtoni,
Këtë kohë ta shpëtoni!

S'është mjaft sa duruat
Edhe ter'ato që vuat?

Eshtë turp për emrin tuaj
Të mundohi për të huaj!

Qitni pallën, si ju dini
Edhe kordhën në e kini,

Me gjith zemër e pa ndjesë
Bini qenit të pabesë!

Mjaft me robënë të çjerë,
Mproni vatrën, mproni nderë!

C'mbani duart si të thata?
Nxirni shata edhe shpata,

Ferrat, gjemba i qëroni,
Lule të mbijnë në doni!

Për trima ju trima jini,
Këtë dhe ju vet' e dini!

Po ç'dobi ësht për atdhenë
Kur s'ësht ashtu si ka qënë?

Shqipérinë ju në doni,
Nga kët rezik ta shpëtoni,

Kryet ngrihni, zgjedhën shtini,
Pastaj lumtur¹⁾ që të jini!

Në jini ju atdhetarë
Dhe thjeshtë shqipëtarë,

Bënie ju sot atdhenë
Siç qe nënë Skënderbenë!

1901

1) lumtur = të lumtur.

MJAFT!

Shqiptar mos vono po ngrehu.
ji gati,
se tashi

Për shpëtim të thëret atdheu!

S'u ngope shqipëtar që ri
i çveshur,
i ngjeshur
Ndë vojtje edhe shtyrani?¹⁾

S'të tundet zemra jote fare,
kur shëkon
e dëgjon
Për humbjen tënde kombëtare?

Shëkon se armiqtë nuk rinë...
po flasin,
të kllasin
Ndënë zgjedhe sot Shqipérinë!

1) shtyrani = tirani.

Ti ku je, ku 'shtë trimëria,
që thua,
se s'dua,
Që të humbasë Shqipëria?

Kërkon të rëfesh me të kota,
se je trim,
për lëvdim?
Po veç me fjalë s'trembet bota...

Sot kombet qi ty të rrrethojnë
s'të njojin,
s'të shohin
Dhe kombësinë ta mchojnë.

1904

BALASHIT

O balash o bukuresh,
Që je trim si një fatosh,
O dragua kali jim,
Që po pret me padurim;
Në ke mall për Shqipëri,
Ngjeshu kalë, ji gati.

Shih sa vënt plot bukuri
Ku del ar, ku del flori,
Ku ndrit dielli me shkëlqim
Dhe qesh hëna me pëlqim;
Si në vënt të prallave,
Trimave dhe pallave!

Ku një pyll, ku një mburim,
Male e fusha pa mbarim,
Me lëndina plot magji,
Ku dreth këngë trimi i ri,
Ku del zana për mëngjes.
Lule thurur gjer në bres.

Shpjermë, shpjermë o balash,
Si hark rugën drejt ta mbash;
Çili këmbët mos u-dro,
Shkëmbinj, kodra m'i kapto,
Malit lart t'i ngjitemi,
Jemi trima e s'vritemi!

Tin' i shpejtë plot fuqi,
Unë burrë trim i ri,
Kur armiku ne na del,
Shqipërinë për m'e shkel,
Si luan t'i hidhemi,
Prej tij ne mos dridhemi!

Si shqiponjë me thonj, krah'
Prej zemrimit zjar që ha;
Si rrufeja sa me shpejt
Balash derdhu atje drejt,
Ta rëzojmë posht mbërdhe,
Më mos shkelë ndë atdhe.

Sepse armiku ku u bë hi,
Atje lule ka me mbi,
Dhe, ku këmba na ka shkel,
Trëndafil ka m'u çel;
Pika e djersës ku q'u derth,
Kurrë bari s'ka m'u-mverth.

Faqebardhë që të dy
Do të jemi për çdo sy,
Kur të shohin më çdo mur
Një shqiponjë një flamur
Dhe të thonë pa kujdes:
Shqipëria kurrë s'vdes!

KËNGA E BASHKIMIT

Ardhi dita e lirimit,
Dita e bukur e bashkimit!
Mblidhuni o shqipëtarë,
Qytetarë e katundarë,

Këtë ditë të shënuar,
Që prej zotit është bekuar,
Në ta lusim, ta nderojmë,
Jetën tonë ta gëzojmë.

Eja gegë këtu pranë,
Qasu, qasu porsi zanë,
Dorën zgjate me dëshirë,
Si një burrë i pavdirë.

Gegë, toskë vllazën jemi,
Të dy bashkë një emër kemi
Dhe një fat në këtë botë,
Shqyptar' jemi fjala thotë.

Prej një nane jemi lerë
Mysulman' e të krishterë;
Më një djellë jemi ritur,
Si dy lisa pranë ngjitur.

Të dy kemi një dëshirë,
Se një sisë kemi pirë;
Një të qeshur, një të qame
E një zëmër të pandame.

Prej Viose gjer te Drini
Mos na ndajë dot Shkumbini.
Porsi vllazën na të rrojmë
Dhe Shqypninë ta forcojmë.

Se Shqypnia është besa,
Nderi i ynë,jeta. shpresa,
Besën tonë pra ta mbajmë,
Kurrë armiqtë mos na çajnë.

Veç si burra pa një drojë,
Si ndë luftë edhe nevojë,
Tërë bota ka me ditur
Se na s'jena për t'u-shitur.

Po të fortë e të bashkuar,
Kryelartë e shpirtnituar,
Të gjith kena m'u-përpjekun:
Për Shqypninë sot me vdekun.

ZANI I LAHUTËS

(fragment)

Zani ambël i lahutës,
Ky asht kanga e Malësis,
Porsi e krismej' e asaj hutës,
Qi ashtë kanga e trimëniis.

Rotull malet gjith buçasin,
Kur lahuta ze gjimcn,
Pyllat, kcdrat sikur flasin,
Zani i bukur kur tingllon.

Ay za q'e ban shum' herë
Zemrën tonë me lotu,
Dhe r:a lotet tuj i nxjerrë,
Ndjejmë shpirtin të lehtsu.

Asht nji kang' e mallëngjyëshme,
Q'asht derguë prej Perëndiis;
Si nji dhunti e hyjnyëshme
Për gazmend të djelmëniis.

Si ndë luftë tek ushtari
Me hov hidhet tuj këndu,
Ashtu bujku dhe tregtari
Gjith me kang' ven' me punu.

Blegtoresha dhe barija

Në atë kohë të djelmnis,

Asht lahuta dhe burija

Q'u ndes zjarmin e dashtnis!

«Nana tuaj, nana e ngratë,

Qi me kangë ju ka rit,

Djelm, prej jush dit' edhe natë

Ah, nji kang po asht tuj e prit!»

1910

POSHTË ERËSIRA!

O Shqipëtarë pse rini si të ngrirë?

E c'prisni ju vallë, ashtu si të mpirë?

Lëvisni këmbë, lëvizni edhe duar

E mos kërkonи të gjeni gjë të shtruar!

Ju fshatra edhe qytete vallë c'prisni?

Pse nga erësira ku jini s'lëvisni?

Dritë, liri, qytetëri ju kërkonи!

Duart ato u zgjatin, pse s'i vështron?

C'është ky gjum'i rëndë që ju ka zënë,

Që s'ju le të hapni sytë, c'domethënë?

Shqipërisë varrin pse vet' ja rrëmoni,

Po nga balta, ku ka rënë, s'e shpëtoni?

Vallë nuk' shihni rrctull kombet e tjere,

Qi kanë qënë gjithë si ju të mjerë,

Lirin' e tyre që të mos e humbasin,

Armiqtë mu në fund të dheut i kllasin?

Vallë ku e kini atë trimërinë,

Që lëvdohi aqe, për ate Perëndinë?

Ju qi për të tjere fare s'e kurseni,

Pse atdhen' e lini t'vuanjë si qeni?

S'kini turp, Skënderbejnë kur e kujtoni
Dhe gjak' i tij në rëmbat u rjeth të thoni?
Si? ay sa rojti Shqipëria ish ndë dritë
Edh' ay që kur vdiq u-bë më këtë ditë.

Si, Shqipëria edhe do të rënkonjë,
Edhe shumë kohë me sy do të shëkonjë
Bijt' e saj, me thonj e me dhëmbë ta çjerin
Edh' atë frymë q'i mbet fare t'i a nxjerin?

O juve kordha edhe palla ku jini,
Pse atyreve që ju mbajnë s'u bini?
Juve, armë të fajkuara, ç'u-bëtë?
Pse s'i dërgoni edhe ju n'atë jetë?

Tundi o brigje, tundi edhe ju o male!
Edhe ju re pse tundi ashtu ngadale?
Rufetë çarkoni, shkëmbenjtë çkallmoni,
Përmblithni zuzarët edh' i qëroni!

Më nj'anë fetë, besët edhe tradhësia,
Më nj'anë gjaku edhe harbutësia.
Posht' erësira, posht' edhe robëria,
Roftë bashkimi, roftë vëllezëria!

Gegë, Toskë, ziruni dorë me dorë
Edhe lirinë shtinie mi Tomorë!
Gjakun pse vallë ju e kurseni aqë,
Kur pa gjak mundni ta fitoni sa kaqë?

Në e lënçi atdhenë në këtë ditë,
Mallëkim do t'mbetet mi ju e mi bijtë.
E nga faq' e dheut fare në u shoftë,
Ahore dheu u hapt' e u mbuloftë!

1901

PALLA E SKËNDERBEUT.

Trimëria e Skënderbeut,
Qi qe dëgjuar n'anët e dheut,
Kish frikësuar turqit téré,
Që s'dinin se q'qe për të bërë.

Për këtë punë Sultani mentoj
E ca njerëz të zgjedhur dërgoj,
Të cilët, pas urdhërat q'u kish dhënë,
Të venë të shohin Skënderbenë.
T'i shohin edhe pallen të lëvduar,
Me të cilën kaqë lufta kish lëftuar.
Vallë çfarë do t'jetë kjo pallë,
Që s'i la asnjë ushtetar të gjallë?
Këta ndë Shqipëri posa vanë
Edhe Skënderbenë si ç'e panë,
— «Nga mbreti, thanë, jemi dërguar,
Që të shohim pallen aqë të lëvduar.»
Rreth e rrrotull mësalles ku rinin,
Nëpër tërë anët sytë po i shtinin.
Panë roba, panë armë të arta,
Panë kordha edhe palla të zjarta,
Po pallen të dëgjuar nuk' e njihnin
Edhe në vent nuk' u vinte të rinin.
Po trimi ngrihet e pallen mer në dorë:
— «Dilni jashtë pakë, thotë, o të gjorë!»
Jashtë posa duallë, me çudi panë:
Një kalë që qe lidhur atje pranë,
Skënderbeu afrohet, e me pallën që mban
I bie kalit, e që nënë bark e sipër më dysh e ndan.
Këta këshfu si pañë u hoqnë gjer në mur,
E atje mbetnë në vent posa një gur.
Pastaj i qasen Skënderbeut pranë,
Që ta pyesin për tërë ato që panë.
— «Çfarë qenka, thanë, kjo palla jote,
Me aq' trimëri që na rëfen zotrote,
Kur mbreti yn ka t'artë t'ergjentë,
Të mveshur gjith me gurë të shtrenjtë.
Palla tij që lufta që gjëmon
Edhe qytete të mbëdha që dërmon;
E kio aq' e rëndë e aq' e gjatë
Munt të luftonje me 'të dit' e natë?
Po trimi përgjigjet e u thotë urtë:
«Vin' i thoni mbretit t'uaj zemrëgurtë,
Se s'pret palla q'ësht një hekur i dheut,
Po pret dor' e fuqishm' e Skënderbeut!»

LARK VATRËS

Ku vete o burrë, ku shkon?
Ku le prindër, ku le atdhe?
Prapë më s'sheh, fare s'gjykon,
Po ikën, sikur mëndje s'ke?
Ku e shuan djalërinë,
Që mjeron vënt e shtëpinë?

Mbë ç'anë ndjenë embëlsirë
Dhe ka më tepër bukurë?
Ku shëndrit djelli më mirë,
Se sa këtu ndë Shqipëri?
Ku gjen male me aq hije
Dhe aq mburime me shije?

Ç'pëlqim, ç'dashuri atje gjen,
Ku nuk të peshon as njeri,
Ku durim' e vojtje çfren,
Dit e natë s'ke qetësi?
Apo ron veç për pak fitim,
Si bagëti veç për ushqim?

Ku janë lotët që t'ramë
Atdhe, prindër ti kur i le?
Si? ato shkuan e vanë,
Pikë gjak ndë zemër s'ke?
Nuk të valon ajo pakë?
Më s'ndjen ti gjë, më s'ke flakë?

Harron vënt, harron dhe shtëpi,
Ikën e më s'dukesh fare
Veç me mëndjen për ca flori,
Vet' e dergjesh si ndë varre?!
Djalërin' e shuan e shkon
Dhe vëndin tënt ti e shkreteton?

Harrin, o harrim i shkretë
Ti i bën gjithë zemrat gur!
Ti ndan njerinë për jetë
Edh' i ri përpëra si mur!
S'e le kurrë të menjtohet,
Se lark shuhet e shkretohet!

Ti, moj Shqipëri e mjerë,
Sa durove e sa duron,
Bijtë q'i kishe një herë
Sot për sot më kot i kërkon;
Se të sotmët të harruan
As s'të njohin as s'të duan!

Vuaj sa munt moj e gjorë,
Besë, shpresë fare mos ki,
Se sot s'gjendet ajo dorë,
Siç qe, të t'bëjë përsëri.
Se bijt' e tu ^{jan'} verbuar
Nga çarja ¹⁾ q'i ka pushtuar!

Ca nga feja dhe padija
Kanë rënë ndë gjakësi,
Të tjerë nga marësija ²⁾
Lenë prindër edhe shtëpi.
Shkojnë, ikijnë, botën zënë,
Kur të zbathur, kur të pa ngrënë.

As zgjohuni mor të mjerë
Dhe mblidhuni prap' nd'atë vënt,
Mos për botën, për të tjerë,
Mos punoni kështu pa mënt.
Po vatrën tuaj kujtoni,
Mos e lini mos e shkrettoni!

Turp për një komb të këtillë,
Të mos jet'i zoti për 'te,
Kur të tjerë pa këshillë
I mburon ³⁾, pa të shohë gjë,
Dhe veten fare s'e shëkon,
Po më kea e prish, e dërmon!

1904

1) carja .. përcarja.

2) marësija = marrëzia.

3) kur të tjerë pa këshillë i mburon = kur të tjerët (kombet e tjerë) pa këshillë (pa patur nevojë për këshillë, për nxitje) i mburon (i pasuron, bën që atje t'u broje lirija, pasuria.)

D H È M B K È

Që vjete i larguar
o i dashur atdhe,
Kurrë s'të kam harruar,
se shum' i ëmbël je.

Zemra gjithë më këndon
për ty o Shqipëri,
Po më tepër më lëngon,
se je në vobësi.

Ah! sa hidhëime ndjenj,
o i bukurë vënt.
Hirë as gjëkundi s'gjenj,
kur tynë të përmënt.

Të falura të dërgonj
që këtu o atdhe.
Dhe gjithënjë të kujtonj,
se bir ti më ke.

Për ty shumë më vjen keq
o i mjerë atdhe,
Pra mëndjen teje s'e heq,
se zemra nuk' më le.

1904

KOSHTUTA... NË SHQIPËRI¹⁾

Një diell i ri na thonë se po lindi,
Një dit' e re u-çfaq pér Shqipérinë,
Dëfrim pa shembëll ra mi njerëzinë
Dhe drita erësirën, thonë, e bindi.

1) Koshtuta = kushtetuta. Siç dihet, triumfi i revolucionit borgjez turk në vitin 1908 përfundoi me shpalljen e një kushtetute, që, veç se nё mbështetja kryesore e këtij revolucioni, liri politike, liri pér të zhvilluar kulturën nacionale, të drejta të barabarta më të gjithë kombësítë e perandorisë turke, të drejta demokratike etj. Sigurisht që i tërë populli shqiptar, që vuante prej shekujsh nën autokracinë e sultanicë, e priti me bëzim të madh shpelljen e kushtetutës. Por, nuk shkoi gjatë e borgjezia

Shëkoni si shkëlqen, si dheu i tërë
Përtrin kudo me lule e gjelbërimë;
Katundet e qytetet plot gëzime...
I qofshin falë zotit q'i ka bërë!

Kudo vështron, një gas i ka pushtuar
Të gjithë. S'mbeti vënt, ngado këndime;
Lahurat e gënetat plot tingllime
Ndë qiell të ngreh; se ç'koh' e mot i uruar!

Të lumtur jemi, se na erth kjo ditë,
Që kurrë ne s'e prisnim, thom, për besë,
Lum kush ka jetë, lum kush s'do të vdesë...
Lum kush i ka të forta mushkëritë.

Sa mirë vemi, gjithë përparime
Vështrojmë, tërë viset si po qeshi,
Sa janë ndë natyrë roba mveshin;
Sa shohim rotull, jo, s'janë èndërimë!

Po, koha e artë ne na e mpshtolli jetën.
Me dituri, me mjeshtëri sot rojmë,
Pa një kujdes ne ditët gjith po i shkojmë;
E drejta u-bashkua me t'vertetën!

Më kot nuk' u-munduam, hapëm udhë
Fituam një kurorë si të rallë...
Të gjithë me gas na puthnë faq' e ballë.
Një punë, po, si e vjetër por... methudhë!

Vërtet se ne punuam me një besë;
E vumë krahun, derthmë gjakun tonë.
Dëshira e vendit ish dëshira jonë,
Se s'di shqiptari ndryshe si të vdesë!

turke, që hypi në fuqi, filloj të dalë me fëtyrën e vërtetë antidekomratrike. Në vend të lirive me këmbëngulje një politikë shoveniste edhe më t'egër se përpara. Nga kjo politikë tradhëtare u indinjua i tërë populli shqiptar dhe udhëheqësit përparimtar të lëvizjes sonë nacional-çlirimtare e demaskuan kushtetutën e gjenieshtër turke. Asdreni i kushtoi kësaj ngjarje me rëndësi të veçantë këtë poezi të fortë, thurur më tepër në formë alegorike, ku sulmon me ironi t'idhë politikën shoveniste e armi-formë alegorike turke dhe cënon sedrën kombëtare të bashkëatdhë-qësore të borgjezisë turke dhe cënon sedrën kombëtare të bashkëatdhëtarëve të vet, që gënjen me lëvdatat e premtimet e armiqëve.

Po një zakon pér vet' e ka shqiptari;
Me lajka ay gënjehet — foshnjë e mitur —
I mëngëm bëhet, mbahet si m'i ditur,
Nër kombe thotë, se na qënke i pari.

Të tjerët, sa që ay i gjen se janë
Të fundit, kohë s'kan' ata t"mendojnë,
Po hedhin çapin dhe përpara shkojnë,
S'ushqehen me «pilaf e me trahanë!»

Shqiptarit s'i pëlqyeka lëvdata!...
Përveç bën miqësi me çdo të huaj.
Vëllamë bëhet, shpirtin jep po thuaj,
Po fundi? Mbet me duartë të thata!

Kur hëna s'ish, na thotë vjershëtori,
Shqiptari ishte! Me t'u-bërë dheu,
Të parën copë ay pra e rëmbeu.
Nuk' është prallë, ja ku flet Tomorri!

C'u-bë ky vallë? Aqë shekuj rothnë,
Të vdekurit u-njallnë, rojn' e janë;
Fuqi, vullnet të fortë ata sot kanë
Shqiptarit, si? virtyte nuk' j' u-ndothnë?

Vërtet kështu kjo munt edhe të jetë:
Të gjitha mplaken, vdirren pa dhe treten;
Vec thrime, gjyrma e shtrembësira mbeten:
Natyra është pasqyra e vërtetë.

... Po një ndryshim është si çudi mos mbeten: :
Të Skënderbeut kush mban hajmalinë,
I trashëgon, si ç'thonë, trimërinë.
Pra duket se s'e vdirin kurrë vjetet.

I mjerë atdhe, ti Shqipëri e bukur,
Që die posht' e shtrirë psherëtinje,
Luan i përgjakosur, kryet s'ngrinje,
Fytyra madhështore t'ishte e çdukur!

Pluhur' i zisë, nata t'kish mbuluar.
Tirani i lik s'të linte as të ngrihesh.
E lidhur, e përbysur, pa të njihesh,²⁾
Një trup me shpirt, pa këmbë edhe pa duar!

Durove, u-lëkunde posht e rzove,³⁾
U ngjalle por si trimëresha e prallës,
Me një rëmbim, një mbyllje të qëpallës
Këpüte hekurat, gjallimn' e ndrove.

Po sa prej një tirani ti shpëtovë,
Mezi shkëlqyen rezet e lirisë,
Atë liri mi trup të trimërisë,
Që ti me gjak e mprojte, e pagëzove,

Të tjerë t'ardhur s'di se ku nga ç'anë,
Të mveshur me lëkurë dele-butë,
Me ndjenja t'egëra porsi hajdutë,
Me lajka, me premtimë ndenjnë pranë.

Nevojë kishin sipër sa të dalin
Dhe si shpirtliq ty çpagën që të japid...
Një grusht mi qafë, burgjet po t'i hapin:
Atje ti ke të drejta... tek t'i falin!

Të drejta? oh, vërtet këto q'i japid
Kujtdo të ardhur, kujt q'u zgjati dorë.
Ty pa mëshirë të ndjekin si mizorë.
Si komb s'të njohin, ty të kllasin drapin.

I varfër popull kurrë nuk' t' pyesin,
Në je i ngrënë apo në je ti i mveshur,
Në syt' e buzët ty të kanë qeshur,
Fëmijt' e tu për bukë n'mos të vdesin.

Paguaju me gjakn' e djersën tënde,
Puno, se ti ke forcë, je i trashë.
Ti jetën nuk' e shkon me them e thashë,
Ti je si bagëti në t' tuat vënde.

2) Po të njihesh = e pamundur të njihesh.

3) posht e rzove = posht e rézove (regjimin autokrat të Sulltanit).

Ty shpinën le ta pjekë vap' e diellit,
Ti derdhe djersën të vesojë dhenë,
Më gjunjë, kryet unjur mbaji frenë,
Se ky për ty ka mbet bekim i qellit.

Një varr për eshtrat tua nukë ndodhet,
Të shkretat tin' i ke ngado lark lenë,
Ty veç se arratisë s'të është dhënë
Dhe trupi i yt pak vënt s'ka ku të çlodhet.

Të huajt shih si po t'qytetërojnë,
Kudo po çelin shkolla diturije,
Nër gjithë viset ruga tregëtije;
Ndë Lindje Perëndimin po e çojnë.

Ndë gjuhë tënde folë e shkruaj shumë.
Për qìll, për yj, për dhenë sa të duash,
Po për të tjera mos e zgjat, ta ruash,
Se ja gëershëra, thonë, dhe... ndë lumë!

Si jo? një komb fatbardhë ne po jemi;
Kur lypim dituri, na kthejnë krahtë;
Donje të drejtë?... koha është e gjatë.
Po thamë gjë... përpara topnë e kemi.

Po kur ze qìlli nxihet, reht' gjëmojnë,
Kur vjen furtuna q'e përbys e dheun,
Rëkeja valë vjen t'qërojë «plehun»,
Rufetë kur kërcasin derpëtojnë,

Reziku, thom, kur vjen e i bie derës,
Kur shohin se më s'kanë nga të dalin,
At' here ty «të dretja» po, të falin....
Po kockat tin' i le në funt t'skëterrës.

.....

«Mos na trazoni farë e fis i ndyrë,
Që s'latë vënt pa prishur pa shkretuar,
Se bota gjer më sot në u ka duruar,
Këtë na e kini neve ju detyrë!

Besoni shpirt se s'kemi vdiqmë fare,
U-shuam, zemra jonë u bë si guri;
Shqiponja u-plagos, u-tret flamuri
Dhe ju na ndehni dorën gjakatare?

... Mos arthtë ora, mos e sjellçin vjetet,
Se ne, po i tundmë shtyllat e shtëpisë,
Të kllasim zjarr, të bëhet hi edhe pisë...
As ne, po edhe jush këmbë më s'ju mbetet!!

1912

T I N G È L L I M È

O, s'janë trimat, burrat që një herë,
Që ndridhej bota këmbën tek e vinin,
Luanë jishin, frikë kurrë s'dinin,
Armikun s'e peshonin asnijëherë.

Kur flamuret valonin nëpër erë,
Me këngë, me kurorë ku që vinin,
Me lule rugës, radhë t'gjith u-rinin,
Si mundësve, ushtarëve me vlerë.

Po sot mjaft shekulla, mjaft vjete shkuan,
Të ndryshkura si palla, thika e shpata...
Ku duhet me s'përdoren, u-harruan.

Atdhe! mëkatet nuk' të janë sosur!
Duro, ti ditët mjaft i ke të gjata...
Se sot shqiponja kraht' i ka plagosur.

1912

TINGELLIMA

I.

Pse gjethi e trëndafili mbajn' aq' erë
Dhe lulet pemve çfaqen me aqë hije?
Pse vesa ndrit si lot sy perëndije
Dhe qelli buzëqesh me gas të ndjerë?

Zefiri ç'ka që kraht' i tunt pa prerë,
Muzikë krejt hyjnore lark që bije?
Ç'ka drita tej që po èndet fije-fije
Dhe syri i ditës s'mbyllët që të flerë?

Cudi, magji apo mrekulli èshtë vallë?
Të gjitha reth që ngjallen, qeshin bukur!
Mos èshtë tjetër botë, një èndrë a prallë?

Jo! tingëlli si i harpës së Orfeut
Dhe bota me shkëlqim më èshtë e dukur,
Se ndrit... fytyra e Bukurës së Dheut!

II.

Pse malet gjith buçasin, ulërijnë,
Posht tundet dheu, vollkanit si i shtyrë?
Pse kodrat duken të ashpra në fytyrë
Dhe pyjet tmeri dridhen, pshërtijnë?

Pse rehtë lart përpiken, çkrepëtijnë
Dhe perëndimi gjakut mer tej ngjyrë?
Ç'ka botës gjith kjo zi që i ka hyrë
Dhe diellit vetullat si nat' i nxijnë?

Mos èshtë luftë ku armët pa mëshirë
Përpiken, kryqëzohen si rufera?
Mos èshtë natë e dita më s'ka gdhirë?

Jo! s'është as kushtimi i Odhyseut,
Nuk' ësht as luftë as Ferri, as Skëterra,
Po vdes... luani i ndjerë: Trimë i Dheut! ¹⁾

1) trimë i dheut = Skënderbeu.

ZËRI I KRYENGRTËS VET¹⁾

(Shqipëtarëve të pasur)

Ne s'duam paqen, prehjen që t' j' u prishim,
Ne s'duam të na i falni pasuritë,
As dorë s'zgjatim — lipës, s'e durojmë —.
Në luftë që të veni na s'ju grishim,
Të lini lark dhe shtëpitë;
Asgjë për veten tonë s'u kërkojmë,
Asgjë nuk' duam nukë,
Veç armë edhe ca bukë!

Me kryet lart në zjar të luftës vemi
Dhe gratë rrokin armët na gjyrmojnë;
Me gas e derdhim gjakun për lirinë!
Rezikun s'e peshojmë ku që t'jemi,
Prej zë trumbetash malet kur gjëmojnë,
Të shkret' e lemë vatrën e shtëpinë.

Ju gjë s'u duam nukë,
Veç armë edhe ca bukë!

Esht turp për ne t'i zgjatim botës dorë,
Detyrë kini ju të na ndihmoni.
Në i kini dhembje vetes dhe atdheut.
Ne s'druhemë nga breshër, shi, apo dborë,
Po kurdoherë ju që të kërkoni,
Një tingëll armësh del nga faq'e dheut.

Pra gjë nuk duam nukë,
Veç armë edhe ca bukë!

Vellezër, prej një nëne jemi lerë,
Po fati na ka lidhur pran' t' i mbësim,
Ta shkojmë jetën tonë me durime,
Me jersë, të vështira dhe të mjerë;
Këtu në malet lart në do fë vdesim
Për rojtjen tuaj, jetën plot pëlqime.

Asgjë nuk duam nukë,
Veç armë edhe ca bukë!

1) Më 1911, në valën e kryengritjes së veriut, Luigj Gurakuqi kputet fill nga Komiteti drejtues i saj, që e kishte selinë në Mal të Zi dhe vjen në Bukuresht, ku hap një fushatë ndihme për kryengritjen ndër shqiptarët e Rumanisë. Siç duket në fillim kjo punë nuk pati shumë sukses, sepse tregëtarët e pasur shqiptarë nuk dhanë gjë. Poeti i inatosur, thuri këtë poezi, që u shpërnda si fletë volante dhe bëri që të shtohen ndihmat në 14000 fr. (informacion gojar nga L. Poradeci dhe M. S. Curra).

Ju rroni nér shtëpira plot shkëlqime,
Nuk dini vojtje, lote edhe kujdese;
Të çveshur si ne, pak sot munt që tjenë.
Si ju s'ë shkojmë jetën me défrime,
Po njerës jemi gjith t'asaj krijese;
Për nderin, vatrén, kombin edhe atdhenë:
Asgjë nuk' duam nukë,
Veç armë edhe ca bukë!

Shtëpi ne kemi shpellat, vrimat, malet;
Nesh rotull gjith armiq e tradhëtorë,
Pa vetëdijë, njerës të pa besë;
Një ergjendit, arit tjetër sot i falet.
Kush helmin t'heth, kush shpatën mban në dorë
Dhe kush vëllan' armikut do t'ja shesë.
Për zotin, s'duam nukë,
Veç armë edhe ca bukë!

Kur flamuri kuq-zi bën vala ngrihet,
Shqiponja me dy krerë kur del ballë,
Kur dridhet toka, topat kur shëkojmë,
Asnjë prej nesh at'here nukë mfshihet,
Po flamin, të vdekur a të gjallë,
Me radhë do të bijem, ta shpëtojmë!
Pra mos na lini nukë
Pa armë edhe pa bukë!

Këtu pra njihet vlera, trimëria;
Këtu rëfahet forca e kombësisë.
Se ne me t'u-bashkuar tundet dheu, —
I thyet çdo armiku gjith fuqia;
Çel trëndafili i bukur i lirisë,
Përtrihet kombi, ngjallet Skënderbeu.
O, gjë nuk duam nukë,
Veç armë edhe ca bukë!

Kujtonani me ç'kini pra të tepër.
Ne derdhim gjakun lumë, ju veç pasje.
Ne vdekje tmeri presim, ju veç rojtje!
Se me theror fitohet sot çdo vepër,
Me njerëz bëhet themeli me çdo rasje.
Pra fshihnnani sot lotët plot me vojtje,
Se gjë nuk duam nukë,
Veç armë edhe ca bukë!

C'na duhen krahtë dot kur s'i përdorim,
C'na duhet jeta, robër gjithëmonë,
Kur s'shohim diellin, dritën e lirisë?
Pra hënën, erësirën që ta çporrim,
Të ngjallim kombin, farën, fisin tonë,
Për nderin tuaj, nder' e Shqipërisë,
Gjë tjatër s'duam nukë,
Veç armë edhe ca bukë!



KRERËVE TRADHËTORË

Ju njohim cilët jini, s'është nevojë
T'u hapet Libri i veprave të bëra,
Se populli i përmend papra me gojë;
Me kut i mat, me syt' i sheh të tëra.

Se ç'farë shëmbëlltyrë t'ju përqasim
Me ç'emër botës mundim t'u tregojmë,
Ne, kot si trut' e mendjen do t'i vrasim,
Me juve, e dimë, kombin turpërojmë!

Si ferrat jini, jetën q' e ndalojnë.
Çdo bim' e lule e mbytni ndënë gjëmbat,
Sa as dritë, as diellë më s'shëkojnë,
As gjaku s'u levrin në dejt' e rrembat!

Si bisha e malit, gjahut kur i derdhi,
As gjurmë më s'i mbetet në ka rrojtur;
Mëshirë s'kini, drojës ju nuk mverdhi
Për shpirtet, jetën që u a kini shojtur.

Si mjer ata që presin dorë ndihme
Prej njerës pa mëshirë Perëndije;
Si mjer ata me djersa edhe mundime,
Kështu që shohin çase lumërije!

Ju s'kini as shpirt as zemër dhembje s'ndjeni,
Përpara jush kur krah' e duar ndehen,
Fytyrën, sytë më nj'anë i u a ktheni
Atyre shpresës suaj që ushqehen.

Sa lot nuk janë derdhur pa shtërruar,
Shtëpi, sa s'kanë mbetur sot të shkretë;
Sa zemra s'psherëtijnë sot pa pushuar,
Therror q'u ranë krejt nën'thonjt' e mprehta!

Mëkatet shpinës, shpirtit që i përmbari,
As posht në Ferr pak vent s'ka që t'u nxerë;
Me ujt' e detit dot nuk i çpërlani;
Mallkimi do t'ju ndjekë gjat' e gjerë!

Prej gurit zemrën ju sikur e keni,
Që as pak s'e ndjeni qarjen e rënkimin;
Ju ligësit' e fajet s'munt t'i mfshehni,
Çdo e keqe këtu posht e ka çpërblimin.

E lumturështë pér besë Shqipëria!
Ka kryesi, në botë si s'ka tjetër,
Një rregull e ka lënë Perëndia:
Çel një kries' e re prej një së vjetër.

Përdhe u-shtrinë shtyllat e mermarta,¹⁾
Prej rënje u prenë lisat madhështorë.
Më vent të tyre hije ka të tmerta
Dhe mi rënimet ngrihen shpirtmizorë.

U-shuan yjtë rrugën q'e ndritonin,,
Sa udhëtarë më s'ka se ku të prehet,
Shtëruan dhe mburimet që kullonin;
Çdo pemë që çel, helm e hidhur bëhet.

Sot zëri i fortë i luanit²⁾ më s'dëgjohet,
Që malet i përcante si gjëmimi;
Por zë bretkosash³⁾ posht prej pellgu çohet
Si këngë zije, këngë robërimi.

1) Këtu dhe në dy strofat që vijnë pas, Poeti shpreh me figurë idenë se parësia e vjetër, e kohës së Skënderbeut (të cilën ai e çmon shumë, se ka udhëhequr popullin shqiptar në luftën pér liri), tanë është çdakur dhe parësia (kryesia) e sotme e Shqipërisë s'ka të bajë me të vjetrën, kjo është degjeneruar, bastarduar.

2) I luanit = pér Skënderbenë.

3) Zë bretkosash = zëri i parësise së sotme.

Mjaft, mjaft! se u mbush kupa e hidhërimit!
Gjerprinj pushoni! helmin tej e çporrni,
Mos dalim tej kufirit të durimit:
Që më në fund se ç'mbuallt ju të korrni!

1912

ÇPËRBLIMI¹⁾

«S'jam lipës, as i humbur e i pa besë,
Në jam pà roba, shorti ma ka thënë;
Por unë gjithënjë kështu s'kam qënë.
E patë, trimërin' e kam dëftesë.

Luftova, gjakn' e ërdha pa përtuar;
Rezikun e ndalova, mbajta «valën».
Ma zgjattë dorën ju, ma dhatë fjalën:
Pra vij të ndajmë gjënë të fituar!»²⁾

«Kush është ay që sot kuxon pa leje,
Që paqën na e tunt, na sjell ngatrime,
Na prish dhe prehjen, jetën plot dëfrime,
C'kërkon këtu i bir' i asaj së veje?

O, nxireni, të hyjë mos e lini,
Të çporret! është rob e s'munt të flasë;
Me shqelme biniji, le të pëlcasë.
Me grusht, me fishkull shpinës, posht' e shtrini!

1) Tëdeja në këtë poezi nuk del fort e qartë. Por, po të futesh në mëndimet politike që kishte Asdreni gjatë kësaj periudhe, kjo poezi qartësohet. Vetë titulli «Çpërblimi» përmban konkluzionin e poeziës:

Vegjelia, që vojti shtypjen e egër të shkelësit turk dhe po shkrihet në luftë pér lirin e Atdheut, mbas çlirimt të Shqipërisë nuk do të shpërbleshet, nuk do të fitojë gjë, se prap mbi ta do të vendoset pështeti «gjakatarve të téré kësaj bote» d.m.th. i parisë, i aristokracisë, që do të vendosë regjimin e shtypjes e të terrorit.

2) Deri këtu flet përfaqësuesi i vegjelisë, i cili kërkon të drejtën e saj për të marrë pjesë në pushtetin e Shqipërisë së nesërme të çliruar.

Rrëmbejeni, se vjen lart na bën hije;
S'na njeh si zot, u-ngrit si valë deti.
Dhe cili i pa mundur ne na mbeti,
Që me rëmbim luani thonjt na i shtie?»³⁾

.....

.....

Një dit' e zezë ishte duke u-gdhirë.⁴⁾
Lart qielli i kaltërt ishte bërë sterrë.
Në gjinjt' e mëmëve fëmija e mjerë
Purtekë dridheshin me gjak të ngrirë!

Buçisnin malet, pushkat po kërcisnin;
Ushtarët shtijnin, gjaku lumë derdhej;
Përpjetë flakë ngrihej qielli mverdhej;
Siç duket se pa shëmbëll gjëra ngjisnin.

Përse kjo gjëmë, q'faj o zot çpérblinin
Të mjerët, bukën që mezi e shëkonin,
Që s'dinin se ku shkelnin as ku ronin
E pa mëshirë togje dheut po binin?⁵⁾

Në dhe të tyre, t'huaj ishin vallë?
Të drejtë të mos kenë atje ku rrojnë,
Po për të tjerë djersat t'u pikojnë;
Mos shohin lumëri sa janë gjallë?

Malikim prej Perëndije kjo do t'ishte,
Mëkat i prindërve q'i kishin bërë...
Më çdo vënt tym, shtëpitë binin sërë:
Mëshirë, përdëllim gjekundi s'kishte,

3) Në këto tri stofa përgjigjet parija, që e ka kapur vetë pushtetin në dorë.

4) Këtu fillon përshkrimi i vuajtjeve dhe i gjakut që ka derdhur vebën dallim këtu midis shkelësit të huaj dhe feodalëve të vendit. Poeti nuk të dy palët, me të drejtë, në një kategorji, duke i cilësuar: gjakatarë të tërë kësaj bote, që, sikurse gjatë okupacionit turk edhe pas fitores së pamvatisë, do ta venë vehten në «majë t'Olympit», d.m.th. në krye të pushtetit e do të kënaqen me vuajtjet e gjakun e kësaj vegjëlige.

5) Kjo strofë në ligjëratë të drejtë, «Përse kjo gjemë? Q'faj o Zot shpërbolenin të mjerët, që mezi e shëkonin bukën, që s'dinin se ku shkelnin as ku ronin e pa mëshirë togje dheut po binin?».

Fëmijt' e gratë maj' syngjive ngrihen.
Më çdo dritare po pikojnë lote....
Dhe gjakatart' e tërë kësaj bote
Të dehur majë Olympit sot po shtrihen.

Gjer sipër era e gjakut, afsh u ngrihet
Dhe varret posht' u duken kopsht dëfrimi
Të ndehur «mundësit» mi fron shkëlqimi
Dhe rrrotull s'shohin kur u çfaqen hijet.

Prej gazit t'marrët duart po fërkojnë,
Me zemrën të kënaqur shohin varret....
Po s'dinë se edhe fati i tyre mvaret⁶⁾
Në dor' t'atyre që sot i shqelmojnë.

1912

LULËKUQJA....

Lulëkuqeja e mjera ~~u~~
Asgjëkundi s'ka shtëpi,
E shkon jetën nd'arrati.
Ajo s'është si të tjera,
S'ka stoli! → *s'ka te nire*

Fushës, ikodrës, del vetiu,
~~Vërës ngrohet, dimuit ngrin,~~ *te zire*
~~Vetë shkundet, vete mbin~~ *te falleze*
Dhe kur skuqet, vjen veriu
dh' e përfshin. *simbol*

Nëpër këmbë gjith e shkelin,
Vent në kopshtet ajo s'ka,
Dorë ndihme kurrë s'pa;
As e mbjellin, as e vjelin,
shkoj u-tha...

6) Me këto dy vargjet e fundit, Poeti shpreh bindjen e tij se, herët a vonë vegjelia do ta shkatërrojë pushtetin e parisë.

Po veg ngjyra e saj si zjarri,
Si një hyll që xixillon,
Tërë bota e imiton;
Është shenjë për së mbari,
nga shëkon.

Ajo ngjyrë kur ze çfaqet,
Mbreti fronë shkon e le,
Njerës robër fare s'sheh,
Vjen e drejta del në faqet:
si zot je.

Ajo ngjyrë nd'ato fletë
Është shpresa që tregon
Një të ardhme që ëndëron...
Është flamuri ynë vetë,
që valon!

1912

DËSHMORËVE TË KOMBIT

Për nder' e tërë Kombit, për atdhenë
Në luftë ranë trimat e vërtetë,
Që t'i këputin hekurat e frenë...
T'i sjellin përsëri liri edhe jetë.

Në botë m'i madh nder as munt të ketë
Për burrat lart q' e mbajnë fjalën, benë,
Se ata shtatuj' e tempull ngrehin vetë,
Me gjak kur skuqin flamurin e dhenë.

Në radhë të dëshmorëve shpirtet tuaj
Në prehje do të çlodhen gjithëmonë,
Si shenjtër drejt në gji të Perëndisë.

Edhe nga varret, sot q'i shkel i huaj,
Ka me shkëlqyer dielli i ardhmjes sonë:
Liria edhe përlindja e Shqipërisë.

1912

SHQIPËRIA U-LIRUA

Shqipëria u lirua,
Më çdo anë gazi ushton.
Me shqiponjat një pallua
Përmi flamur po valon!

Shqipëria u lirua,
Frej çdo vojtje sot shpëton.
Me shqiponjat një pallua
Lumturin' po i këndon!

Shqipëria u lirua,
Shqipëtari po feston.
Me shqiponjat një pallua
Sot mi malet po ndriçon!

Shqipëria u lirua,
Sot kur hëna perëndon,
Me shqiponjat një pallua
Reze t'arta po na çon!

Shqipëria u lirua,
Përparimi sot afron.
Me shqiponjat një pallua
Kryelartë i a kushton!

Durrës 22. Shkurt 1914

BURRI I DHEUT

— Djem o trima, burra lufte,
Mos m'a patë djalin vallë,
Çun sokol e trim me fletë,
Pamjeçelur e sygjallë?
Shtat të naltë, burrë mali,
Trëndafilë m'i kish faqet;
Vjet njëzet pothuaj kishte
Dhe pa dirsur as mustaqet;

Buz' e tija gjith me këngë
Në brez fyell, lule shkruar,
Më të qarë kur i a merte,
Kodrat ishin duk' ushtuar!
Malli i tija qenë malet
Dhe mburimet uj' ergjëndi,
Shtrat i tija qenë bjeshkat,
Shokë, lulet e çdo kendi.
Kur prëndvera hapte fletët
(Se prëndverë qe dhe vetë),
S'linte skaj pa mos e shkelur
Posht' e lart si shpes' e lehtë.
Për dëshirën e lirisë,
Që kur vendi zu të shkelet,
Në të parin zë kushtrimi,
Nisi enda që t'i çelet.
Për lirin' e vatrës shenjtë
Ku qe lerë, ku qe ritur;
Për vëllezër ndënë thundër
Mendja djalit i qe ngritur!...
Me ju bashk' u nis or burra,
Me ju shkoj që të luftonte;
S'kishte prehje s'kishte gjumë,
Shqipërinë gjith kujtonte.
Me fustanën porsi dhendër,
Dhe me gunën supit shtënë.
Pushk' e tija si një nuse
Dhe një flamur në gjit vënë.
As më thoni, bij, o çuna,
Në më rron a po ka vdekur?
Se prej mallit tij po tretem,
Se pér 'të në prush jam pjekur!
Veç atë kam prej sa patshë
Djal-zogë si pëllumbi,
Me thërime vet' e rita,
Që kur t'atn' e hëngri plumbi.
Kisha burrë si desh Zoti,
Burrë trim e zemërmirë.
Me nder rojti sa qe gjallë,
Po pat fundin të vështirë:
S'di qysh delja pat shpëtuar
Në një luath pér kullotë,
Kur shkoj murgu që ta zerë,
U dërgua tej n'at' botë.

Jemi bujq e truall s'kemi
Zotérinjt' e mbajnë frerin,
Prej lémoshés tyre rrojmë:
Ne me lot ata me nderin.

As shtëpija s'ësht e jona,
Kur u kënda jasht na qesin.
Për një dru në vatrat tonë,
Me të rahur shpesh na vdesin.

Me se rojtke, s'hapin fjalë,
Nga të vetsh, o bir, kur s'di nga?

Po një jetë plot mungesa,
Kur pa buk' e kur pa opinga.
Gjith si kokra vese dërsat
Nëpër faqet na kullojnë.

Tërë ditën shpinëthyer,
Punë, punë na kërkojnë.
Në çdo brazdë të parmëndës
Djersa jonë ka pikuar.

Nga sa korrim një grusht s'kemi:
Veç me nejet¹⁾ nëpër duar...
Qysh jep zogut dëllëndyshja,
N'goj ushqimin kur ia bije,

Un' ashtuth e rita djalin.
Kur në djell' e kur në hije,
Të mbjell n'arët a të kornja,
A me shatën për në vreshtë,

Djalin pas gjithmon e mbanja,
Kryever' e gjer në vjeshtë.
Pres e mjera, pres e shkreta
Të më vijë t'i puth ballin,

Se jam plakë ditëshkurtër,
Due zemrës t'ia nxjer mallin.
Mu ndë syt' e tij të kaltërt

Dhe mi flokët si kalliri,
T'i ve buzët, t'i ve duart,
T'i a pshtet kryet drejt te gjiri.

Të më vinte ta martonja
Me një nuse vajzë trime
Dhe kurorët t'i a u puthnja.

Ta gëzonja jetën time.
Kur erth dita q'u nda meje,
Erth më puthi ball' e dorë
Më zu qafës me mall biri
Dhe më la kështu të gjorë.

Lot tē nxehtha sysh mē bijnin.
M'u-droth trupi, mē ra pika,
Kur tha: «mëmë lamtumirë»,
Sa mes zemrës shkojin thika.
T'jesh e vë sa pun' e keqe!
Asnjë ndihmë prej gjékundai.
Gjith me djersë pér një bukë,
Po kjo shpresën nuk ma tundi.
Pata dit' e nete vojtjesh
(Fati-i keq kur ta ve tmerin),
S'më dil mendjes malli-i tija,
Sa kujtimet sot më therrin.
Ec i thosha n'Amerikë,
Vend ku lozin me dollarë;
A tekdo, tē rosh fatbardhë,
Jo me dhen e me gomarë!
Fjalët s'doj tē mi dëgjojë:
«Një detyrë kam moj mëmë:
S'më le zemra, tha, tē huajt
Që ta bëjn' atdhenë lëmë,
Porsi korbët mi stërvinë²).
«Po na cqyejn' copë copë
Vënd pér varr më mos na lenë,
«Të na mjelin si një lopë.
E ndjej turp kur jam në moshë,
«Mos ta bëj dëtyrën time.
C'vlerë kanë ca tē holla
«Nder po s'pate sa një qime?
Sa nga tanët s'kanë shkuar
«Nëpër botë s'kanë mbetur?
Dhe n'u-mbushnë me thesare,
«Me 'ta bashkë janë tretur.
M'i ri n'është, vjen martohet,
«Rri me gruan dy-tre muaj,
Pastaj ikën edh'harrohet...
«Gjen tē tjera nér tē huaj.
Sa tē reja s'kanë qarë,
«Prit e prit më kot një jetë,
Dhe sa mëma s'janë tretur
«Duke mbetur filli vetë?
Nonjë syresh e në kthehet,
«Mall në pastë pér atdhenë,
S'e nxehtha vendi, qysh i huaj,
«S'i gjen shije, syt' s'i flenë.

Shumë syresh me fëmijët
«Rritur mirë, bërë njerës,
Por q'doi pér Shqipërinë,
«Kur i rinë lark së mjerës.
S'e mban ment, dikur më thoshe,
«Yt vëlla si më s'pat ardhur?
Kishte pasje, dhe në kishte,
«Pér ty gjë ay s'pat derdhur.
Në ka burra dhe të zotët,
«Që ndihmuani pa u lodhur
Emri-i tyre gjith përmendet
«Më çdo vend që janë ndodhur.
Po, më kenda të rroj jashtë,
«Në të mbathur i limuar,
Por s'le vendin e në mbajtsha
«Dhe nj'opingë të pakruar.
Po s'punove qysh di vetë
«S'ke nevojë më të qash pér
Do të tjerë që po thonë:
«Tek najeta qenk'e ashpér.
Se sa eshtrat të më kalben
«Lark katundit tem q'u-rita,
M'i kënaqur jam me vdekje
«Pér Atdhenë nëpér prita!»
Ju e patë se qysh ndizej,
Sytë flakë si i lëshonin,
Kur erth ora që të shkonte,
Plot gas buzët i ndriçonin.
— Vafsh shëndosh' o djal' i mbarë,
Me bekime nga ana ime,
Puna jote daltë mbarë,
Mëma jote bën urime!
S'më vjen, bir, të ndahem teje,
S'i a di ditët pleqërisë,
Po, luan u-kthefsh, i thashë,
Ti je shtylla e shtëpisë!
Po më duket se s'kam shpresë,
Endra tmerri siç kam parë:
Sikur qitnja një dhëmpallë
E nj'e keqe mos ka ngjarë!
Me shtëllungën të tjerr leshtë,
Pranë vatrës kurse rinja,
Gjë kërciste nëpér dhomë;
Mirë s'ish, nga pleqt' e dinja.

Sa her' isha në mejtime
Syr'i mengjér më loj dëndur,
Se s'qe mirë, kët' e dinja,
Dhe shpesh qanja si një e çmendur.
Dhe në shpatull kam kërkuar,
Kur një qengj e pata therrur.
Por kur pashë fatn' e shkretë,
Ment e sy më janë terrur:
Për së largu re të trasha
Pellgje gjaku skuqnin tokën,
Tym e flakë, varr të hapur,
Un' e zeza humba kokën!
S'di në luftë në ka rënë,
S'di me nder në ka luftuar,
Mos armiqvet u është dhënë,
Mos gjëkundi është harruar?
Sa për nder të Shqipërisë,
Në râ djali, «falur qoftë».
Se nga zemra s'thom të keqen;
Shqipërija veçse rrroftë!

— Rrij e qetë, mos qaj motrë,
Mbaje zemrën, bënu burrë,
Se yt bir, e lumur mêmë,
E në vdiq, ay s'vdes kurrë.
Se t'atillë burra s'vdesin.
Gjaku i tyre bëhet vesë,
Q'i çel lulet e lirisë
Dhe për Kombin janë besë.
Vet' e pamë qysh luftonte,
Si luan mi mal përpjetë;
Pushk' e tij çudira bënte,
Bij armiku musi fletë.
Më çdo msyjtje qe i pari.
Gjith me kengë e zinte trapin.
Ku kërciste pushka rendë,
Ish ay q'e merte vrapi.
Mbrema herë rrrotull zjarit,
Kur po mereshim me fjalë,
Rrij me vesh duke përgjuar,
Kokë bufi mos na dalë.

Dhe kur deshér ne po ripnim,
Nér hej prushit duk' i pjekur,
Doj çdo punë vet' ta bënte,
Sikur ishte dorëhekur.
Mirr värcakun³), siç po dinte
Coprat mishi vet' i ndante,
S'linte shck pa e kënaqur;
Sa pér vehten kokë s'çante.
Pleq e plaka prej çdo fshati,
Kur na sillnin pér të ngrënë,
Ish i fundit që gjith priste,
Pakëz gjellë pér t'i dhënë.
Keq na vinte kur e shihnim
Se kujdesej aqë shumë.
Si një plak gjithmon na thoshte:
— «Të gjith jemi sot një brumë.
Pér dit' mëma më kujtonte,
«Ta kem zemrën, thosh, gjith hapur,
As zilia vend mos ketë
«Në shpirt tem pér t'u-përhapur.
Gjithsa pragun që na shkelnin,
«Qysh të huaj dhe fshatarë,
Me ç'na ndodhej i nderonim
«Si do miq qëmoti parë»
Kish një gojë t'embël mjaltë,
Kur do sende na tregonte,
Prej njëj gjyshit tij dëgjuar,
Si pas çasit q'i kujtonte.
Fjal' e tija na pëlqente,
Se kish bindje, mirëritje;
I kish enda qysh njëj plakut
Të na thotë pa mërzitje:
«Se qëmoti gjyshrit tanë
«Qysh sot s'ishin të përcarë,
Një fe kishin e një ndjesë
«Me qëllime të pandarë.
Por kot mundi-i tyre vajti.
«Ardhë ditë të këqija,
Mjegull dhen' e pat mbuluar,
«U dërmua krejt shtëpija.
Atrit tanë sikur s'ishin
«Bijt' e tyre, bij njëj fare,
Si të verbër, njëri jatrin
«Nuk e njihnin, t'egër fare.

Pér tē huajt u-coptuam
«Dhe ne mbetmë varfanjakë,
 Të këputur dhe tē mjerë,
«Asnjë dorë s'na ndih pakë.
 Mirë botës që t'i bëjmë,
«Fat i tillë na që shkruar.
 Sot tē mirën ta shpërblejnë:
«Syt' e zemrën me t'i çpuar.
 Dhe ky flamur yn i vyer,
«Para kohe ka valuar,
 Por tē sotshmit as që dinë,
«Se c'gjë patnë trashëguar.
 Shih dhe sot si djepet tanë
«I skuq flamuri i uruar!
 Si dhe n'arkat e martesës,
«Të dy shkabat janë shkruar.
 Si një korë le ta kemi,
«Se na jep kuxim e shpresë,
 Dhe kandile ne t'i ndezim,
«Dhe pér 'te kushdo tē vdesë.
 Sot armiqtë me ne tallen,
«Më tē zinj se bij skëterre,
 Nëpër baltë na e ndyjnë,
«Më bisht qeni si levele!»
 Si këto dhe do tē tjera
Na tregonte nér pushime,
 Gjersa nj'urdhër dhe, më kembë,
Kish arth ora pér luftime.
 Se çdo kendit Shqipërisë
Këmbë armiqt' i kishin vënë;
 Djath' e mëngjér ngado vinje,
Mi ne syn' e kishin shtënë.
 Pa mëshirë tē na shtypin
Me një luftë që tē therte,
 Porsi qenat nga një copë,
Me tē madhen kush ta merrte.
 Sulu lart e sulu poshtë,
Ne s'i-u-trembëm as tē fortit.
 Kur u-hothmë me gjith zemër
Më s'i a ndejtim frikën mortit.
 Pér ne lufta qe një dasmë,
Barra sendesh mjaft na ranë,
 Ball'i bëmë çdo rrezikut:
Mjer armiqve syt ç'u panë.

Dhe kur Vlorës i u afroan,
Reth me tela gjemba-gjemba,
Më zë thirri: «Djem përpara,
Djem në kini gjak në rremba!»
Dhe mer sulmin trimi-i rallë,
Se në hovet i kish ènda.
E shtron gunën ne pas tija;
Dhe matanë të gjith brënda.
Tej nga deti porsi breshër,
Poplat zjarri hekur-rrumbull,
Të mallkuarat na korrinin,
Kur që sipër bijin grumbull.
Ne përpara gjith po prijim
Kishim shenja, bërë fjalë,
Ndonjë-e keqe mos na ngjasë,
Me syt katër, me ngadalë.
Por ay na tha: «Përpara!
«Burrat s'dinë ç'ësht dëshprimi,
Puna jon' ësht pun' e shenjtë
«Dhe ky flamur ësht qëllimi.
Be mi flamur, djem, betuam,
«Se ne brënda do ta ngulim,
S'jemi burra po ta shkelim,
«Jasht' armikun do ta çkulim!
Një pëllëmbë vënd na mbeti,
«Prej kaq toke së bekuar,
Se stërgjyshrit kur luftonin.
«Gjith të tjerë gjenin shtruar.
Ne na marrin për kusarë,
«Sikur s'dinë çfarë jemi.
Se sa burra janë tretur
«Dhe për ta, si fqij q'i kemi.
Për të huaj mirëpritës
«I shqiptarit ësht zakoni,
Po kur sheh se del një gjarpër,
«Shpejt i merret mikut froni.
Ne s'u ramë pa pandehur
«Fjal' u bëmë që të dinë,
Se me miq për të rëmbyer,
«S'munt ta lemë ne shtëpinë.
Por ata në fjalët tonë
«Vesh e peshë kurrë s'vinin
Tetëkëmbës⁴⁾ qenë shtrijtur:
«Dhe me thithat gjak na pinin!»

Prij me flamurin q'e kishte
Në gjit vënë si një korë,
Syrin soje nuk e hiqte,
Pushka-lule gjith në dorë.
Tej armiqtë sa na panë
Me gjith armët, u hutuan,
Aq shqiptari të jet'i zoti,
Kurrë, besa, s'e besuan.

Nga gjith anët pushka binte
Në vesht plumbat vërvhellenin.
Ne mi gunat, trupin xvarë
Shkuam telat si s'pandehnin.

Kur u-poqmë ballafaqe,
U ra pika, mënt u-vranë,
Falje, falje! po bërtisnin,
Ngritnë duart edh' u-dhanë.

Kushedi se sa nuk ishim
Një grusht veta, po më tepër.
Ish dëshira jon' e zjartë,
Qe vullneti kryevepër.

Qysh ata ne s'patëm armë,
As të luftës rregullime,
Por një zemër e ca plumba,
Me pak buk' e pak ushqime.

n'Aqë gjémë, luftë tmerri.
Nuk luftonte pushk'e shkretë,
Po qe shpiriti-i gjall' i Kombit:
Shqipërija doravetë.

Prin me flamur, del nga shokët
«Përmi Vlorë të valojë,
Le ta ngulim, tha, për jetë
«Toka, deti sa të rrojë,
Tok' e Shkabës dykrenare,
«Me gjak tën' ësht pagëzuar,
Dhe ky flamur faqebardhë
«Ka gjithmon për të valuar!»

Lart fortësës vate-e nguli,
Po përtej një plumb i shkretë,
Arth në zemër e goditi:
Më vend ra, si trim me fletë.

Ne s'e dinim se kush ishte,
I gjyronim veç qëllimin,
Ish luftar munt i panjohur,
Por sot Kombi e njeh trimin.

E dha shpirtin i kënaqur,
 Se detyrën pat mbaruar,
 Se sot flâmuri yn' i shenjtë
 Po tregon kush pat luftuar.
 Pér nj'atdhe ra, pér lëvdatë,
 Pér atë trimoshen Vlorë,
 Ra me nder si bijen burrat,
 Ra me Flamurin në dorë!

1920

-
- 1) nejet = nyjet, kallot.
 - 2) stërvinë = ngordhësirë (serb.)
 - 3) värcakun = thikën (serb.)
 - 4) tetëkembës = octopodh.

V L O R È S

Vlorë, Vlorë, zall e det,
 Hyll prej qiellit je pikuar,
 Dorës Zotit e gatuar,
 Si rall shoqe ke mi dhet.
 Vlorë e bukur, lumja ti!
 Dita, nata sykulluar,
 Ver' e dimër luie shtruar,
 Je si nuse plot stoli.

Ti je balli me florinj,
 Ti je lulja e Shqipërisë
 Dhe trumbeta e Lirisë,
 Pleq që ngjalle dhe të rinj.
 Tërë kombi të sjell nder,
 Me lavd emrin ta ka shkruar
 Se ti trime vet' me duar
 Fift' e flamurit ke tjer!

Je kurora me shkëlqim,
 Gurë shtrenjt, margaritar,
 Që do mjeshtër magjistar
 T'i radhuan me qëllim.
 Zjar lëshojnë që verbon,
 Si hyj rotull të shëndrisin,
 Reze ngjyrash llambarisin,
 Pér sy bërë që lakmon!...

Mi tre skajet lagur det,
 Një rip malesh, tjatër fushë,
 Në mest ishul si një gushë;
 Ti për ball' u ri si mbret.
 Reth pëqinjtë thurur ar
 Me plot dorë perëndije;
 Vlorë çerdhe trimërije,
 Mburje-e kombit e thesar.

Gjirit tënd, gji madhështor
 Deti-i kaltërt i pshtet kryet,
 I ndeh buzët, epet, thyet
 E të puth si një dashtnor.
 Djelli lint a perëndon,
 Rrezet lozin mij' fytyra,
 Natën qielli si pasqyra
 Nga kandilet ar pikon.

Kur jaشت teje fryn, gjëmon,
 Shkumbë e valë ngreh përpjetë,
 Pikë ërgjëndi rahin retë,
 Një tmer lufte që s'pushon,
 Zana e detit më s'këndon,
 Ri detari mëndjeshkretë,
 Copra-anijesh ngasin vetë,
 Shoqi shokun q'e kërkon.

Por ti dyert sa q'i hap,
 Je parajsi-i ëndëruar,
 Q'i fal prehjen e kërkuar
 Çdo kujt gjiret që t'i kap;
 Ti je tempulli hyjnor,
 Lundërthyeri ku ndalet,
 Si njëj kore vjen e falet;
 Këngë lutjesh ku përdor.

Të vu Zoti n'atë bri,
 Që t'jesh roj' e-Adriatikut,
 T'i mbash shtegun çdo armikut,
 Cveshur kordhën për liri!
 Ta tundsh krahun me kuxim.
 Fati barrën ta pat dhënë,
 Për ta mprojtur nderin tenë,
 Dërdhe gjakun në kushtrim.

Rrotull fqinjët sa fuqi,
Sa mënyra nuk përdorin,
Me pahir që të ta korrin
 Çdo send, Vlorë, mban në gji!
 Mund e bij ke pas armiq,
Me syt' katër gjith pas arit,
Jasht zakonit të shqiptarit,
 Që s'shet besën për ca fiq.

Por ti Vlorë mos u-dro,
Mbaj mburonjën me qindresë,
Se kush vetes i zë besë
 E mat grushtin me këdo.
 Se dhe Deti mik kur fle,
N'endrat kryen një dëshirë:
Mbret të jet' e Zot i lirë
 Veç për Tokën q'i dha bë.

1920

LUFTARI LYPËS

Lëftova për atdhe,
Lëftova për liri,
Por veshin një s'ma ve,
 As dorë s'm'ep njeri.

Pa kurrnjë ndihmë jam,
 Me plagë plot në trup,
Fuqi më t'ecëj s'kam,
 As robë s'kam mi sup.

Kudo që kam trokit,
 Një derë nuk m'u-hap.
Rri jashtë prit e prit:
 Një copë bukë s'kap.

Armikut s'i jam tut,
 Në ballët i kam dal,
Shpesh dërmën i a kam fut
 Dhe hovin i a kam ndal.

Nër nete qiel pa hyj,,
Shtërgata vij me shi,
Vend s'keshe ku të hyj,
S'di vetë qysh jam gdhi.

U-treta për disa,
Q'as njihjin komb, atdhe,
Mbi frone sot ata,
Që shgryhen pa një fre.

Me mburje posht' e lart
Bërtasin me një zë,
Se hyjtin mu ndë zgjart,
Kur zjarri s'ishte më.

Kur isha në kushtrim
Me shokët për atdhe,
Ata gjithmon pengim:
Çdo çap na venin re.

Kur qe nonjë rrezik,
Disa që rrinin lark,
Sot rendin vrik e vrik:
S'mendohen veç për bark,

Të tjerë me shpirtliq,
Që prap na kanë vra,
Sot bëhen miq për fiq,
Sikur më s'jan' ata.

Mundimet kush s'i njeh,
Rrezikun kush s'e pa,
Tekdo të ngopur sheh,
Q'as vunë kurrnjë krah ¹⁾.

S'pyesin sot kush je,
S'kujdesen se si rron,
Kur shkon, kurrkush s'të njeh:
Syshtrembër të qëllon.

1) Q'as vunë kurrnjë krah = që nuk ndihmuani në luftën e lirisë.

Fëmijët mos më keq,
Të çveshur un'i kam,
Të zit t'ullirit hedq,
Nër mënt' e mijë s'jam.

Përjashta pa shtëpi
Po breth andej këtej,
Të lyp si faqezi,
Fëmijët që t'ushqej.

Një send veç më ngushëllon,
Detyrën se kam la,
Kjo helmet mi shëron,
Pa, fati i em m'u-pa.

Një shpresë tek Tynzot
Kam shpirtin që t'i a jap,
Ta shuaj krejt çdo lot,
Mos heth më sytë prap.

1922

REPUBLIKA SHQIPTARE ¹⁾

Sot breth fjala gënjeshtare
Prej disave mëndjelehtë,
Se ky vëndi jyn'i qetë
Parësi ka gjakatare,
Gjë që s'ësht'e s'mund të jetë.

Se në bijen dhe dëshmorë,
Mund të ngjasë herë, herë,
Faj që falet, faj pa vlerë,
Se kjo botë s'ka shejtorë:
kanë bërë edhe të tjerë!

Shteti ynë, shtet i mbarë
Ësht një shëmbull drejtësije.
çdo që bën, s'e bën pa shije,
I shkon shokët, s'ka të ngjarë
Në çdo punë qeverije!

1) Dorëshkrim, e pabotuar.

U tund deti, briti toka:
Shqipërija Republikë!
Pun'e bukur, thon pa frikë,
Veç zyrtarët që nga koka
S'dinë shqip as gramatikë.

1925

FISNIKËT E SHQIPËRISE¹⁾

Larg, larg, rrugën hapni shpejt,
Se beu i ynë vjen kaluar;
Ja tek duket drejt për drejt,
Pas me trimat t'armatosur!
Shih fytyra si i shkëlqen,
Gjith ergjën edh'ar i mveshur,
Shih si mfryhet, si dëften,
Sikur është me kashtë i ngjeshur!

Që t'arrijë bej, e-hu!
Të pangrënë u-tretnë shumë;
Sa të tjerë kot për lumë
S'i pëershkoj në plumb, e-hu!
Qysh besoni se ësht fisnik,
A bir mbreti në fuqi,
çdo të math mos e ka mik,
Për të mbrojtur vegjeli?
Ase s'ësht aspak harbut
Dhe se hiqet «Derë e Madhe»,
Kurse natën del hajdut,
çvesh sa shkojnë rrugës madhe?
Shkovi lark, se, gjith sa ka,
I rrëmbeu nga varfëria;
Vatrë s'mbet një lot ku s'ra:
Rroftë pra fisnikërija!

1) Kjo poezi është titulluar së pari: «Beu harut», pastaj është prishur dhe është zëvëndësuar me «Fisnikët e Shqipërisë», (Dorëshkrim e pabotuar)

T R A S H E G I M I¹⁾

Të rrish të bësh gjykime, ma sa të shohin sytë,
 Të hysh në më të thellat, që t'apësh gjyq stërhollë,
 Me veprat e sicilit, të pastër a të ndytë,
 Më duket pun'e rëndë, ta dijni mir' e hollë.
 Sa herë s'ju ka ndodhur, që shpesh të shihni njerës
 Që, pa ta njohin vehten, as çastin ta peshojnë,²⁾
 Por mjeshtër dredharakë — sicili sipas vlerës —;
 Me vlerë veç për prishje, çdo shteg që ta kalojnë.
 Sa veta s'ka kësyresh pa pikë zotësije,
 Me sjellje trashanike që s'maten me pëllëmbë,
 Çdo shpirti me një frymë që shquhet vetëdije
 T'i bëhen urdhëronjës, ta marrin nëpër këmbë.
 Në qoftë se kuximi q'e kanë si mburonjë,
 Të thyejnë vullnete, të shkelin mi kufoma,
 Për hir të madhërisë, q'e kan' ata si pronjë,
 Të dredhin çdo ndërgjegjje a t'epin tru të njoma;
 Mi frone që të hipin, të duken se diç janë,
 Të japid e të marrin me frymë kotësije,
 Për t'i treguar botës pushtetin plot q'e kanë,
 Pa ta peshojnë vehten n'u ka çdo robë hije.
 Këtu dëftehen çiltas se kanë tru të thatë
 Se kokën nuk e çajnë më tej t'i shtijen sytë,
 Veç zotër që të janë me dorën sa më gjatë,
 Të tunden e të mfryhen, si ta mos t'jet'i dytë.
 I sheh si po lëvdohen, se janë zemërgjerë,
 Se dhembjet thell' i ndjejnë, se janë mëshirtarë,
 Çdo fjal' e tyre mjaltë, të mirën për të bërë,
 Të duken se çdo vepër e bëkan për të mbarë.
 Në punra njerëzimi s'i shkon ata një tjetër,
 Rrëmujë e bënë pasjen, me grusht të holla hodhën,
 Lëvdatë kjo pa kripë, një përrallë e vjetër.

1) Poezi e pabotuar, gjetur n'arkivin personal t'Asdrenit këto kohët e fundit. Nuk ka datë të shënuar, por nga brendia kuptohet se duhet të jetë shkruar aty rrëth viteve 30, kur regjimi feudal-borgjez i Zogut ishte restauruar plotësisht dhe pasojat e tij ishin bërë të qarta.

2) Po fillojmë këto 3 vargje, që nuk janë fort të qartë. «që, pa mundur të njohin dot vehten, të metat vetjake, (për injorancën e ka fjalën më tepër), pa ditur gjithashtu të qmojnë rrëthanat (as çastin ta peshojnë), të aftë vetëm për dhëlpëri (sicili sipas vlerës, me vlerë veç për prishje), për të kapërxyer situatat e vështira e për t'ua hedhur të tjerëve (çdo shteg që ta kalojnë).»

Kuletën që ta çelin askurrë nuk u lodhën.
Lot bëhen sikur shtrydhin pér faqe me mandilen,
Kur bukë s'ke pér gojën, kur ndodhesh në të keqe,
Por, fati në ta pruri, me vaj ta kesh kandilen;³⁾
Mentsh prishen nga nakari, të ndehin mijra leqe.
Me thonjtë majëmprehur, si mace ledhatare,
Si dhelpa sydinake dhe kobë kukuvaje,
Në prita dit' e natë dëshirash lakkimtare,
Me vrik ta kapin gjahun, të prurin gjémë e vaje.
Nuk gjendet fjal' as emër në botë pér t'i nxirë
Këta të pafytyrë q'e shëmbin njerëzinë,
Që rendin pér të shqyer, në copë pér t'i grirë
Sa dorës tyre bijen, sulmuar në greminë,
Pa shpresë njëj shpëtimi prej grushtit më të rëndë
Si shkëmb q'u rri krahnorit, q'as frymën dot s'e heqin,
Të ndrydhur nér mundime, të shtrydhur si një lëndë,
Nga thonjt' e bishës s'egër, që rri në gaz me dreqin.
Armiq të kombësisë, por miq me 'të pér thela,
Me hov si shpëndë nate në roje prapa murit,
Lëftonjës të së drejtës, si vegla dhe truela
Gjithmon' ushqir.. q'i dhanë litarit edhe hurit.
Kësijsh e dashka fati dhe prijës shpesh në ballë
Të kombit udhëheqës, të shtetit kujdestarë
Kalarës të Cervantes ta mbajnë kapistallë:
Të dukemi të lumtur, kur jemi pér t'u qarë!

O hije tërëshenja të burrave të shquar,
Therror q'e bëtë vehten pér një mendim q'ushqenit,
Q'e latë jetën tuaj nér burgje t'errësuar,
A ratë nér luftime me plot durim të qenit,
Që s'patë drítë djelli mi ballin e rrudhosur,
Mi kurmin tuaj shtrihur dërpuar plagash plumbi,
Të flakur si stervinë, si send më të nëmosur;
Me syt' e juaj shtrydhur në 'ta përshkuar thumbi
I veglës së mallkuar, i dorës më mizore,
Që ndiqte pa mëshirë si bishë e egër mali
Të shuajë çdo flakë që ndizej madhështore,
Q'as breshëri, shtërgata dot sulmin nuk i a ndali,

3) Por, fati në ta pruri, me vaj ta kesh kandilen = në se ta ka sjellë
fati të sigurojsh një jetë modeste, pa shumë mungesa.

Ku jini ju dëshmorë, ju shpirte të bekuar,
Që ngjallte një të shkuar, nér shekuj që shëndrisi,
Që derdhët kroje gjaku, q'u-trettë duke pshuar
Të pshtetur shpresës suaj, rreziku kur i a krisi?
Vështrimet posht i hithni, vështrime si rrufeja,
Qëlloni që së larti me sa ju ze fuqija,
Tek vendi fli q'u-bëtë, ku latë gra të veja,
Që qajtën gjer në vdekje me motra, bij e bija.
Si burrat e padroje ju ndritnit porsi hyje
Nd'ate t'errët kohë më e zezë se skëtera,
Nér male dhe nér shkrepë, nér fusha dhe nér pyje,
Me zemër prej luani nér sulmet e paprera.
Mi sup e shputë kryqin, pa lot i ndjetë thumbat
Titanë nga veprimet, Herkulë nga vullnesa,
Krahnorin vutë rrasë, me te të prekni plumbat;
Themel ta bëni trupin, të ngrihet sot ndërtesa.
Ju prangat i dërmuat, ju haptë rrugën gjërë
Dhe shtegjet e pashtetur i bëtë sheshe gazi.
Që sot i-a dredhin valles të bërë e të pabërë,
As n'ëndërr që s'e pritnin, t'u mbushet plot gurmazi.

Këta të jenë vallë nj'ata që trashëgimin
E muarr ta smadhojnë, t'i japin nder e famë,
Nér vepra madhështore të bëra pér kujtimin,
Pér lavdi të mundit tuaj, që kurrë syresh s'pamë?
Këta të jenë vallë gjurmashët me lëvdata,
Që posht e lart bërtasin se kanë shpirt krijonjës,
Që hapin gojën gjërë me gjuhën si lopata,
Me buzët plot me jarga, si do gjerprinj helmonjës?
Fytyra prej shqiptari, por zemra krejt e huaj,
Me trupn' e tyre faqas por shpirti-u breth përjashta,
Të dijsh se ç'kanë brënda, lëkurën pak u-a kruaj,
Do shohç, se s'gjen shenjtorë, por djaj me mish e rrashtha,
Me maskë në fytyrë me të stërhollë prekje,
Të çfaqen plot virtuta nér sjellje bujarije,
Pér nderin, të vërtetën, dëshmori presin vdekje⁴⁾
Me mburrje pa kufire, me frymë krenarije.

4) Pér nderim, të vërtetën, dëshmoni presin vdekje = presin vdekje
dëshmori pér punë nderi e pér mbrojtjen e së vërtetës.

Kur poshtë janë vaje nér vojtje dhe mjerime
 Që s'kanë një kafshore tē bukës së përditme,
 Që s'ngopen dot me fjalë, me festa dhe shkëlmime,⁵⁾
 Përveç uris'së zezë, as n'ëndërr një tē pritme.
 Tē zbathur e tē çveshur, nér yrma dhe kasolle
 Një lindet pesë vdesin, me kërmat mahin tokën,
 Fëmijët si cirua prej ethesh e prej kolle,
 Si fiq tē thatë fishkur, mezi e shpijen kokën.
 Më n'janë sheh tē ngopur, tē ngjallmë, barkalecë,
 Dinakë musi dhelpa çdo send me grep ta heqin.
 Më tjatrën, sheh barkthatë pa mënt si kastravecë,
 Në djell'e shi tē rrahir, qe s'dijn' asgjë tē ndreqin...

Ushqehen parazitë, pa bërë kurrnjë punë,
 Që rrojnë, me gënjeshtra, që shesin çdo ndërgjegje;
 Me kokën plot me krunde, lëkurën musi gunë
 Shushunja gjak që thithin, pa dhën' asnë përgjegjje.
 Me fjal'i sheh se merren, me gjepura pa kripë,
 Me frymën mëndësije në lak pér tē shtytur,
 Biseda pa kuptime, tē thëna sa pér cipë:
 Themeli-i kalbur fare, mendimi krejt i mbytur.
 Veprime nënëdheshmë, vendime nënërogostë,
 Qëllime satanike pér msyjtje shtazarake,
 Pér ta kurrgjë s'ka vleftë dhe bota krejt n'u-sostë,
 Pa turp që t'i përdorin pér ëndje më vehtjake.
 Se vunë krah e mendje, se janë burra shteti,
 Në fushë t'atdhesissë vërtet politikanë,
 Bismarcku, Metternichu si dhe Gladstoni-i shkreti
 Më kot e shkuant jetën, në fund tē pellgut ranë...
 Bashkimi pun'e plotë, si shkëmb që s'tundet vëndit;⁶⁾
 Gjarprinjsh qarkuar trupin, dikur si Laokconi,
 Me zotër sipas kokës, me miq q'i shtrihen këndit,
 Sa s'dijmë se ky truall i tyri n'ësht a joni!

Nj'aty ku letërsija ësht gjellë që s'ka shije
 Edh' arti fjal'e thatë q'aspak s'i dihet fara,
 Ar derdhet pa mëshirë pér sende kotësije,
 Kur libra s'ke pér shkolla, një çap tē bësh pérpara.

5) Kuptimi i drejtë pér drejtë i këtyre vargjeve: Njerëzit që s'kanë një kafshore, që s'mbushin dot barkun me bukë, nuk ngopen me fjalë (me gënjeshtrat) dhe me festat tuaja tē shkëlqyeshme.

6) Bashkimi pun' e plotë... = ideja e bashkimit tē së gjithë elementeve tē këtij kallëpi në krye tē shtetit.

Prej gjuhës sonë s'aftë me tinguj harmónije,
Që shkruhej më një kohë që s'ish pér 'të zyrtare,
Me fraza të këthjellta, me fjalë q'i kish hije,
Sot zyrat po na ngjeshin një lëng pa shije fare.
Prej nuses bukur nisur si vajzë trupkërthinxjtë,
Të sotmit na stolisin një plakë me shallvare;
Le shkolla nér katundet tek faqas lozin minjtë,
Plevica kemi ndrequr në vend të ngreh' alltare.
Mësonjës t'arësimit me shpirt të ndryshmë e gjyqe,
Që vetë fund s'i japid njëgjyqe lakrash çorbë,
Me ndërlikime fjalësh q'u bëhen mëntë qyqe:
Mos presim zell mësimi nga çunat tanë korbë.
Të rinj pérjashta çohen, po rrall'e me zelltari
Nér shkolla dijenaltë, pér t'aftë dijetarë,
Por shqipen kur s'e dijnë si ç'duhet piksëpari.
Kot shteti derth të hollat, kot fara hidhet nd'arë.
Hith sytë mi botime të javës a të ditës,
Në dhjetë fjalë shkruar, nuk di në gjen dy shqipe,
Kalorësit e pëndës si t'aftë kryengritës
Me shkerm i bijen mëmës e flakin nëpër çipe.
Një kohë do t'arrijmë, që tash afroj po thuaj,
Mos njohim çfarë gjuhe del frymës sonë gjallë,
Se trupi n'ësht i jyni, por shpirti krejt i huaj,
Mos qahemi se s'kemi të shquar papagallë.
Me hundën gjith përpjetë dhe ndjenjat të përcarta,
Me mburrje mëndjelarti dhe sjellje «urt' e butë»,
Si pemët e paarrijta në tul e lëng të tharta,
Nj'ashtu si ç'duam vetë, q'i dashka mushka drutë.
Ç'na duhet gjyq e dije ta lodhim tepër trurin,
Kur puna vete mbarë me kleçka dhe me arna?
Mjaft qënka me stolira ta mveshim bukur drurin,
Ta vemë krye këndit, pa le të hamë e-barna
Të huajt venë peshë, kur shohin ç'ka pjell mendja,
Ç'del trurit e shëndoshtë, n'ësht ajk' apo shëllirë,
Pér ndryshe s'të përfillin sido q'ë prurtë gjendja
Kur ke mungesë dije, kur gjyqi s'tësht i dlrë.

Në gjirin tonë patmë nj'aq sende vjetërsije
Kujtime prej të parve nga kohët më të lashta,
Por ne si ca demonë nuk lamë syresh fije,
Në gjak e fe të mbytur, çdo send u-shduk pérjashta.

Sa tempuj s'ndruan faqe, tē fesë stërgjyshore
 Për hirin e njëj tjetrës, dikur pa rënë fare,
 Me frymë bese ngrehur prej kohësh shekullore,
 Nër falje besnikësh stolisur me thesare.
 Kujdes askurrë s'patmë pér gjëra tē këtilla,
 Do dru tē thata jemi, me 'to t'ushqehet zjarri,
 Për vendin kemi qenë më t'egër se nj'Atilla,
 Se gur mi gur më s'imbeti..., na pat mashtruar arri.
 I huaji sa kohë q'e shkeli tokën tonë,
 Sado q'ish një-egërsirë nuk pruri nj'aqë dëme,
 Sa dora jonë vetë shkretuar pat gjithmonë,
 Që dridhej edhe foshnja në barkun e njëj mëme,
 Vëllaji-i yt dhe nderin ta shkelte pa pik droje.
 Me kërcëname t'armës apo me tundje palle,
 Kur shtaza ngulte këmbë. Për tē shpëtuar soje
 Dhe priftër rrëth tē vdekursh pa dashka lojtën valle⁷⁾.
 Vandalë po pér vehte, krijonjës pér tē tjerë
 Më vatrën varfanjake si bij tē njëj së veje,
 Në botët u-shpërndamë si pendë e hedhur n'erë,
 Pér fqinjët kryeprijës, pér vehten shpendë prerje.

Je mik i së vërtetës, tē marrin drejt tē marrë.
 Ni nxjer në shesh tē metat, armiq i ke dhe miqtë,
 Me shufrë-e ndjek gëshnjeshtrën, tē bëjnë tē palarë.
 S'gjen mjete pér t'i shquar tē mirët nga tē liqtë.
 I botës s'jam gjykatës tē munt që t'ap dëname
 As s'dua që tē hiqem nj'ay më-i mëndjedlirti,
 Por gjyqit fré t'i verë tē drejtë s ka për qime
 As urdhri as fuqija, kur ndjenja flet e shpirti.
 Të kisha Dante-i pendë, penel tē Raffaelit,
 Me vjersha dhe me ngjyra, me këngë si t'Homerit,
 Gjigandët që po ngrehin sot pircun e Babelit:
 Në lavd qjellor t'i ngrehja «heronjt» e Guliverit.
 Katundesh dhe qytetesh si një rapsod shëtitës
 Kurorë do t'u thurrnja nér hymne burrërike,
 Kérminjve që krenohen, se janë hyjt' e ditës,
 Burim i lumërisë tē s'ultës sonë hije!...⁸⁾

7) Këtu e ka ma tepër fjalën pér sjelljet e feodalit musliman shqiptar.

8) Duke ironizuar feudo-borgjezinë, që sundonte në kohën e Zogut, poeti bën një paralezmë me vend midis këtyre dhe heronjve tē veprës së Khanatan Simftit «Udhëtimet e Guliverit», tē cilët, edhe pse janë xhuxhi-maxhuxhë (tē gjatë një pëllëmbë), kujtojnë se veprat e tyre janë më të shkëlqyerat dhe ata vetë «janë hyjt e dritës».

Gjurmashët e pazottë, të mitur si një dele,
Me veprat burracake dhe me-etjen madhërije!
Kam frikë, trashëgimi mos bëhet gjith fertele:
Ideal-i ëndërruar mos shduket si një hije!

TË RINJVE

O ju që vijni paskëtaj plot shpresë,
Si ata, që s'dinë çase psherëtimi,
Që s'panë vojtje e as durim mërgimi,
As zemrave pik helmi që t'u zbresë.

Na, rrugën drejt e mbajtmë gjith me ndjesë,
Të tretur shumë herë nga trishtimi;
Por mjaltë krejt na dukej hidhërimi,
Kur shihnim se fjala jonë se ze besë¹⁾

Por na ju lemë, shkojmë si shkon vesa,
Asgjë mbi dhe s'qëndron për gjithëmonë,
Si trashëgim ju lemë shpirtin tonë.

Ne shkojm' o shokë, po s na shuhet shpresa,
Se fjalën që ju lamë si pasqyrë,
Gjithmonë do ta keni shëmbëlltyrë.

1) se ze besë = se fiton besim në popull; se besohet.



PÖEZI PËR NATYRËN DHE PUNËN

DITË PRENDVERE

Dita gdhihet, çel agimi,
Derdhet drita porsi ar,
Cduket nata, shkon qetimi,
Dielli rezet si mburimi
I çon poshtë porsi zjar.

Ndritten kodrat, fshati zgjohet,
Lumi qiellin pasqyron,
Fusha, bregu ngjyra ndrohet,
Fletët dridhen, era ngrohet;
Shkëmbi majën sbardhëllon.

Prej kasolles bagëtija
Fushës dalin pér ushqim,
Derës jashtë bukurija,
Kur ndaj kroji, kur ndaj vija,
Këngë dreth me përmallim.

Lunat lozin, vashat qepin,
Plakat e urta tjetrin lesh,
Nuset shkundin, tundin djepin,
Burrat shatën, pleqtë grepin,
Një mban fjalë, tjetri qesh.

Pxv
Fushës zbresin tatëpjetë
Punëtorët në mëngjes,
Nëpër arat porsi mbletë,
Kush me veglë kush me qetë,
Me peqinjtë përmi bres.

Vjen mjesdita, grat' u shpien
Buk'e gjellë me ç'u ndoth,
Ndënë hije redhe shtrihen,
Hanë drekë, çlodhen, bien,
Pastaj nisin punën mbroth.

Hëna kur nëpër brigjet
Del si dyllë që digjet
Dhe ndrin me ëmbëlsirë,
Çdo gjëje i jep hirë.
Natën e bën të artë
Me dritënë të zjartë,
Rehtë, si edhe çdo vënt,
I ngjyron gjith me ërgjënt.
Sa pëlqim sa bukuri
Që s'e mohon asnjeri!

DUA

Mbi bar dua të prehem,
Të këndojoj të dëfrehem.
Të shoh arreth, bagëtinë,
Kur hanë edhe pinë.
Të shoh fushat e blera,
Bimrat kur i fryn era,
Njerëzit kur punojnë
Dhe çupat kur këndoijnë.

Ah, dua dhe lulet
Kur i çfaqin pekulet!
Dhe flytyrat që venë,
Mi 'to dua të jenë.
Bilbili t'ia thotë,
Djelli t'jet' i ngrohtë,
Pylli të gjelbëronjë,
Qyqja të mos pushonjë.

Dua dhe Shqipërinë,
Se atje kam shtëpinë,
Ku rinja nëpër ferrat
Edhe losnja me shqerrat.
Për këto kam dëshirë
Edh' as dua më mirë,
Veç atje dua të shkonj,
Sa të jem e sa të ronj.

PERËNDIM DIELLI NË VERË

Sa pamje e bukur e madhështore,
Sa magji çfaqet që s'ka mbarim,
Natyra duket më vjershëtore,
Me aqë ndryshime plot me pëlqim!

Si disk i zjarrtë perëndon dielli,
Tej ret' e malet flakë i ngjyron,
Ckuqet e mverdhet përpjetë qielli,
Një zjar vollkani sikur kullon.

Si pluhur, duken kur po lëshohen
Rezet e fundit me qetësi,
Dhe në kuroër të artë ndrohen,
Duk' u-përhapur plot me magji.

Bredhat e lisat tunden e ndalen,
Kur er' e mbrëmës është në fryjtë;
Porsi në tempull njerës kur falen
Përpara korës me një adhurim.

Gruri, tërshëra gjith ar ngjyruar,
Me pëshpërime tundet me vrap,
Lëndin' e gjërë me lule e shtruar,
Erë prej afshi kudo përhap.

Lumi, përroji në fytyrë ndrohet,
Kodra edhe fusha plot bukuri;
Anës së detit po pasqyrohet
Ulliri i gjelbër me madhështi.

Rëzës bariu si gjithëmonë
I bie fyellit gjith me pëlqim,
Nuset e vashat vjershës ja thonë
Nëpër kasollet me përmallim.

Sa pamje e kandëshme edh' e pëlqyer
Është kur dielli po perëndon!
Ah, sa èndra, shpresë pa u dëftyer!
S'na sjell e nesërmja që afëron!

TRANDAFILI

Që kur në botë lulet kanë jetë,
Veç unë jam që mbretëroj mi 'to,
Se un'jam Luljambret.
Një tjatër vendin tem as munt ta ketë,
Se gjiret gjërë kur i hap kudo,
Me gaz kushdo më pret.

Që me t'u gdhirë dita prëndverake
Dhe gjer sa qesh një djell dimëror,
Me mall gjithkush më çik.
Që prej kasolles s'ult' e varfanjake,
Si dhe gjer te pallati mbretëror,
Të gjith më kanë mik.

Çdo rreze qesh në gjinjt' e mij kur derdhet,
Çdo pikë vese e bëj margaritar,
Shpall drit' e gaz hirplot.
Kur vjeshtës, pyll e fushë nis e mverdhet
Dhe çvishet robës shelgu qamatar¹⁾,
Prap unë mbetem zot.

Un'jam ay që çfaqem plot magjije.
Stoli kam ngjyrat botën q'e ndërsen,
Stoli që syt'i a merr;
S'jam qysh ylberi, qjejsh kur del si hije,
Veç pér një ças, me gjyrat syt' q'i ren,
Si dh'avull shpejt q'u ter.

Gjithmon me mua bukuria mburret,
Stoli pa shëmbëll jam pér çdo krahnor;
Vesonj çdo zjar që djek,
Nuk trembem as njëj dore kur më turret,
Sepse te çdo njeri kam një dashtnor:
Me nder kushdo më prek.

Me mua rruga mundësvet u shtrohet;
Dashtnorve mallin zemrës un' u-a ndes,
I deh me afshin tim.
Kuror' e tufa lulja shpesh më ndrohet;
Kujtdo sa rron, martohet a po vdes,
Prur gaz e ngushëllim.

1) qamatar = vajtues. Këtu: shelgu qamatar, shelgu vajtues, një lloj shelgu me degë të përkulura. (shelgu lotues).

Me mall si pupëll flutura vjen, shtrihet,
Më puth, me kraht, si mik më përkëdhel,
Si nj'i pandarë shok.
Dhe mbleta punëtore porsa gdhihet
Si prej çdo lule e meje mjaltë vjel,
Më thith e fletë e flok.

Kushdo që vjen, i kënda t'i a fal lulet,
T'i prur në zemër prehje dhe gëzim,
Çdo dhembje t'i a shëronj.
E në kuxon dikush pa mënt e sulet,
Ta shtjerë dorën egër për rëmbim,
Më dhimpset ta pickonj.

Jam për çdo sy me dritë, lumtëria;
Çdo gaz i a shtonj, por dhe çdo lot i a shterr,
Qoft punëtor a mbret,
Qysh plakut q'i përmendet aq risia,
Qysh të sëmuri, erën kush ma merr,
Fuqi ndjen dhe shëndet.

Jam Lulja mbret e paqes s'amëshuar,
Për çdo njeri, nga zemra që më do,
Qëllimin q'e kupton;
Dhuratë qjelli jam për botën çuar,
Si shenjë butësije për këdo,
Fatbardhësi q'endrron.

PAMJE VJESHTE

Shkoj vera
Si hije,
Frym era,
Shi bije.

Lart qielli
Si plumbi,
Shkoj dielli,
Na humbi.

S'ka jetë,
Ra brymë.
Bar, fletë
Fa frymë.

Rri zogu
Të hajë
Te shtogu
Mi majë.

Ka gojë,
Do jetën
Ta rojë
Të shkretën.

Gjahtari
Del gjahut,
Druvari
Dru krahut.

Del bujku
Mbleth berrat,
Tej ujku
Nër ferrat.

Lart fshatit
Tingllime....
Rreth shratit:
Dëfrime.

VJESHTA

U çduk vapa, shkojti vera
Dhe bilbili më s'këndon,
Ardhi vjeshta me të tjera,
Syri i ynë q'i shëkon.

Terret koha, hapen retë,
Ngjyrë plumbi përsëri,
Duket prapë tjetër jetë,
Që natyra ndron tashi.

Era fryn dhe fletët bien,
Pemët çyishen si nga mot,
Mali, fusha më s'ka hijen,
Që po e kishte gjér më sot.

Qielli i bukur që dëfrente
Trupin tonë, sot u-terr,
Më s'ka ngjyrën që shkëlqente
Si pasqyrë, si mermer.

Bukuritë janë çdukur,
Shiu e bryma zuri vënt,
Bari, lulet, kopshti i bukur
U-ndryshuan më çdo kënt.

Dhe liqeni i kulluar,
Që ndriçonte me shkëlqim,
E ka faqen të trazuar,
Dridhet, tundet pa pushim.

Veç nga herë me ëmbëlsirë
Dielli rezet na i dërgon,
Natën hëna me një hirë
Në ërgjënt malet i ngjyron.

Por e mirë është vjeshta,
Sepse bujku gjith punon;
Për të vjelur sot ka vreshta,
Nesër arat po lëron.

Njerëzia nga çdo anë,
Posa ngrihen në mëngjes,
Nëpër fushë çdo që kanë
Rendin, mbledhin me kujdes.

Fra me punë gjith të rojmë,
Se veç puna ne na vlen,
Sepse ndryshe s'trashëgojmë
Verën tjetër që po vjen.

Pylli më s'gjelbëron,
se nga fletët u-shkunt,
As era më s'pushon,
po shpesh degët i tunt.

Dëllëndysheja shkoj,
si na gëzoj n'verë,
Ah! dhe qyqja pushoi,
vajti ndë skëterë.

Flytyrat më s'venë
nëpër lule me qëndru,
Çdo gazmënd e lenë
dhe trishtim' i ka pushtu.

Hëna nuk shëndrit,
se ret' e kan' mbulu,
Veç ngaher' rezet i qit
porsi vash' e turpnu.

Era fryn, bie shi,
veriu vërvhellen,
Vjeshta ikën tashi
dhe dimri me vrap vjen.

Dbora flokë-flokë
të gjitha i mbulon,
Sikur s'je ti o toke,
sa bukur zbardhëllon!

Zogjtë togje-togje,
për me kërkü ushqim,
Zihen nëpër shtogje,
kur hanë me nxitim.

Dbora zbardhi malin
dhe fushën tatëpjet',
Njerëzit më s'dalin
dhe rruga është e shkret.

Kudo është pushim
dhe heshtje mbretëron,
Veç veriu me tërbim
përpjek edhe rëzon.

Hoho! Pusho o veri,
mjaft, mos vërvhelle.
Ku qe ec' përsëri
dhe prapë mos u-kthe!

Prëndvera për me ardh
me dit të gazmume,
Fushën me na e zbardh
me lule t'bekueme.

Eja pra o lule,
që ritesh ndë vesë,
Ti nga qiell u-sule
për me na prû shpresë!

ARDHJA E DIMRIT

Zunë ret' edhe po shoshen,
Dbara bie me qetim,
Dheu mbulohet në të bardhë,
Me një robë plot shkëlqim.

Bien flokët si pambuku,
Sërë-sërë e një nga një,
Bëjnë vetulla mi muret,
Ndron fytyrë posht' çdo gjë.

Zë fryn era pa pushuar,
Del veriu me tërbim,
E ngreh dborën porsi pëndë,
E bën togje me nxitim.

Pylli i çveshur rri i trishtuar,
Sikur qan, sikur mban zi,
Drurët tunden, krahtë ndehur,
Bëjnë lutje si njeri.

Çduket fusha an'e mb'anë,
Në syt' duket porsi det.
Përtej lumi ndrit si ergjendi,
Porsi gjarpër rrëthon, shket.

Dridhen zoqtë nga të ftohtit,
Porsi fleta ndënë shi,
Kur foletja majës shelgut,
Që t'i mprojë s'ka fuqi.

Në fshat ditën duket heshtje,
Sipër tymi veç rrëthon;
Për m'at'anë dushku i vogël
Po tunt kryet e vajton.

Her' pushimit zë dëgjohet,
Reza, kodra shpesh gjëmon.
Hyjn' e dalin njerëzija;
Zë sopate depërtón.

Ndë kasolle plaka e zbardhur.
Pranë këndit po tjerr lesh,
Vështron flakën që del zjarrit,
Lark menjtohet... loton shpesh.

Del e reja në dritare,
Në gjit foshnjën përkëdhel
Dhe një këngë mjaltë e embël
Duk'e puthur. gojës del.

Jashtë çunat hidhen, lozin.
Gjersa urija i largon;
Ndenjur shtratit vash' e bukur.
Duke ëndur po këndon.

Natën fshati fle në prehje,
Kudo paqe mbretëron.
Nër kasollet ënden endra:
Shpresë jete që s'shtërron:

Zunë rehtë prap' tē shoshen,
Dbora bie me qetim,
Dheu mbulohet nē tē bardhë,
Me një robë plot shkëlqim.

P A M J E

Që lart nga qjelli
në hapësit, si lëmsh i zjarrtë,
u-rëkëllye djelli,
kur perëndoi.

Por mb'udhë, maje shkëmbi tē njej mali,
takoj tē jetë mali-i lartë,
me që dot hovin nuk' e ndali,
keq u përpoq, mënt kryet e dërmoj.
Një gjak tē kuq zu plagës hodhi,
u-skuqnë-edh' ujrat edhe toka,
u-skuqnë rreth e retë.
Por mentë kur i mblodhi,
kur pa q'e dhimpte koka,
plot helm u-shduk e shkavi tatëpjetë.

* * *

Në pikë tē vrapimit
i rodhi gjaku shumë;
fytyr' e tij u-skuq si prushi,
sado në det e lau sa mundi,
me gjeth' e pyjeve q'u-fshih
dhe tërë natën mbet pa gjumë
dhe prej dëshprimit
sysh derhte lot si kokra rushi;
se kur përtej u-duk prap nē mëngjes,
gjer sa u-gdhi,
s'i kish pushuar.

Dhe posa dolli, kryet shkundi
prej dhëmbjes së tmerruar.
Si gjaku mirë s'e kish lënë,
i pati lidhur faqet me një bres
dhe brezi lyer qe me gjak.
një bres i bardhë fijesh, si çdo fije lesh,
se lesh nuk ish aspak,
por ishin fasha resh,
fytyrës q'i kish venë.

* * *

Si hej zu gjaku shpërkënditej¹⁾ nga që redhi!
U-skuqnë prap edh' ujrat edhe toka,
u-skuqnë rrëth e retë;
tej kreshtë maleve me dborë shtruar
dhe bredhat majrave, q'u dukshin si burbuqe.
u-lyen ngjyrë trëndafili;
dhe deti i tërë u-bë pasqyr' e kuqe:
i larë qe me gjak sicili,
sikur prej dore magjistari t'ishin ndruar!

Më von, kur pa se dhembjet i pushuan,
shpejt fashat tej i hodhi.
kur pa se syt' i-u kthjelluan
dhe e ndjevi vehten më të lehtë,
zu mentë, prap i mblofdhi.
kur pa se me s'i dhimpte koka,
me hov, plot gas, u-hoth më qjell përpjetë.

HYMN HËNËS

Hën' e verdhë, hën' e bardhë,
S'je as mollë, s'je as dardhë,
Por je tokë pa një flagë,
Plot me rrudha, plot me plagë.

1) shpërkënditej = shpérndahej.

Hën' e artë, hën' e-ërgjëntë,
Se ç'i more botës mëntë,
As e bukur as me hije,
Faqe shtrige plot me lije!

Kot të thonë se je vashë
Ty sydjall e kokëtrashë;
Kur vjen rrotull na sbarth dhëmbët
Si kukuth t'u thefshin këmbët!

Djemt e vajzat q'ëndërrojnë,
Si fatore¹⁾ t'adhurojnë,
Kur me pralla rin' u kënda,
Që t'u-lozësh në shtrat brënda.

Magjistarët ty të shkelin,
Mendjelehtët që t'i mjelin;
S'di ç'të thonë, s'di ç'të lypin,
Buzë e gojë kur përtypin!

Ca të falen, ca të luten,
Ca për ty në zihje futen,
Ti nxjer gjuhën, goj'-tagare.²⁾
Që t'u tallesh si qyqare.

Herë nxihesh si një nëmë,
Herë ndritesh sa një lëmë,
Kur, si drapër, shtrigë nate,
Kur, gjysmake, sylugate.

Herë dukesh korë e artë,
Se je mvarur më të lartë.
Po lugetrit gjith arijnë,
Syt' e faqet të t'i grijnë...

Të gjith duall gënjeshtarë,
Si dashtnor' e vjershëtarë.
Më kot hymne ty të çohin,
Se ty mirë nuk të njohin.

1) fatore = që sjell fat të mirë.

2) goj' tagare = gojëmadhe sa tagari (mangalli).

Po tē dijnин, ti se ç'jeshe,
Gjak turinjtë do t'i keshe;
S'do t'të bënin aspak lutje:
Do t'të çporrnin dh'aq më tutje.

MALL NATE

Del hëna lëmsh si ar,
I.art bregut porsi korë,
Me rezet reth kurorë,
Çel buzët qesh si zanë,
Me kryet gjith më nj'anë
Dhe faqet plot me zjar.

Heth dritën nëpër gjeth
Gjith hargje edhe shigjeta,
Derth ngjyra faqezbeta;
Lot, tundet si fantomë¹⁾
E syëmbël hyn në dhomë,
Bën qarke murit reth.

Haj hënë m'u afro,
Kur shtratit jam i shtrirë,
Si vashë zemërmirë;
Mí ballët puthmë nxeh të
Dhe mallin tem të shkretë
Prej shpirtit ma largo!

DËSHIRA IME

Pylli, prozhmi ku bën hije,
Ku qetimi mbretëron,
Lule e bukur, ku po bije,
Er' e malit ku s'pushon.

Atje, shokë, atje dua,
Kur të vdes, kur të mbaronj,
Të ma bëni varrin mua.
Që të çlodhem, si kërkonj.

1) fantomë = hije.

Më largoni nga të qarët,
Që nér varret s'ka pushim,
Se s'kam punë me të marrët,
Që nuk dinë ç'ësht qetim.

Vaj pér mua, lottë janë:
Pikat vese në mëngjes,
Kur vjollca qan' më nj'anë,
Kryet unjur gjer në bres.

Majë kodrës në lendinë,
Afér pyllit plot me lis,
Ku me radhë zoqtë rinë,
Dhe mburimi murmuris;

Pranë ujit të kulluar,
Udhëtari ku qëndron,
Ku bariu rri i gëzuar,
Me mall zëmre po këndon!

Këto dua varrit pranë,
Të më qajnë me këndim,
Që u ka falurnymfa zanë,
Të zbavitin shpirtin tim.

S'kam dëshirë pér vajtime
Po lark Pllutonit të jem;
Ndaj Olympi, nér kthjellime,
Shpirtin tim dua ta kem.

ORA E ZEMRËS

Shkrihen ujrat nér liqene,
Qjelli fletët nis i hap,
Mbyllur zemra rri si qene,
S'do të çohet jashtë një çap.
Strehvet treten dhe krongjittë,
Shterrin lotet gjith pik-pik,
Zemra hesht e mbleth pëqijtë,
Me një sy më sheh të lik.

Maje biskut zogu tundet,
 Rreze vere gjith po pret,
 Gjumit zemra s'do t'i shkundet,
 As një ndjenj' asaj s'i flet.
 Kryet kacja¹⁾ qet si trime,
 Plafn²⁾ e bardh' e flaku tej,
 Tuf' e barit, dje si qime,
 Sot çel gishtarat musi hej.
 Dhe gjinkalla mer qitharën,
 Nj'arratitës vjershëtor,
 Rri mpreh zërin mi të parën
 Fije barit prendveror.
 Hapu zemrë, vjen prendvera,
 Rreze shkasin më çdo skaj.
 Mer lahutën, dil tek dera,
 Nisia këngës e mos qaj!
 Thuria këngës dhempshurije,
 Çele zërin magjiplot,
 Ligjératën dashuriye,
 Q'e dha Qielli dorëplot.
 Çohu zemrë, shteri lotet,
 Ejeri tingllit ledhatar,
 Se gjësendi s'vlejnë motet,
 Sa vlen çasti magjistar!

VEGIM PERENDIMI

Me sy habije shoh tej largësirën
 Dhe rehtë ndënë vetull si dremitin,
 Shoh rrezet qysh e prekin errësirën,
 Me mijra shtijza syresh që reshqitin.

I lodhur dalngadal po shdukët djelli,
 Sikur dikush që posht e heq pa reshtur;
 Porsi një libr' i math mbyll faqet qjelli
 Me pamjet madhështis' së tij të heshtur.

Dhe hije e murme vjen me fletët hapur,
 Me hovin e paprehur t'amëshimit,
 Nër thonjt' e saja shpirtin duk' ma kapur,
 Si bisha pa kurrfare përdëllimit.

1) kacja = lulja që del e para në prendverë.

2) plafnë = qilimin

Del hëna me syt' e saj dërptonjës
Dhe me vështrim të thellë magjistari,
Çdo send e namatis me hov qëllonjës,
Më deh me plot mënyra gënjeshtari.

Ndë heshtje dhe nér èndra bote së paprekur
E çanj mërgimn' e ndjenjave të mijas,
Me mëndjen tej pafundjen duk' e ndjekur;
Vëshgoj çdo hyll ta shkoj mi vigje e via.

Në luftë të pa reshtur jam me vehten,
Gjesend kërkonj t'i prur për ta kënaqur.
Por shoh fuqit' e mijas si po treten,
Sikur pa shpresë prap për të m'u-çfaqur! . . .

Nis endet dita prej plehures zezë,
Sa natës gjurmë fare më s'i mbetet,
Mi tokë, gjërrë shtrihet një tryezë,
Ku drita derdhet posht si ar që tretet.

I dehur jam prej bukuris' së ditës,
Prej kaltërsis' së qjellit të kulluar,
Q'e kqyr si çdo send me sy shëtitës,
Plot etje të një èndjes së pashuar.

E shoh si derdhet rrezja magjistare,
Në faqet si më puth me mall dashtnori,
Sikur që lart një dorë shpëtimtare
Ma fal sërisht ate që dje ma mori.

LETRE PREJ KATUNDIT TEM

Urdhëroni, zot, në fshatin tonë,
Me shtëpi të bardha si gjithmonë,
Me avlli dhe porta pleqërishte,
Gjith me buzëqeshje dhendërishte,
Ku dritaret qeshin bukurije
Nga të vëndit lule plot me hije:
Bozilok i gjelbër që mban erë,
Që të deh sikundër deh një verë,

Me 'të bashk' e bufka¹⁾ magjistare
 Që têrheq me pamjen ledhatare
 Dhe qershiz' e turpshme porsi vashë,
 Q'i çel sytht' e kuq të saj gjumashë,
 Si dhe karamfil' e trëndafili
 Që, pa dashur, vjen të fton sicili.
 Po të hyni brenda do të shihni,
 Si ju prehet syri nga q'e shtini:
 Në të bardhë muret gjith të lyer,
 Si një trup i paqm' i papérlyer.
 Dhomat, posht e rrotull bukur shtruar,
 Gjith me shtresa dore zonje shkruar,
 Q'u shkëlqeijnë ngjyrat qysh ylberi,
 Me fytyra shkabe dhe sklifteri;
 Prej shtëllungash, dita pa u gdhirë,
 Tjerur lesht' e bardhë, fijedlirë,
 Si velenxa, shkorsa²⁾ dhe qilime,
 Endur gjith me këng' edhe èndërime;
 N'avlimend punuar-dit' e natë,
 Siç tek na me zell punojnë gratë;
 Çdo q'u del nga duart e qendisur,
 Esht gjith lule-e flutura stolisur;
 Më çdo send të vet' e të shtëpisë
 Duket dora, mjeshtri-i bukurisë.
 Pa le djellit rrezet kur i çohen,
 Faqe, faqe ngjyrat sheh si ndrohen,
 Dhe kur hën e plotë vjen e bije,
 Sheh pallate prallsh plot magjije;
 Ku gjen krejt një pritje miqësore,
 Si nér viset tonë malësore;
 Tek ju presin, jo më pak bujare,
 Zonja si dhe vajza shtatkrenare!

Urdhëroni, zot, në fshatin tonë,
 Që pret dyerhapur si gjithmonë,
 Se mundimi kot s'ka për t'ju vajtur,
 Sado ment e kini për ta mbajtur!
 Se një drek' e darkë do të gjeni
 Dhe një shtrat të lirë ku të fleni;
 Dhe tek një të varfër po të shkelni,
 Pa ju pritur mirë s'do të delni!

1) Bufka = një illoj luleje.

2) Shkorsa = qilim me lesh dhije, që e shtrojnë në dhoma ku rrinë.

Ka sicili miqtë pér t'i prekur
Një lakror e mish a zog të pjekur;
Vez' e petka, gjalp' e kos a shalcë,
Po gjith aq të majmë mu si palcë!
Pa le qumësh, djath' e gjiz' e dhallë
Plot, se fshati ka mjaft gjë të gjallë,
Dhen e dhi, si kecër ka dhe shqerra,
Lopë e viçër, dema dhe mëshqerra,
Nër kullota çuar me barinjtë,
Të shijojnë barin e kérthinqjtë,
Dal nga dal kur kthehen mbrëma herë,
Fyell e këmborë zjejnë n'erë,
Tufa, tufa malit kurse vijnë,
Të ze malli kur po blegërijnë,
Që t'u-a mjelësh qumështin e majmë,
Siç tek na q'e kanë, ment sa mbajmë.

Urdhéroni, zot, në fshatin tonë,
Ku fryn er' e malit si gjithmonë,
Se katundi ynë, fala Zotit,
Eshtë plot nga çdo prodhim të motit:
Grurë ka, dhe misër e térsherë,
Pa le vreshtat, zot, kur janë bërë,
T'embël mjaltë rushtë si ngaherë,
Që del syresh fort e shijshmja verë.
Ka edh' arra e qershi e thana,
Po nér ne më shumë bëhen mana,
Porsi vethë varg q'u mvaren serët,
Gjer sa skuqen, nxihen në të berët;
Që, prej frytit tyre kaq të shquar,
Del një e pirë me-emër të dëgjuar.
Pa ka dhe fasule t'embla shumë,
Se burimet rjedhin porsi lumë;
Nér luadhe ritet bar me lule
Dhe në kopshte kunguj plot me tule.
Uj' i ftohtë derdhet nëpër kroje,
Ujë, q'ep shëndet po pive soje;
Që del malit, shket pér mes lajthije,
Gur mi gur me sulmin engjërvije¹⁾.
Pa ne kemi bujq e punëtorë,
Gjith flori që del ku venë dorë.

1) engjërvije = zhivë.

Në fshat tonë burrat nuk pértojnë,
Si diku që gratë t'u lërojnë.
Ca, dhe vatrës tyre në largohen,
Gjith pér fshatn' e vet' ata mendohen.
Nga të gjitha t'jetë plot shtëpija,
Siç' e do dhe nderi dhe vetija.
Portën miqve ne gjithmon u-a çelim,
Se zakonet, zot, ne nuk i shkelim,
Se ky vendi-i yn' munt ka të meta,
Po, pér pritje miqsh i tretet jeta,

PUNËTORI I MIRË

Ngrihet që me natë,
Pa dalë mirë djelli,
Mer që edhe shatë,
Pa u zbardhur qielli.

Nd'arë vete me gas,
Punon me dëshirë,
Dhe, dreka si u qas,
Ha edhe pi mirë.

S'trëmbet kur fryn era,
As shiu kur pikon,
Se këtu eshtë vlera,
Pér atë që punon.

Punën si e mbaron,
Që djersa i rjeth
Dhe djelli perëndon,
Ay veglat i mbleth.

Mbrëmanet në shtëpi
Nga puna vjen çlodhet,
Mer fëmijën në gji
Edhe ha ç'të ndodhet.

Vreshtën e ka kujdes,
Bagëtin' e ushqen,
Pa mjell nuk'ri në thes,
Të gjitha mir' i kthen.

Vjeshta kur afrohet,
Ay shtëpin' e mbush
Dhe ri e qetohet
Pranë zjarit me prush.

Sa gëzim ay ndjen,
Kur ka se ç'i duhet;
Dimëri i pëlqen
Edhe kurrë s'huhet.

Puna është një nder,
Për çdo njeri me mënt,
Përtimi është vrer,
Pa fjalë pa kuvënt!

P U N A

(pjesërisht)

~~perfektiv~~
Kujt s'i pëlqen të punonjë,
Ay s'munt të quhet njeri,
Se kerkon gjithë të ronjë
Me gënjeshtra e djallëzi.

Puna e nderon njerinë,
Ajo i sjell fatbardhësi,
E ka plot edhe shtëpinë,
Kurrë s'mbetet me dor' më gji.

Shumë jan' ata që rinë...
Dhe fëmija vdes urije,
Po të vështrojnë shtëpinë,
Mbarësia lark i shpie.

Natyra ka mjaft dëftime,
Që na mëson si të bëjmë;
Qi për ne janë burime,
Me mëndjen si t'i çbëjmë.

Shpesët, kafshët nat' e ditë
Gjithë përpiken për ushqim,
Edh'i kanë plot shtëpitë,
Sepse punojnë me mundim.

Ashtu dhe ne të punojmë,
Si duhet mirë për ushqim,
Begati të mos lakmojmë,
Se edh' ajo sjell hidhërim.

«NUSJA E MBARË!»
Buzëkuqurës

Tire leshtë e bardha Nuse,
Mer shtëllungën se shkon vera,
Leri fjalët se na krruse,
Se e ke dimrin munt te dera!

Bagëtin' e ke përjashta;
U myk bari nër luadhe
Dhe në lëmët kalbet kashta,
Ti po mbahesh zonj' e madhe!

S'bëhet kurrë puna vetë,
Lypset vendit pak të tundesh;
Mbet lakin me një petë,
Ti po krihesh e po shkundesh!

Nxir unazat, merr gjilpërën
Dhe qep linjat për fëmijën,
Qiti rrathet, përvish llërën,
U laj petkat, që t'u ndrijën!

Nér të huaj burri tretet,
Ti po ndreqesh me të kuqe,
Tjatër send ty më s'të mbetet
Veç për dita si burbuqe!

Gjith me djersa dhe mundime
Të mban murgu me të holla,
Ti nér endje dhe gëzime,
Kur me rrushka kur me molla!

Me pasqyrën gjith në dorë,
Mbet shtëpija e pa fshirë,
Ti po zbardhesh porsi dëborë,
Enët, vatra blozë nxirë!

Shko në magjet e bëj bukë,
Shih se brumi t'u-thartua;
Shtëmbat thahen dhe ti nukë
Del për ujë gjer në krua!

C'pret t'ët vjerrë plakë-krrusur?
Ngrehu zonjë, punën bëje,
Mos rri zemrës duk'i-u lusur
Dashuris' edhe çdo gjëje!...

Ti s'di fare ç'thotë fshati;
M'i derth flokët laqe-laqe,
Por, gjithmonë s'të ndih fati,
Se s'do kesh më sy e faqe!

SHPESET UDHETARE

Kurbelx

Tok mbledhur si nga mot
Po shkojnë ndaj mërgimi,
Nga kulmi, nga largimi
Na lenë «dam' tu mirën»
Dhe çajnë hapesirën,
I bien erës m' not.

Lark venë për ushqim,
E nxijnë qiellin, ngasin
Ethirit¹⁾ sipër shkasin;
Vjen dbora, dimri i mprehtë,
Kërkojnë vent të nxeh të,
Plot shpresë dhe kuxim.

Për gojen pa përtim
Mi dete, male shkojnë,
Rezikun s'e peshojnë,
Mundim edhe të vojtur,
Sejeta duhet rrojtur,
S'ka prehje as qetim.

1) ethirit = eterit, nëpër eter, nëpër hapësirë.



Asdreni në mes disa arsimtarëve të rrethit të Korçës — 1938

P O E Z I E R O T I K E

PREJ KATUNDIT

Vështro Kocin si po tundet
Me fustanen klinda bërë,
Udhës ecën, robës shkundet,
Që ta shohë fshati i tére.

Ndënë festë sërë-sërë
Mban baluket përmi ballë;
Dreth mustaqet si gjilpërë,
Djal' i bukur, djal' i gjallë.

Anterin¹⁾ e ka stolisur
Gjith me sumbulla, me lule.
Mengët, jakën të qendisur
Vija-vija plot pekule.

Mbathur kalcat²⁾ pulpës ngjitur,
Lidhur dizgat³⁾ çufka-çufka;
Me opingat majë ngritur,
Telatinë⁴⁾ plot me bufka

Mban silahun⁵⁾ me pallaska,
Me pisqollën⁶⁾ të férkuar;
Edhe unazë Koci paska,
Si një dhëndër i gatuar...

Por as Nonka faj s'ka fare;
Çup' e gjatë si selvia,
Faqekuqe si fshatare,
Që s'di ç'është djallëzia...

1) anterinë = petk me mëngë të gjata.

2) kalcat = kallçe, që i vishen këmbës nga poshtë deri në **gjuj**.

3) dizgat = rrypyat.

4) telatinë = llustrofini

5) Silahun = Brez i lëkurtë ku mbahen armët.

6) pisqollë = armë brezi me çark.

Në pasqyrë leshtë krehur;
Hundëhequr si sqifteri;
Me dy mollë ndë gjit mfshehur,
Afrôditë prej mermeri.

Lyer leshkat me vaj afshi,
Mban gërs hetat krahve zgjidhur,
Me mandilen¹⁾ prej miendafshi,
Majë kokës bukur lidhur.

Kur mëngjezit del në krua,
Si sorkadhe shkel ngadalë;
E përveshur si një grua,
Çupë trime, më s'ka fjalë!

Po edhe Koci poshtë s'lihet,
Se për Nonkën ka dëshirë;
Pranë krojtit ay gdihet,
Që t'a shohë ca më mirë.

Syt' i shtije ndënë vetull,
Me mall zjarri duk' e parë,
Kur me dorën ndënë sjetull,
Kur tek ujët duk u larë.

Me vështrime gjith të mfshehta,
Me shmbylljen të qepallës,
Dhe shigjeta majëmprehta;
Si ca gjëra të përrallës.

Po më kot ato shkëndija,
Prush e zjarr pa nonjë flagë,
Se shum' herë dashuri ja,
Sjell një brengë, hap një plagë.

Ment e tija po bare sin,
Endrash sytë i arratisen,
Porsi fluturat që vdesin
Pas një lule dhe shastisen

1) mandilen = shaminë.

Po edhe portës sa her' dilte,
Syt' i mbante tatëpjetë,
Kur i mbyllte, kur i cilte,
Me një ndjenjë, mall të mfshehtë.

Djal'i turpshmë kishte frikë,
Gojës fjalë që të nxjerë,
Se zakoni është një çikë
Nom i dytë, dhe ka vlerë.

Koci deshte, Koci priste
Veç një fjalë t'i dëgjojë;
Gjaku brenda i kërciste,
Për një buzë pér një gojë.

Kudo vente, mal a fushë,
Kur kulloste bagëtinë,
Sytë, vetullat e gushë,
Ishin èndrat pér të zinë.

Zjari flagë kish lëshuar,
S'ndjente vehten n'ësht' e tija;
Tërë ditën i menjtuar,
Nonka ishte perëndija.

Koha shkonte edhe më s'priste;
Shpresa Kocit s'i ishte thyer,
Si do puna që të ngjiste,
Nonkën s'kish pér te këmbyer.

Nonka hiqej çupë oxhaku,
Por as Kocin s'e harronte,
Me fustanen si zëmbaku,
Pranë derës kur po shkonte.

At' i saja re kish vënë,
Çuni portës shpesh se shkonte,
«Mirë dita» q'ui kish dhënë
Edhe syëmbël q'e shëkonte.

Trim i dukej në të dukur,
Syri i mbushej plakut tonë.
Djal' i fortë, shtat të bukur,
Njeri mali, si ç'e thonë,

Ay Nonkën dëshéronte,
Si pas sërës ta martojë,
Sa për Kocin as kujtonte,
Këndit dhëndër ta bekojë.

Po në botë shumë herë
Ngjasin gjëra të çuditëshme;
Kjo s'është èndër ashtu n'erë,
Por është punë si e përditshme.

Aq' më tepër dashuria
Me fuqin' e saj të mfshehtë
Këput hekura e dreth viaj
Dhe zbut zemra fare lehtë.

Kot as Koci s' u-mundua,
Se dëshirën shpejt e mbushi,
Për pak kohë djali u vlua,
U-shoijt flaka, mbeti prushë.

S'di se qysh u bënë fjalët,
Po një mbrëmë pushka krisi;
U pajtuan të dy palët
Pas ca javë e dasma nisi.

Si ndë dasmët ardhë miqtë,
Tërë fshati mori anë,
Dhe të mirët, dhe të liqtë
Në kurorë të gjith'vanë.

Si dy lule të rinjtë ishin,
Kishin bashkë dashurinë,
Gra edhe burra zili u kishin,
Kur u shihnin bukurinë!

.....

.....

Ish i lumtur pun' e madhe,
Sikur bota t'isht'e tija.
Gazi i Kocit kësaj radhe
Qe veç Nonka edhe shtëpia.

Kur të tjerët iknin, shkonin,
Zenin botën gjat' e gjërë,
Kamje, pasje të fitonin
dhe thesare për të bërë,

Kur po shokët pa pushuar
Shkonin, mernin arratinë,
Duke lënë të shkretuar
Si atdhenë edhe shtëpinë,

Vetëm Koci s'u mejtua,
Shum' të holla të fitojë,
Që të lerë fshat e grua.
Për të huaj të punojë..

Prej katundit s'u nda kurrë;
Dhe si trim që s'do të dijë,
Kish shtëpinë si një burrë,
Plot me pasje dhe... fëmijë.

S H E G A

Posht tek manat në livadhe,
Me një poçe buzëthyer,
Goj' e duar kuqelyer,
Po breth Shega si sorkadhe
Man pas manit, e rëmbyer.

Era hollë fryn nér fletë,
Manat bijen, asaj i venë;
Gjarpër syt' asaj i venë,
I sjell qerthull, dihet vetë;
S'dij se ka dhe sy që s'flenë.

Në tē mugët si ca hije
Tunden plepat e kërcasin,
Erës fletët i përplasin,
Shegës tmerr në gjak i bije,
Drihtha trupit gjith i shkasin.

Uj' i zallit shkumb' e valë
Qet mij' zera me t'u-derdhur;
Mbetet Shega dyll' e inverdhur,
Kur nga zérat ndjen dhe fjalë:
Pas dokush mos t'i ket' erdhur!

Porsi trime, s'i a ka frikën,
Çdo rezikut i bën ballë.
Doj tē dinte kush qe vallë.
Ndalet vendit e më s'ikën,
Por, s'pa hije gjëjegjallë.

Era s'lodhet duke fryrë,
Kur më fort e kur ngadalë,
Flokët Shegës i a bën valë
Qysh mi supe e mi fytyrë,
Fijet derdhën palë-palë

Me kuxim tē pa treguar,
Ngiritur heret, *gjinjsh e dlirë*,
Zbret nér manat fushës lirë,
Poçen doj pér ta rafshuar,
Mblith e mblith nga kish dëshirë.

Puna s'vete pas pëlqimit,
Të vesh dorë ku s'ke leje.
Qofsh e bij' e njëj së veje,
Po s'i vure fre lakmimit,
Dorës tjetrit bije preje.

Se dhe Lili, trim si Lekë
Prapa manit po rri fshehir,
Syt' e mendjen i mban mprehur,
Po pret gjahun që ta prekë.
Drejt në grackët q'i pat ngrehur.

Lili djali re kish vënë,
Për dit' manat q'i përfshihen;
Shkunden erës, vetë bijen,
Një me dor' ay s'pat zënë
Dhe kusarët as që dihen.

Si një hije Shega afrohet,
Pa mos dijtur çdo të ngjasë.
Munt të zotin që ta hasë,
Se me dreqin kurrë s'llohet
Dhe gjësend do të pëlcasë.

Gjith me mendjen në të mbledhur,
Lot gishtrinjtë si gërshtërë,
M'i mbleth manat gjat' e gjërë,
Drejt në poçe duk' i hedhur,
Si nga hera që pat bërë.

Pshtetur manit shëmbëllevi,
Se gjësend sikur lëviste,
Prij¹⁾ me frikë gjë mos ngjiste,
Sa dhe poçen diç' e thevi,
Kur pa vajza se ç'e priste.

Me vrapi Lili, plumb i sulet,
Me rrëmbim e kap pér brezi;
Shega pa se puna ndezi,
Doj t'i hiqet e t'i okulet,
Por ay s'e lij nga mezi.

— «Bjerma poçen, se thyej,
Shoh se qënke një kusare!
Mos e luaj dorën fare,
Se, pér besë, gjak të lyej,
Po m'u solle kundërshtare!

Në fshat hiqesh zonj' e madhe,
As s'të flet ty kush me gojë,
Kur del portës del me drojë,
Po pér mana nér luadhe,
Më pér turpin s'kë nevojë!»

1) prij = priste.

— Lermia poçen, Lil, të lutem,
Pa çdo faj kam pér ta larë!
Me ty s'dua t'jem e sharë,
As në zihje s'do të futem;
Di se je një djal' i mbarë.

Shoh se degët janë pranë,
Dhe, kur era po fullonte,
Pashë manat q'i rézonte
Kur këtej e kur mb'at'anë,
Gjë që mua më dëmtonte.

Lil, pér Zotin ty të pashë,
Prapa manit q'ishe fshehur,
Por me mendjen s'kam pandehur,
Që të sillesh aqë trashë;
Se në qesha, s'jam e dehur.

Sa pér mana, po të duash,
Mblith ti nesër nga të mijat,
Pse t'i shtojmë të këqijat,
Kot të rrish e të më ruash,
Kur i ndreqim bashkë vijat?»

Plot me sjellje ledhatare
Dhe me fjalë, ment i-a drodhi
Lilit, zëmrën-diq' i-a mvodhi,
Me t'i falur mij' thesare
Dhe çdo send asaj q'i ndodhi.

Manat qenë shkak i bérë,
Se qëllimin kush s'e dintë?
Gjë në mendjet n'ish q'u ndrinte,
Dashuria, thom, e tërë
Ish ajo në gjak q'u shkrinte.

Gjith katundi vesh pat marë.
Shegës gjë s'i mbetet pa thënë,
Mi të vjedhur sa qe zënë;
Dhe në dihej vajz' e mbarë,
Nuk dolli si pat qenë.

Goj' e botës zu të bredhë,
Gjëmë fjalësh soje rodhi.
Munt as ish ashtu si ndodhi,
Se në Shega doj të vjedhë,
Lili Shegën ish q'e mvodhi.

Vreshtës pjekur ishin rrushtë
Dhe nga manat q'ishin «vjedhur»
Dil rakija-ajo më e zgjedhur.
Mollët kuqur musi prushtë
Me sy bënin pér t'u mbledhur.

Që nga manat gjer në vlesë
Shum'i rëndë çapi s'ishte,
Zjarr i ndezur flagë kishte,
Të dy zemrat dojin vesë,
Si dhe lulet në lulishte.

Dasm'e madhe qysh gjëkundi:¹⁾
Përmi shtresat vija-vija,
Sa s'i nxente më shtëpija,
Lojti valle gjith katundi,
Të kënaqur nga rakija!...

THELENZA E LEKËS

Djal' i bukur si ndë prralle,
Që në krye e gjer në funt,
Shtat të naltë, sy të gjallë,
Çun i ritur në katund,
Një krijesë bukurije,
Trim i mbarë plot me hije!

Po ç'ka Leka që mejtohet,
Gjith i pshtetur mi një gur?
S'i qesh buza, as qetohet,
Por as këngës më s'ja thur;
Asaj kënge dashuriye,
Lart ndaj qielli që të shpie.

1) qysh gjekundi = si asgjëkundi.

Kthehet trimi mbrëmë fare¹⁾,
Fushës punën kur mbaron;
Ndaj shtëpia «dy dritare»
I heth syt' edhe rënkon
Për thëllénzën që rri mfshehur
Përmi shtresat shtrirë, ndehur.

Kur shkon rrugës ndaj deriçka,
Majë këmbës thumb më thumb,
Heth thëllénzës me guriçka,
I bën shënjë si pëllumb;
Veç fytyrën t'i vështrojë,
Zjarri i zemrës që t'i shkojë!

Sot ashtu dhe nesër ndryshe,
Endra Lekës shpejt i del,
Se Thëllenzën dallëndyshe
Me mall zjari e përkëdhel,
Gjith me fjal' edhe premtimë
Për një pritmje me gëzime.

... Nd'atë vent të parën herë
Ajo dorën kur ja dha,
Kur prej gazit që kish ndjerë,
Një lot faqesh dheut i ra;
Çel një mbimë plot burbuqe:
Trëndafil me lul' të kuqe.

NË KRUÀ

Nga ditë del në krua,
Me stomnën shkon në dorë;
Peqinjtë gjer në bres,
Lan këmbët në përrua
Të bardha porsi dborë,
Për mbrëma, pér mëngjes.

1) mbremë fare = vonë fare.

Së largu Nereidë,¹⁾
 Prej detit sikur dolli,
 Si shkumbë plot shkëlqim;
 Si një Karyatidë,²⁾
 Fidias që e polli
 Në botën për kujtim.

E trembur si sorkadhe,
 Prej gjëmbi si e çpuar,
 Heth sytë me habi.
 Çudi' e saj e madhe
 Ish, kur, duke u-afruar,
 Po sheh një trim të ri.

Mi kaln' e tij si reja,
 Fatosh, çudi e rrallë;
 Symath, mustaqezi,
 Vështrimet si rrufeja
 Ja heth asaj përballë,
 Me syt' sikur e pi.

Plot gas e buzëqeshur
 Ndeh dorën edh' i lutet,
 Pak ujë ay i kërkon³⁾
 Dhe rri mi kalë shqjeshur
 Sa syri s'i çkëputet
 Prej drithës q'e verbon.

.....

Plot turpit ajo syve,
 Me kryet tatëpjetë,
 Zgjati enën pa një zë;
 Nga dridhjet e të dyve
 Derptimet⁴⁾ ah, të mfshehtë,
 Ra stomna, copë u-bë! . .

1) Nereidë = personazh mitologjik i grekërve të vjetër, «Zana» te na.

2) Si një karyotidë, Fidias që e polli në botë për kujtim = si shtatorja e karytidës (personazh femër i mitologjisë greke), punuar nga Fidiasi skulptori i famshëm i Greqisë antike.

3) shqjeshur = pa armë në bres.

4) dëftimet = tronditjet e brendëshme shpirtërore.

BUKURIA

Kasolles pér mëngjes
Del vasha mveshur hollë,
Me gjiret si dy mollë;
Kri anës vijës lahet,
Kur shihet dot më s'mbahet;
Lesht' derdhur gjer në bres.

M'e bukur as më s'ka.
Ndë syt' ajo si njihet,
Kur faqet sheh dhe ijet;
Prej gazit qesh e nxehet
E me ënda malli dehet;
Si veten shoqe s'pa.

Frym era, leht' ushton.
Dhe vija si pasqyrë
Ndron faqe, ndron fytyrë,
Si pënda dridhet, tundet;
Prej shelgjesh gjeth ze shkundet
Hap redhe ku pikon¹⁾)

Një dridhje zemrës ndjen,
Kur sheh se bukurija
I ndrohet rudha e vija,
Kur vetullat si hargje
Dhe leshtë unazash vargje,
Si ç'ishin më s'i gjen.

..Sheh trimin tej kur shkon,
Syzjarri plot shigjeta;
Depërtime ndjen të mfshehta.
Heth sytë prap' te vija
S'sheh gjë vec hij' e tija.
Qesh nd'uji... èndëron.

1) Prej shelgjesh gjeth zë shkundet, hap redhe ku pikon = Mbi vijë, aty ku bien gjethet nga shelgjet, kafen rrathë.

NJI ORË LUMTËSIE

Hëna ndritte porsi ërgjënt,
Kur ndë kopshte bashkë vinim
Dhe me dorën mi krahun tënt
Të ndihnga mi bar të rinim.

Ah! sa ëmbëlsirë ndjeva
Kur dorën ma zgjate,
At'her fare më s'e mfsheva
Mirëdashjen zëmrës sate.

Lulet na çonin një erë
Shum' t'ëmbël e të pëlqyer,
Edhe zefirët ngaherë
Na kujtonin pa kurcyer.

Rezet që na përgëzonin,
Kur ishim të përqafuar,
Dashurinë na e shtonin
Me një mall të paharuar.

Sa fjalë t'ëmbla më thoshe,
Kur përkëdheleshim të dy,
Dhe me syçkat bukuroshe
Më bënje të mos ndahem nga ty.

Po dyshimi nuk më linte
Të të besonj se ti më do;
Si hëna rezet q'i mfshinte
Dhe i conte ku desh ajo.

Veç ahere kupëtova,
Se je zemër plot mëshirë,
Dhe veten time e ngrova,
Kur më puthe me dëshirë.

TI ME SY TË ZINJ!

(këngë)

O moj ti me sy të zij,
Q'i ke flokët por si ar,
Eja mezin të ta mar
Se po s'ardhe do t' të vij!

O moj ti me sy të zij,
Q'i ke buzët si qershi,
Falma dorën e mos ri
Se po s'ardhe do t' të vij!

O moj ti me sy të zij,
Me vështrimet si rrufe,
Falmi sytë që më sheh,
Se po s'ardhe do t' të vij!

O moj ti me sy të zij,
Me ato lule rreth në bres,
Nem një lule të mos vdes,
Se po s'ardhe dot t' të vij!

KTHIME

Kur të pashë më s'të lashë,
T'u-afruash e s't'u-ndashë
Dhe me zë t'ëmbël të thashë:
«Sa të dua o moj vashë!»
Edhe më gjunjë të rashë,
T'u-luta gjer sa u-vrashë.
Po nga zëmra pshëritëta,
U-treta u-lebetita,
Se asnjë fjalë s'të qita,
Gjer sa shpresën far' e ngrita,
Se m'u-mërzit sa të prita,
Aq sa u-ngrys edhe dita.
Vetëm pastaj un' u-zgjova
Dhe mëndjen time e ndrova,
Kur zemrën ta kupëtova
Dhe ika e të harrova,
Nga tër' mundimet shpëtova,
Si edhe shpirtin e qetova.

Pastaj ti mbrëmanet herë
Më vjen rotull si një shqerë,
Si një flytyrë ndë verë
Dhe më lutesh aqë herë;
Po tashi shëko të tjerë,
Se s'të dua moj e mjerë.

MALLI I PESHKËTARES

Peshkëtar, peshkëtar mos nxito,
Mbaje lundrën e më vënt qëndro,
Se më kënda të t'shoh!
Peshkëtar, qi ujën e trazon
Dhe me krahtë valat i mërgon,
Ktheu e më shiko!
Peshkëtar, qi deti s'të tmeron,
Kur ay mfryhet ti zë këndon,
Ktheu mos më harro!
Peshkëtar, qi ke djellin për shok,
Hënën si edhe gjith yjtë tok,
Prit, prit mos u-largo!

FUQIA e DASHURISË

Kur era fryn me ëmbëlsi
dhe faqen ma përkëdhel,
Ah! ahere ndjenj një fuqi,
qi zemrën sikur ma çel!

Kur djelli ndrit me ngrohtësi
Edhe trupin ma gëzon,
Mendja më iékën me vrapsi
edhe ëndëra vështron.

Kur henëza me mfshehtësi
mi mua rezet i çon,
Shtrihem se jam ndë qetësi,
Po gjumi nuk' më pushton.

Kur rehtë janë ndë gjëmim
dhe koha rëndë mvrejton,
Gjaku im éشتë ndë trazim
dhe shpirtin ma turbullon.

Kur deti zjen me duhi
edhe valat i shëkonj,
Aher' menjtohem si e si
atje të hidhem t'shpëtonj.

Por kur krahëtë mi zgjat ti
edhe' un të përqafonj,
Oh, mbaju zemër se tashi
dua edhe që të ronj!!

DASHURO!

X ✓ Shëko lisi si më flet,
Fjalë t'embla si më ushton,
Degët unj e më thërrret:
Dashuro, se koha shkon!

Maj' e plepit gjithënëjë,
Kur tunt kryet më qërtan,
Përpjek fletët më çon zë:
Djalë ç'pret e s'dashuron!

Er' e malit me një ushtim
Dhe mburimi që kullon,
Gjith më thonë plot gëzim:
Dashuro, se koha shkon!

} Kopshtit vasha që po pret,
Si zog pylli që këndon,
Buzëqeshur më thërrret,
Djalë ç'pret e s'dashuron!

Mua zëmra gjith më reh
Brënda gjaku më valon,
Ma ndes mallin më vë re:
Dashurô, se koha shkon.

} Çdo gjë rrötull më pyet:
Djalë ç'pret e s'dashuron,
Ditët shkojnë,jeta shket,
Dashurô, se koha shkon!

KUJTIMI I SAJ

Çelim lulet plot burbuqe,
Trëndafili lëshon erë,
Mbusket fusha lulekuqe,
Kalli gruri nis të nxjerë.

Mua malli më ka marrë
Për natyrë për prendverë,
Dhe sa syri më ka parë
Prapë s'nginjet nonjë herë.

{ Por kujtimet nuk më ndahen,
Mëndja e ime nuk lagrohet,
Zemrës, lëtet kurrë s'lahan,
Kur ajo më mfyturohet.¹⁾

BALLADA E BARIUT

Në rahje drite, malesh i qarkuar
Ish një pallat me pamje madhështore,
Tek rij një bijë mbreti syqjellorre,
Me flokë t'artë krahve të lëshuar;
Hyllesh' e bukur, plot risi verore,
Magji shpërndante, hire perëndije,
Sa, trëndafile, vjolca dhe shpatore
Nakar i kishin nga q'u bënte hije.

Në rahje zemre malli të pashuar,
Nérëndra dehje t'ëmbla dhe gazmore,
Prej buzëqeshjes saj përkëdhelore
Dhe zoqtë cmiri zen' e kishin ndruar.
...Së largu n'erë tingëll vij këmbore
Dhe fyelli me vaje dhempshurije;
Me dhen rrëth pikaloshe dhe leshtore
Rrij një bari që tretej dashurije.

1) mfyturohet = përfytërohet.

Në rahje shpresash, èndrash i errësuar
Prej bukuris' së rall' e shëmbëllore,
Me dridhje përkëdheljesh prendverore,
Dritares syt' i conte pa pushuar.
Q'i vogël ikur vatrës tij prindore,
Pa shokë dhe nér vise vetëmije
Dh'ay massi krijesë qe njerzore::
Njëj zjarrit tretej, zjarrit djalërije!.

Në rahje mendje truri të menduar,
Me drithma të panjohura trupore,
I shigjetuar prej së ndritshmes **kore**,
Që mënt' e kres' i-a kishte mjergulluar,
Gjith priste çastin e së lumes **ore**,
Të lumen **orë** çasit **mrekullije**,
Që **veç** t'i prekte gishtin e njëj dore:
Si shënje njohje, shënje miqësije.

Në rahje gurësh uji të kulluar
Me vrull' i derthte valat tingëllore
Një lumë rreth banesës mbretërore
Me pika mij' ylberesh i trazuar.
Kur djelli shkrepte rrezet mëngjezore,
Një zë dil valës rrebtë, zë magjije,
Aq sa gjëmonin grykat malësore
Dhe drita tinglesh endej fije-fije.

Më kot po pret ti buzët èngjëllore
T'asaj që kurr'o djalë ty s't'i bije!
Aty qëndro, me lulet rro fushore
Bari, njëj bije mbreti s'i ka hijke!..

....Në rahje fletësh vjeshte së vonuar
Dhe lote hyjsh e hëne mbrëmësore,
Nér blegërima berrash fatmizore,
Heq shpirtin një bari pa u-kunguar.

E BUKUR' E DHEUT

Që lart nga reja ka pikuar,
Shëndrit si gur margaritari,
Si pika e vesës e kulluar;
Agim mëngjezi, dritë ari,
Magji' e prallës pa treguar.

Ndë buzët ngjyrën e qershijve,
Ndë syt' të kaltërtit e qiellit,
Ndë lesht' të verdhit e kallijve;
Fytyr' e saj si drita e diellit,
Dhe trupi hiri i perëndijve,

Mburim e krua bukurije.
'Saj i unjet madhëria e mbretit.
Kur del, le gjyrmë prej shkëndije,
E bardhë porsi shkumba e detit,
Ndë pamjet një verbit magjije.

Del soje drita e vërtetë,
Fytyra e saj shkëlqen si korë,
Si reze ndrit, që prur gjith jetë;
Sikur mban qiellin, yjt' me dorë:
E bukura ësht e dheut vetë!

Të gjith i falin shpirt e zemër,
Se shëmbëll shoqë s'ka në botë,
Nër lulet lule ësht më emër;
Kushdo q' e sheh s'kuxon të thotë:
Se nuk' ështëngjëll, por është femër.

Luani i fortë krejit¹⁾ zbutet,
Kur ijet i sheh dhe bukurinë;
Dhe murgu shenjtit kur i lutet,
Shigjetë e pëershkon të zinë,
Si hyll prej qiellit kur çkëputet.

1) krejit = krejt.

Dhe mbreti qoft' a punëtori,
Për 'të shpesh zemra u reh të dyve.
Fetari qoft' a vjershëtori,
U merret mendja, drita e syve:
Demon, që gjyqin¹⁾ shpejt ta mori!

TINGËLLIMË

Qante Erosi, lot derthte lumiit anës.
As dielli rezet të arta më s'i a conte,
Po me trishtim i shtrirë dheut rënkonte,
Si një që vdes në ramjet e këmbanës.

Në shpirt plot helm, se format e Dianës
Më s'dukeshin' tek ujët që kullonte,
Veg erë vjeshte shelgjet i trazonte.
Dhe fletët laheshin në vënt të zanës.

I dukej nat' e zezë jet' e tija,
As sytë s'kishin më shkëlqimn' e zjarrtë,
Sepse me kohën bashk' i u shojt risija.

Kot Erosi po priste prap' të kthehet,
Kot e kujtonte trupn' e saj të kjartë:
Se jishin èndra plaku... shpesh që dehet!

N A R Q I S I²⁾

Te një lëndinë mali me breth e lis qarkuar
Qe një mburim me famë, pa reshtur që mburonte,
Me nj'uji-ërgjend, i pastër, se vesa m'i kulluar,
Se çdo rrugtar pa dashur një grim' aty qëndronte.

Një çun bari, Narqisi, sa her' aty qëndronte,
Prej bukuris' së vet po tretej si-i hutuar,
Aqsa për çast fytyrën vij n'uj e pasqyronte,
Gjer sa i-u bë sëmundje pa bar, për t'ia shëruar.

1) gjyqin = gjykimin, mendjen.

2) Narqisi = personazh i mitologjisë greke.

Ehko-ja nymfë ushtore, keq syrin i-a pat vënë,
Por s'di, bariu i mjerë në lule qysh u-ndrúa;
Në lule ngjyrëverdhë, në lule shënjë zije.

Për mallin e djaloshit, në vojtje q'e pat shtënë.
Më kot jehon Ekho-ja dhe sysht derth lote prrua:
Se fli sëbashku ranë prej malli, bukurije.

THAISA

Qysh sot edhe në kohërat e lashta
Shpesh etja ndizej pas njëj bukurije.
Zjarr merrnin ndjenjat, flagë si merr kashta,
Veç për një ças të shkurtër lumtërije.
Valltarja Thaisa trup e mes kérthijnjét,
Rinis' s'Athinës ment' i a ishte prishur
Dhe filosofët pleq e flokëthinjét
S'i ngopeshin gjith pranë duk' e grishur.
I madhi Leka, Zot i gjithë botës,
Dëshirë pati pas ta kish me vehte.
Për dashurin e tij ndaj mendjekotës
S'i ndahej duke humbur dit' e natë.
Nër kupa t'arta vera rithte lumë
Mbi shtresat më të shtrejta njëj Asije.
Të përqafuar binin shpesh në gjumë,
Duk' e kaluar masën çdo liri.
Nër kthethrat e pat kapur si tigreshë,
Çdo ças me te, pushtuar goja-gojës,
I lypte, sikur t'ishte mbretëreshë,
Me piska zjar t'i fusë Persepøjës.

MOTIVE TË NDRYSHME

PËR GJAH

Fyshekët për brezi
Dhe pushkën mi krah,
Pa zbardhur mëngjezi
Të dalim për gjah!

O burra bre shokë,
Rreth hapur të gjith,
Vënt zini mi tokë,
Lart malit më vith!

Thëllënza edhe rosa,
Dhi t'egra mjaft ka;
Arinj, dera, dosa,
Sorkadhe si ka.

Nosita edhe shkurta,
Plot turtuj ndë gjeth,
Verdhashka të urta,
Kot plumbin s'e heth!

Bam, bum! të kërcasë,
Drejt plumbi mi 'to,
Mberdhe¹⁾) sa t'pëllasë;
Mer gjahun dhe shko.

Në krahtë ngarkuar,
Gjithkush në shtëpi,
T'i hajë i gëzuar
Për ditë nga tri.

Mësallës t'i shtrihet
Me verë rush-zi,
Dhe rrojtjes t'i vihet:
Me hâ edhe me pis.

1) mberdhe = përdhe.

Gjithë shpesët me fole,
 Gjithë bota më shtëpi,
 Vetëm qyqja mbet si qe,
 Zog i shkretë dhe fatzi.

Si vjen prilli, nis këndon
 Pyll më pyll e gjeth më gjeth,
 Këngë-e vaje gjith lëshon,
 Tunden malet lis e breth.

Me zjarr këngës kur ja shtron,
 Zemrës mallin na e nxjer.
 Pylli, kodra rrëth gjëmon,
 Radhas kuku! kur i-a mer.

Shum' i kënda, kur ja thur,
 Si kasnec i lajmes re;
 Veç që zemrën e ka gur,
 Rron si murgu, s'ka fole.

— Përse qyqe nuk gjen shok,
 Pse arratisesh bri më bri?
 Pse s'afrohesh të jesh tok,
 Siç e la një Perëndi?

Përse qyqe s'më dëgjon,
 Fjalës seme s'i ven vesh?
 Pse si brumbull breth, kërkon,
 Jetës shijen që t'i a gjesh?

Kur këtu e kur atje
 Del e shdukesh si skifter.
 Shkoj qershori, ti më s'je,
 Sikur bije drejt në ferr.

Ze vjen vjeshta brym' e shi,
 Kohë e dimrit me cingrim.
 Ti gjith vet' o zog fatzi
 E shkon jetën në harrim.

Shih bilbilin një trupmi,
Dëllëndyshen sygjarprush,
Dhe thëllënëngjyrëhi,
Me folenë si gjithkush.

Ndo lavroshen krahëshpejt
Shkurtë-e turtull a po çdo,
Ndo mëllinjën këmbëdrejt;
Palë-palë i sheh kudo.

| Ve ti pjell e ve ti s'ke,
Rron e lirë e pa kujdes,
Zogj' e tu se ku i le,
As të hyn ndopak në thes.

S'të ka hije qyqe aspak,
Kurse mëndjen nuk' e shtron,
Çdo gjë e gjallë që ka gjak
Mbi dhet posht' e vetëm s'rron.

Veç në goftë se ndoj³ mëkat,
Farës s'ate i ke çpërblim,
Zog i mjerë n'e paske fat
Ta shkosh jetën në mallkim,

Ero pra, qyqe nd'arrati,
Se ky qënka fati-i yt:
Gjith pa shok e pa shtëpi,
Gjith me vaje e lot në syt.

FYELLI

Kujtim Dëshirës së pashuar të
Naim Frashërit për bagëtin' e
bujqësin' e Shqipërisë.

O fyell, t'adħur onj me mall e besë,
Se bashkme zérin tēnd hyjnor jam ritur
Qékurse njoha djaléri.
Se ti në shpirtin tem ke derdhur vesë,
Në kulme gazi ndjenjat duk' m'i ngritur
Me një tē rrallë dhempshuri.

Me tyn' e ndjeva mallin e pashuar
Të dashuris' së tokës arbënore,
 Q'e kam për dita n'endërrim.
Me tingllin tënd, kujtimi-i kohës shkuar
Nër ment më shkon me plot flladi verore
 Dhe me të thellë ngazëllim.

Ti kur i a mbush me plot e kur i-a thusa,
Sa zërat ven, e vijnë palë-palë,
 Si valle vargut èngjëllor,
Si shok në zë ke kodr' e mal e prrua,
Porsi prej goje zane t'jet'i dalë
 Prej njëj pallatit madhështor.

Qysh drit' e hyllit shket mi rreze hëne,
Me faqet e liqenit duk' u çmallur,
 Me drithma droje si dashtnor,
Dhe verbi i yt, lajmtar i njëj së thëne,
Të bukurës së dheut me zë të çpallur,
 Blaton nér ne fullim veror.

Kurse prëndvera gjiret nis t'i çelë
Dhe, me t'i hapur kraht' e saj të gjërë,
 Na jep fuqi dhe hir qjellor,
Dhe ti, kur gishti gamat nis t'i shkelë
I jep të re fytyrë botës tërë:
 Krijon rreth nesh një kor gazmor.

Bariu me ty nér bjeshkat del e çmallet,
Me vaje tinglesh, vaje plot magjije,
 Çdo zjarr të zemrës që ja tret.
Me ty të rinjtë radhas heqin vallet,
Të shtyrë prej së shenjtës dashurije
 Në gjinjt' e saj gjithmon q'i pret.

Sikundër gjethet hollë dridhen n'erë,
Aq sa nga drithm' e tyre këngë çpallen,
 Duke trajtuar harmoni,
Dhe zërin tënd kushdo q'e ndjen përherë,
Kujtimet e harruar prap i ngjallen,
 Mu si një qjelltë symfoni.

Del bujku ngul parmëndën, shpinëthyer,
 A korr kallint' e pjekur bukëprurës,
 Q'as vëtë s'di pér kë dërsin,
 Me ty çdo breng'i shkon duk' u shdëfryer,
 Sikundër' i shkon edh' etja n'ujt' e gurrës
 Q'e kap me grusht edh' e përpin.

Dhe prindrit tan' e kohës së larguar
 Me ty në brest e shpatë në përdornin,
 Ja mbushnin këngës plot me zjar,
 Nër luftra trimëri duk' u-flakruar,
 Gjithmon' kurorë mundjeje të korrnin,
 Si ç'korrtë Leka legjendar.

Plot andje dhe Minerva perëndesha,
 Me tyn' e shkonte kohën nér défrime,
 Lart tek Olympi shkreptimtar,
 Dhe Nymfat rrëth e rrrotull si hyllesha,
 Me valle çaprythmike dhe kërcime,
 Ndërsenin Bakhun ziliqar.

Virgjili, mjeshtër këngëtar me famë,
 Nér shekuj aq' të tjer' e qysh Mozarti,
 Prej teje bëjtin shenjt alltar.
 Me tyn' èndërrijtnë popuj q' as i pamë,
 T'ushqyer idealesh që së larti,
 Prej njëj burimi shpëtimtar.

Sado të tjerë sot ta zunë rendin,
 Si shenj' e re të njëj qytetërimi,
 Që s'njeh në botë kundërshtar.
 Por vjershëtorët hymne ty prap t'endin,
 Se, mi të gjith' prap ti plot forcëtrimi
 Qendron, o fyell magjistar!

TINGËLLIMË

Këndoni djema e ardhmja është e juaj;
 Risija¹⁾ është një lule, bukuri;
 Gëzoniju tashi në moshën tuaj,
 Si edhe prendvera rrëth kur derth magji.

1) Risija = rinija.

Dhe gruri fushës korret, bëhet duaj.
Çdo lule çel ndë kohë, s'ka se si,
E paktë ësht jetë, moti sa një muaj;
Dëfreni e valle drethni përsëri!

Shkon koha e bukur, vjeshta vjen afrohet.
Ze bryma mi fletë e gjelbërime.
Fytyrës s'dheut si faqe e ngjyrë i ndrohet.

Dhe ju të rinj, me këngë edhe gëzime,
Ngadal' bryma mi kryet kur t'u shtrohet,
At'her si pleq... dëfreni me kujtime!

KUJTIME TË SHKUARA

Ku munt t'ju gjej, o shokë djalërije,
Që ta shijoj prap kohën e pëlqyer
Të çastit, që na mbushte lumërije,
Kur losnim varg, me gaz të padëftyer?

Aspak s'na ndjentej shpirti pik mërzije,
Prëndvera zemrës krejt na qe mbërthyer;
Nuk dinim se kjo jetë plot mërije
Të tret pa shpresë gazi për t'u-kthyer

Si fletë vjeshte e tundur prej çdo ere,
Si ças fatbardhësije që s'vjen fare
A porsi një ëndrë e shdukur nate vere,

E ndjen, e sheh, si shpresat udhëtarë
Të prurin ëndje kur-e-kur papritur,
Si drithë hëne fushës së zhuritur.

KOTESIA

Në qytet, nër kisha gjith të vjetra,
Do varre shoh rrënime, të harruar,
Përmi mermert q'u duken disa letra,
Mishkrime të njëj jetës perënduar.

Ca, thyer copra, posht' e lart tē hedhur,
Disa si pér t'u tallur bérë shtrojë,
Tē tjerë grumbuj murit pranë mbledhur
Si gjë që s'ka më kush pér 'ta nevojë.

Shkon bota, syt' i heth mi ta shum'herë.
Por, si çdo send që shpesh e gjuan syri,
S'i jep ndopak as rëndësi, as vlerë,
Kur sheh se gjë, në pun' askujt s'i hyri.

Kush munt ta dijë ç'kanë qënë vallë?
Se letrat krejt prej kohës janë ngrënë:
Veç si kuror' u duken lart në ballë
Do flet' ullinjsh e lisi rrrotull vënë.

Kush munt ta dijë me sa shpresa rrojtnë
Ata q'i dirgjen hijes s'amëshuar?
Kushdi me fatn' e njerësve sa lojtnë,
Sa ranë fli nér këmbët tyre shtruar?

Me lajka munt sa qenë gjallë rrojtnë;
Munt pa kujdese jetën e mbaruan;
Më tej se vehtes tjatër botë s'njojtnë;
S'u dhembi munt sa lote që pikuan!

Pas, munt, se lanë bij q'i trashëguan,
Nér andje, munt, që pasjen e shpérndanë;
Veç pér një copë her' edh' u harruan,
Qiri tē ndezur buzë varrit s'panë.

Besonin se, po vdiqnë vet' një herë,
Ka pér t'u-ndritur varri pér gjithmonë.
Nuk' dinin se do flenin si tē tjerë
Q'as shenjë më s'u mbetet në tē vonë!

Kurrkujt s'i dhemp, pér ta, kujdes tē ketë.
Përsipér shkelin njerës dhe bagëtia.....
E vetmja veprë pa themel në jetë,
Nj'ashtu si ç'po u-a donte kotësia.

PASQYRA

Kurrgjë nuk jam në botë!
Një veglë jam pa shpirt e jetë,
Një qelq, si gur i ftohtë;
Zili ndokush as munt të ketë,
Veçse në goftë mendjelehtë.

Njeri s'trazonj me dorë,
Se duar s'kam, as këmbë e gojë,
Jam varur musi korë,
Më prek me dorë kush të dojë
Dhe s'di se si të më nderojë.

Të gjith kujdes më kanë,
Më vënë tek u vjen më mirë;
Më mbajn' e shtratit pranë,
Për dita faqet duk' m' i fshirë,
E bukur t'jem si vajzë-e dlirë.

Sa veta që m'afrohen
Të gjithë më vijnë duke qeshur;
Kur mvishen a kur ndrohen,
Shpesh, kur i shoh edhe të çveshur,
Më kqyrin ëmbël, buzëqeshur.

Më tepër e më dendur
Shoh zonj' e vajza kur ndërtohen;
Dhe burra shoh të çmëndur
Përpara meje që t'harrohen,
Të zbardhin dhëmbët, shtrembërohen.

Por fajin s'e kam unë,
Në dashkan që të përkëdhelen
Dhe s'kanë nonjë punë;
N'u kënda dit' pér dit' të çelen,
Mëri s'u mbaj gjërsa të velen.

Po ku më ze çudija,
Pér ca që kohën e humbasin!
Dhe zjarr n'u merr shtëpija,
I shoh se kokën as e vrasin,
Po shpesh, dhe vehtes zjarr i kllasin.

ARTIKUJ, DOKUMENTA, KORISPONDENCE.

DY TRI FIALË PËR OXHAKSINË

I shtrenjtë atdhetar. Unë nuk munt të ju kundërshtohem për punëra që muntai t'i gjykon si më mirë se të tjerë, por e dreqtë së dreqtës, munt të thom se kanë arësy disa shqiptarë të zemrohen për shkakun e bejlerëve. Sa për punët e tiera nuk përzjehem.

Në është që të bëhet Shqipëria më vete, e si ju thoni ndë «Albania e vogël», që, kurrë mos u bëftë, nëmos qoftë se të tërë shqiptarët nukë do të gëzohen ndë të drejtat e tyre, dhe në duam të vemë pas mendimit të madh që thotë: Egalité, Fraternité, Liberté, ahore c'nevojë të jetë kombi ndarë në shkalla, me zotë e me robër?

Shqiptarët përparrë kanuneve duhet të jenë një. Titllat të shporen, madhësi nuk duhet.

Apo si, besoni që oxhakësia të urdhëronjë si sot edhe ahore? Në është ashtu, nuk duhet qeveri, kur oxhakësia qenka m'ë fuqishme se qeveria.

Të jetë oxhakësi, po të jetë secili për vehten e tija. Si? ahore ata të tjerët do me thënë janë të poshtër, zëri i tyre të mbytet e në duan të kërkojnë një të dreqtë, edh'e cila është në dorë të oxhakësisë të mos kenë leje këta të ngrihen më sipër nga frikë oxhakësisë?

Jo! në është që të bëhet siç kemi qëllim, të gjithë shqipetarët si qytetarë të jenë më një shkallë.

Titlla si, lordër, kontër, baronë, të lipsen, aristokrati s'duhet, se në qoftë kështu me të tilla fisnikësie, ahore 'çduhet liria, kur nuk munt të jetë për të gjithë, po vetëm për një anë të kombit, c'duhet qeveri, kur oxhakësia është zëvëndës qeverie?

Ato që kini shkrojtur te Albania Nr. I, mot i pestë nën titllin «Shqipëria me 1801 e më 1901», janë me aqë rëndësi e aqë të drejta, se na rëfejnë të vërtetën. Pra, besoni se më një mot ukëmbyen punërat? Se ahore thoni se të paka shtëpi kanë mbetur e më të shumtët bejlerë vanë në Stamboll...

E si? tashti u këmbyen e vetëm ca vanë në djall, edhe të tierët u penduan njierjesh, sikur i përktheu ndonjë me stap të magjepsur?

E dini fort mirë sot si është, e munt Zotria juaj nuk i dini aqë, se jini ritur në mes të botës së qytetëruar, si ron gjindia ndë Shqipëri. Edhe unë s'i dinja, se i keshe haruar, po tashi e

dy viet, kur më shpuri fati të vete prapë, vallë si besoni se i gjecë? Gjithashtu si q'i kisha lënë. Parësia mbretëron, edhe gjindien ta shëkosh, të këputet zëmra.

Kur shkojnë bejlerët udhës, edhe gurët hiqen më nj'anë, pa le që njerëzit që dridhen kur u dëgjojnë zënë. Kurrë s'kam dëgjuar (edhe në janë, ata janë fort të rrallë) një bej të zgresë më poshtë e të pyesë një të varfër si shkon, sikundër shohëmë nëpër vise të botës së qytetëruar.

Në është që ca duan të marrin mprimin e odxhakësisë, aqë më tepër ne duhet të marim mprimin e vegjëlisë, se jo parësia është shtyll' e kombit, po vegjëlia. Ajo vegjëli që derdhet kur doherë më çdo rezik, kur parësia ri edhe vështron për së largu, ajo vegjëli që është përpjekur edhe sot përpiqet me nevojat e rënda, të cilat nevoja parësia nuk i ndjen, se, si ju thatë vetë, lépin këmbët e anadollakëve për ca ërgjënt. Ajo vegjëli që në kohë të Skënderbeut ish e lumtur, sot është shtypur e shtrydhur.

Në do odxhakësia të shpëtonjë popullin, pse ri, c'pret, pse u thotë atyre të marin armët, po s'i marrin ata vetë më parë, po si nginjen me pretime. E paratisin (1) popullin që u bashkua me ata me një trap që nuk di pastaj ngaha të dalë edhe mbushen burgjet.

Eshëtë detyra jonë të mos e lemë vegjelinë ndë thonjtë e mprehta të parësisë, po të kërkojmë t'i shërojmë plagët e gjakta, të dhemburit e të cilave e ndjen gjer në palcët.

Ne dëshërojmë që të bëhet një e drejtë për të tërë. C'nevojë për këtë parësië si është sot?

Parësi do të jetë ajo vetëm që e do populli, që e nxierr nga gjiri i tij.

E ju, or atdhetar, që jini mburur (2) ndë dritët e asaj France popullore, ku dini fort mirë si u bë e drejta e popullit, ku dini më sa paanësi gjykohen punërat, oh! ahene mos vimi re sa shkruajnë ca që duan të mprohen që të mos u priten thonjtë, po gjykonit punërat më së afërmë. Mentohuni sa pun' e shënjtëruar është kur përkrahi që të mpronit ata të dobëtit, ata që s'kanë fuqi të ngrihen më sipër, që të na rëfejnë të dhemburat e nevojat e tyre.

Shumë lark jemi qëllimit në mos i mendofshim të tëra këto.

Të ju mundësh të bënët një udhëtim në Shqipëri e të shëkonit. Ahene do të thoshnit se kemi të dreqtën.

Pra, ahene mundim të jemi të lumtur, kur ay qëllim është i mbaruar.

1) e paratisin (gr.) = braktisin.

2) mburur = jeni bërë burr, jeni rritur.

Me këto radhë nuk dua që të shkruan as kundër Z. Nuri Beut, as kundër Zotërisë s'uaj, por, kur pashë ato fialët e sipërme, shumë më trazuan. Se sot s'është dita e sharies edh' e çaries, për të cilat na qeshin armiqtë, të cilët ndalojnë edhe bashkimin; e ca më tepër sot, më vënt të bashkohemi, duke pënuar dorë për dore, sëcili sa munt e sa di me dashuri e pa cmir për të mirën e kombit.

Nukë dua të flas as kundër ca bejlerëve të vërtetë atdheutarë, të cilët janë fort të pakta, që s'u ndjehet gjishti fare, po sillen mire me të térë si të vërtetë oxhakë që janë.

Mbaronj, duke ju lutur të mos zemërohi po të thomi të vërtetën, gjithënjë të vërtetën.

Më 6 të Marsit 1902.

PARËSIA E SHQIPËRISË

(1912)

Parësia na duket se të gjithë veprimet e lëvizjet kombëtare të popullit i sheh si ca gjëra të paqëna, i sheh me një sy të shtrëmbër, si lodra foshnjarake, me nj'anë sikur duke dashur të rëfëhet se është edhe me atë, po më tjetër anë të mos e lerë edhe atë q'e ka në dorë.

Parësia është ajo që gjer më sot i ka mbajtur punërat më vënt, pa mos dashur të vërë këmbën ku lypset ta vërë, të vejë pas një ideali të vërtetë, pas një rruge së drejtë e atdhetarije me themel e të ngrihet atje ku lavdia është e pa sosur, e jo të kalbet më atë pellg ku hidhen tërë qelbësirat e botës. S'duan të marrin atë erën të kjarë që i shëron, që i ngjall, por, në atë pellg po e heqin për këmbe dhe popullin, duk' e bërë piedestal, ballë e funt, që të rinë ata përsipër, të duken përpara botës se diç janë, pa kupëtar si bota me një qeshje ironike tallet me ta si njerës pa pikë vetëdije, për vetveten e tyre.

Na thonë se ata punojnë me mënt e me rregull, kur shohin se nga kjo punë e nga ky veprim i tyre ka harirë Shqipëria në këtë shtet për tu qarë.

Cilat janë mirësitë që i suall Shqipërisë gjer më sot? Cilat janë ndryshimet që pat vendi? Cilat janë përparimet e popullit? Ato që i shohim sot të pakta te mentaliteti i ndjenjave të shqiptarit, i ka se i bëri vetë, i fitoi me djersët e veta. Parësia as është lëvizur, parësia s'ka nxjerë asnje zë.

Parësia e solli vendin tonë në këtë ditë si s'ka më keq. Nga moskujdesi, nga të mos ndjehur se ç'detyrë kanë përpëra popullit që i nderon, po përveç të fryrë me fryshtë pér një madhështi vjetiake edhe fanatismi, dashurie pér çdo të huaj, s'e kujtojnë fare vëntlermin e tyre, po, që atje lart ku ndodhen, e çallmuani më keq. Shqipëria pér ditë që shkon, më vënt të shohë një ças lumërije, sheh një jetë e rrojtje mjerësije e fatkeqësje. Populli ka marë botën duk' u përhapur më të katër anët e dheut, qytetet e katundet po zbrazen pér ditë. U mbush Misiri, u mbush Greqija, u mbush Rumanija, ku s'gjen fshat pa mos gjetur shqipëtarë të vendosur, që të mos kujtojmë Serbi, Bullgari e të tjera. E tani më në funt përtetj Atllantikut, në Amerikë po derdhen vala emigrante shqipëtarë pa numur. Nuk dimë nga tërë këta në u këtheftshin prapë 25 pér qint, po ç'thom, 10 pér qint.

Të gjitha këto ngjasin se parësia shqipëtare u përkujdes edhe po përkujdeset ta lumërojë Shqipërinë!

E lumëroj, se shqipëtarët iknë edhe u a zunë vendin muhaxhirët e të tjerë, e lumëroj se kur populli thëret, ata u bijen nér këmbë armiqëve pér kush' e di se ç'dëshirë; e lumëroj se të huajt pothuaj janë gati ta përcajnë e ta përfshijnë. Këto janë vepra kombëtare t'atyre që duan të thonë se janë oxhake. Por, mjerisht oxhake të vërtetë më s'ka, se i shoiji s'di se kush, posa tha tjetër herë një shqipëtar i njohur ka disa vjet; e nuk di në janë sa gishtinjtë të një dore.

Disa prej parësisë e hedhin fjalën, duke thënë se çështja shqipe s'ka rënë në duar mjafit serioze, se ata që punojnë janë njerës të içit! Por, u pyesim Zotërinj prej çdo feje a besim qofshi: pse s'iu përveshëtë punës e ta merni ju në dorë, kush ju mbajti? Pse nuk' u-dëgjua një herë zëri të buçasë përtetj rretheve tuaj?

Pse të rini me duartë e këmbët kryq? pse zemrën ta kini të gurtë? Popullin e kini si dyllen, përdornie duk'i dhënë formën e fundit.

Fusha është mjafit e gjërë, urdhëroni e merni anë në lërimin e saj, shkalla është e lartë, urdhëroni e ngjituni ku dëshëroni! bënie detyrën si atdhetarë, edhe populli i tërë ka t'u vijë pas; mernie flamurin në dorë, valonie nér viset e Shqipërisë dhe s'imbetet asnjë pa të mos u vijë ku të doni!

Se kjo therori u mungon, u duk çiltas. Se s'kini të drejtë të na i mohoni këto që thomi, provë kemi të vjetmet. (1) Parësia kur pa popullin të thëresë, ajo s'u përgjigj ndjenjavet e dëshiravet të tija. Munt të na objektojnë disa se parësia ishte me mish

1) Është fjala pér kryengritjen e malsorve të Veriut më 1911.

e me shpirt me 'të. Por as kjo s'është me themel, se në mos e hapnë gjirin përpara plumbit, nuk hapnë kuletën që të dërgojnë plumbin në gji t'armikut.

Kjo na dëften kthjellt e plotësisht se parësia e sqoçme e Shqipërisë u bastardua, u përzje me fise të huaj, dhe ajo parësi që duket se po është, është një parësi e harrirë, parësi e bërë vetëm për interesa të veta, që sipër të marë e që poshtë të rjepë; se, po të kish një parësi me ndjenja të vërtetë, do të kishte dalë, do mfshehta; se po është që bëhet një ndryshim ndë Shqipëri të hidhen këtej, e po të mos bëhet, mirë jemi se ku jemi.

Mos harrojmë vërtet se nga parësia të pakë jan' ata që ushqehen me ndjenja të vërtetë, e të cilët populli i njeh. Fort mirë, po trimi i mirë me shokë shumë.

Mjaft pra Zotërinj me të këtilla sjellje, mjaft me shpinën ujnjur përpara armikut; mjaft me fjalë të erës, se i dolli kallaji fare! Mentohuni se ini shqipëtarë; mentohuni se përpara e 500 vjetsh nuk' ishit siç jini sot; gjykon se janë djersa e lote që pikojnë duk' i mallëkuar ata që i thëthijnë gjakun, dhe që i a rrëmojnë varin popullit!

Këtu është trimëria e artë! ja se përveshuni e punoni me mish e me shpirt për të mirën e përgjithshme, ashtu sikundër na beson bota se jemi duk' i merituar ato lëvdata që u a sjell stërgjushëve tamë, ja se, në mos po mbushnie kupën me helm dhe zireni Shqipërinë për fytì, duk' ja hapur gojën e shtijani helmin ta pijë, e të vejë atje ku fati i saj ja ka dhënë të vejë për jeten e jetës!!

21 prill 1912

ËNDËR E VËRTETË

Shumë herë mejtohesha: Vjete shumë shkuan qëkur e kam lënë Shqipërinë. Isha djal' i vogël kur ika. Po ashtu si isha, sikur kupëtonja sikur ndjenja gjëkafshë të mfshehtë, që herë më gjëzonte, herë më trishtonte pa masë. Djalë mali e fushe. Natyra ish m'e para punë që më dëfrente zemrën, që më kënaqte sytë, që më hirështonte shpirtin, prandaj një të madh trishtim ndjeva kur e lashë.

Ndë dhet të huaj i vajtur, domosdo u mësuash me zakonet e vendit, të cilët pik së pari më dukeshin shumë të çuditëshmë. Jeta e qytetit, e shkollës pa dyshim të ndryshon, të hollon, të

këmben; atje njeriu siç sheh ashtu bën; zë tjatër udhë, udhë që një të huaji mund t'i sjellë shumë të mira, po edhe shumë të liga.

Vjetet rithnin pa reshtur, koha shkonte, ajo kohë që i këm-
ben të gjitha, që i haron të gjitha, që i ndryshon të gjitha. Po me
tërë këto një dëshir'e brëndëshme e zemrës më shtynte, më çpon-
te që t'i shoh edhe një herë ata vise, të shoh vendin e prindërvë
të mij q'e kisha lënë me aqë mallengjim, me aqë lote; të shoh
baltën e Shqipërisë, si thotë vjershëtori, nga e cila jam krijuar.

Mendja s'më rinte më një vënt; më dukej sikur nukë munt
ta bënj këtë çap të rëndë, që të largohem nga ky vend ku ndo-
hem, ku u bëshë burrë, ku u rita, ku u madhova edhe pashë
të parën shkëndijë dashuri. Më dukej sikur gjëkafshë më pen-
gon, më ndalon që të mos largohem. Po kujtimet e vogëlisë, ata
kujtime të ëmbëlë, që më gjëzonin kurdoherë, ata kujtime të jet-
tës së pametë, të kthjellë, të kulluar porsi qelli i Shqipërisë ndë
qershori, më bënин, më shtynin që ti shoh, ti përmënd, ti kujtoj
edhe një herë.

Një mshehje e pakuptueshme më çfaqej ndë zemër. Trupi
më çelej; më gjëzohej, më kënaqeje kur kujtonja se do të munt të
mbush këtë dëshirë të zjartë të zemrës sime.

Thashë me vehte: Të kapërxenj male, fush' e det, të vete
atje, t'i shoh të gjitha: gurët, drurët, barrat, brigjet, kodrat, t'i
ngjit e t'i zgres malet, të pi ujët e kulluar të mburimeve, të kqy-
ronj fshatrat pér rrëth, punëtorët, bagtitë, lulet, pemët; t'i zë me
dorën time, t'i ndjenj, t'i përgëzonj, t'i përqafonj, të nginjem, të
ngopem, të nxjer mallin e zemrës.

Po herë-herë mëndja më këthehej, zëmra më trishtohej, më
rënkonte. Jo, këto janë èndëra të miturisë, të vogëlisë, të fosh-
njërisë; janë èndëra të shkuara. Tashi jam i madh, ato shkuani
e vanë, fluturuan, u-shuan. Tashi duhet të përpinqesh, të mun-
dochesh, të mblethç pér rojtje, pér ushqim, pér bukën e përditë-
shme. Jam burrë, tjatër kohë, tjatër zakon, tjatër jetë. Ato ishin
èndëra foshnje, që s'di ç'është bota, ç'është mundimi pér rojtje.

Ja një burg pa mure që më pengonte lirinë, ja një gjë që më
mbante më vënt, ja hekura të rënda që nuk' më linin të lëvizem,
të mos munt të shijonj edhe një herë ëmbëlsirat t'atyre kujti-
meve që më dëshpëronin zëmrën, që më helmonin shpirtin, që
më dobëtonin trupin, kur kujtonja se s'i arrinja dot.

Isha ndë një dilemë: a më mirë midis dy gjërash, të cilat një
të heq e një të shtyn. Ç'thashë: jam njeri e ronj. Sa të jem ndë
jetë, dua që t'i jap kësaj jete ëmbëlsirën që i duhet; të jem i kë-
naqur. Të tjerat janë të rrena. Pra duhet të mbush dëshirën që
ma do shpirti edhe zemra.

Thashë edhe béra. Mendimet e mijë u vërtetuan, se sa kaq u ndothçë ndë kufi të Shqipërisë, ndë kufi të dëshirave të mia, që më rihi zëmrën dit' pér ditë, orë pér orë, minutë pér minutë.

Ju malet e lartë me majat e mprehta,
Pyllet e dëndura me vise të mëshehta,
Ju mburimet edhe lumenjt e kulluar,
që ujiti posht' e lart vëndin e uruar.
Ju balt e bekuar, vend' i trimërisë,
Atdheu i shtrënjtë, dheu i Shqipërisë,
Ju dhe Tomori mal' i shenjtëruar.
E gjithë si ç'e lashë e gjenj të pa ndryshuar.
Me mall ika, me mall vinj përsëri,
Ndjehem i lumtur, edhe munt të vdes tashi.

Vura dorën më ballët, qëndrova më vënt. Pashë rrrotull, u tunda, u shkunda, mos ndodhesha në ndonjë èndër, mos ishte nonjë çudi, mos ishte nonjë mrekulli që më gënjen sytë! Tërë këto i gjykova, i mejtova, i kullova, i çkullova. Po me të vërtet shoh se këtu ku ndodhem èshtë dheu im, èshtë Shqipëria. Marr udhën e gjërë, zgres malet, marr fushën. Era më dukej e èmbël, e shijëshme, e pëlqyer. Lulet rrrotull lëshonin një erë të ballsamtë, që të shëron, të çel, të çmall. Vesa, që kish rënë mi bart, shkëlqente si ca gurë të kushtueshëm; rezet e djellit, posa kishin dalë, porsi ca shigjeta ari të derdhura begatie, më përgëzonin, më përkëdhelin; mburimet, duke riedhur më ushëtinin ndë veshët, më gudulisinin, më dëfrenin; rëkeja, që përhapej fushës porsi gjarpër e çkëlqente si ergjënt ashtu e derdhurë midis gjelbësiravet, më kënaqte e më merte sytë gjer së largu; natyra më ngrinte, më lartësonë, më dukej se fluturonj përpjetë, më dukej se ndodhesha me të vërtetë ndë èndërat që dëshëronja, e ndjehem i lumtur, i kënaqur, i gjëzuar; edhe një shfrim i dalë nga fund'i zemrës më lehtëson nga rëndësira që më rëndonte trupin aqë kohë; sikur bëhem m'ri, sikur çelem, sikur freskohem.

Ja Shqipëria, thashë, ja vendi ku shkova vogjelinë, që më dha jetë, që më dha drithë; ja viset që dëshëronja, q'isha djegur pér to! Ja zogjtë që këndojnë dhe shqiponjat si ven' e vijnë me sulm, ja liqenet me viset e bukurë, e me ujët e kulluar! Ja bagëtitë si kullosin, dhe punëtorët e gjëzuar si unjen e ngrihen duke punuar me djersë, ja pleqtë me leshrat e gjata e të thinjura, ja trimat me pushkën mbë krahi si ecijnë udhës me kryelartësi, me robat e bardha porsi dëborë, me atë shtat të plotë, që i ngjasin Herkulit, të fuqishmë, të fortë të bukur. Ja gratë puntore edhe zëmërmira, si rendin posht' e lart, si përkujdesen pér shtëpinë,

çupat tē turpëshme e tē bukura me shtat tē mermertë si t'Afroditës, tē bardha si shkumb' e detit, symbëdha, cipëholla, vetullëzeza, faqekuqe, si ecijnë me çap pëllumbi! Ja bariu i mbështeturë mbi krahët me fyellin ndë gojë, si i bie edhe çmallet duke kënduar; dashi me këmborën që buçet gjer së largu, dhentë tē urta me shqerat ndënë hije t'atij lisi tē gjërë, edhe dhitë si ngjiten nëpër shkëmbinj e drurë, që duken porsi Pan-i, perëndi i Dëshurisë!

Ja qyteti tashti me shtëpit' e dendura e tē larta, me kishët, me minaret, që duken ndë ethirt! ja fshati im me shtëpitë e bardha, me kopshte tē thurura, me luadhet, me vreshtat me pemët, ja lumi, përrenjtë, brigjet malet përtëj, ja bukuria e pasosurë!

Janë tē gjitha më vënt si ç'i lashë prap ashtu i shoh. Ja vendi ku losnja, ku këcenja, ku çgryhesha! Të gjitha sikur më flisin edh' un i përkëdhelnja me sy, sikur këndonin edhe i dëgjonja me etje, sikur qeshnin edhe un i përgjonja me dashuri.

Sa kujtime tē pa mbaruara s'më përshkonin nëpër mendje. Më dukej se jam prapë foshnjë me èndërat e pëlqyera, se jam i çvendosur ndë pamje tē pazakonëshme, e ndjenja vehten time tē lumurë se arriva atë q'e mejtonja q'e dëshëronja q'e èndëronja!

Pashë diellin si një dhisk i ckuqur si perëndonte, si mfshihej prapa malevet, majat e tē cilëvet tē ngjyruara edh' ato me një ngjyrë tē kuqe tē gjallë, porsi një vullkan që èshtë ndë zjar e flagë; pashë hënën porsi vashë bardhëlloshe me atë èmbëlsirë tē mfshetë q'e ka, si ndritë përmi rrëthet; yjet, kandile tē pashuara si xhixhillonin mbë quell, era e butë si frynte e kandëshme, nata si i mbuloj e pëlqyer me mfshetësinë e thellë, gjumi si i pushtonte që tē gjitha!!

.....
Po kur kështu, duke u mejtar u zgjova, edhe duke kqyrur për rrëth i habitshmë, shoh se ndodhem gjith'atje ku isha!!

1905

Letrën e mora dhe mora shënim përsa më shkruani. Nukë ka gjë, as ja dëftova letrën Zotni Durmishit.

Më shkruan se edhe atje ka djem që dëshërojnë për atë punë edh' unë fort mirë e di; do të vij kohë për së shpejti, që t'i venë edh' ata në rrëth të kësaj pune; nga shkurti kam shpresë t'ihem gjer aty dhe si të shohëmë do të bëjmë.

Sa për muslimanët, që më thua, i kemi në rrëth. Nga Labëria kemi një njeri, që ka shumë fuqi atje, që këtë verë ka për të dalë me nja 60 shpirt; ky njeri ka shumë fuqi dhe miq nd'ato vise që munt të mbanetë mirë.

Këta që do të dalin së këtejmi gjith nd'ato anë kanë për të vajturë. Kur do t'vij atje në Shkurt do t'i flasim gjer' e gjatë këto punë. Tani për tani i lemë, po sido të ngjasë prap të kam për të shkruarë.

«Dritën» mbesonj te kini marrë. Si e gjini? Sot nisa të shkruej numurin tjetër, i cili për së shpejti ka për të dalë. Z.ti Shahin dje iku për në Misir (Egjipt). Tani jam vetëm.

Kristo Luarasi gjindet në Bukuresht, ku e thiri një prift katolik nga Shkodra.

Të fala që të gjithëvet. P. Durmishit i dolli zemrimi. Në këtë numur do të hap edhe çështjen. Si thua ti. Në di gjë për këtë punë dhe për shkollën shqip të Korçës Shkruam.

të përqafoj me mall

TH. AVRAMI

BUKURESHT, 17 Nëndor 1904¹⁾

I nerueshmë edh' i dashtun Atdhatar,

E mora letrën tandem edh' u-gëzova tepër kur pashë se nj'atdhetar si ju vjen tuj na shkrue gjana qì rral noj tjetër ashtu me i shkrue.

Ate qì zotnia juej jini tuj diftu, janë t'vërteta e mos besoni se na këtu nuk njejm ate dhimë që kini edhe ju, por fati ashtu që venë me kadal punët. E para ashtu si më thoni dhe ju, se shum kërkijnë me punu, por kanë frigë; t'gjithë bërtasin e thonë ç'asht për me u-ba, e asnji nuk kuxon me qit krahnurin

1) Kjo letër është kopje e shkruar me dorë t'Asdrenit, por shumë shpejt, prandaj, aty ke s'është dalluar ndonjë fjalë, është lënë vendi bosh dhe janë venë pikë. Ka shumë gabime.

Gjithashtu nuk është shënuar emri i njeriut të cilit i drejtohet. Është shkruar gegërisht, sepse sic duket i drejtohet një gege.

përpara armikut. Asht edhe nji gjë e çudiçme, se ata qì kanë tas-kën plot nuk lëvizin fare, jan'tuj hangër e tuj pi, me shpnesë se Evropa ka me i dhanë Shqypnis qì lypet. Sa fjalë të rema! Un thom se kurrën e kurrës Evropa s'ka ba i sen në ven tonë, deri sa shqyptart nuk bajnë nji lëvizje komtare të përgjithëshme. Jo si sot, veg nér disa vise e vetëm kunér pagesavet e reformavet e pa nonji kuptim pér atdhen, por nji lëvizje me të vërtetë komtare, pér me i diftue bots se Shqypnia s'ka dek edhe asht e zoja pér me u sunue vetë, tuj nalue sillevt e grekt mos me shti kamen mrena tek s'asht veni i tyne, tuj thir Evropës, se jemi vetë të zot në ven ton e nuk e lem n'dor t'huj kurr. Por mjerisht deri më sot një lëvizje kështu s'asht ba e tash asht koha pér me kuptue njenitjetrin q'asht pér me u ba, pér me dal nga ky rezik i math.

Sa pér t'holla, e thomi se duhen. Kjo punë asht e vështir, por asht edhe e leht. Tani e me letër t'afërme kam pér me të shkrue pér mi këtë punë, si edhe të tjera çeshtje me ranësi t'madhe. Kët herë nuk munt t'u thom të gjitha, deri sa ju nuk më shkrue... aty në kioft se gjinen t'holla, vall se janë njerz... m'u mujt, e m'e zhdrivillum kët shtet të turpshëm t'tashme. Masi t'marr t'gjegjun, kam m'u përgjegj gjanë e gjatë, e u kam diftue mikun, qì asht vu pér me gjet t'holla e me t..... m'u pjek anej afér pas pak kohe.

Ky njeri asht nji atdhetar i flakt shtyptar edhe asht vu pér me e qit Shqypnin nga kët turp, por lypet edhe shokë të mirë e jo tradhtar. Pasanej ju lutem pér me shkrue në munet ju gjeni njerz qì dëshrojnë me punue ashtu siç thoni vet, pér me fitue lirimin.

Deri sot s'kam kuptue mir pér letrat të shtypuna ku janë shtyp, kush i ka shtyp e përsë nuk ka.... drejtimi më ishte pér me mleth të holla. Pranej atdhetart e këtushmë shum tuj u çuditë me mos ditë prej kujt ishin que ato thirie e s'parit na besuam se ishin que prej dikujt Sh. B. prej Londonit. Pra të lutem fort m'u gjegje pér mbi kët pun. Pér artikullin «Reformat e Turqëve» e kam pér m'e botue në gazet t'Sofjes.

Vëlla i dashtun,

Kto t'thom çiltas' se jam gzum fort, se që tash e tutje munim me këmye letra me zotnin tane e të dëshmoj se kah ana ime mos druni po pér qđo gjë qì asht pér t'mirën t'atdheut me na e kallë dhe qì kshtu të munëna m'u marrë vesh midis nesh edhe un kam me u shkrue gjithnjë gjith' q'asht me u ba këtej. Lutem me shkrue q'farë qoftë shqyp...

Tuj pritun t'gjegjun, ju shtërngoj të dy duart atdhetarisht me ner, vllai yt i padam.

ALEKS DRENOVA

Zotit Aleksit St. Drenova
ndë Bukuresht.
Atdhetar i çkëlqyer,

Të lumtë! Ja vjersha që ndrijnë si rezet e djellit¹⁾. Ja vjer-
shëtor i vërtetë! Nuk mund të them se çndjej në zemër kur mar-
e këndojoj këtë librë, shtypur sa s'bëhet më mirë dhe shkruarë
me mënt të lartë e me shpyrt thjeshtë shqipëtarë. Të tjerë, që di-
në dhe kupëtojnë mirë, le të të lëvdojnë si ç'duhetë. Faik beu
le të marrë pendën e ti q'e përdor kaqë bukur dhe le të lëvdojë
këto vjersha sa të mundjë, se këtë herë nuk besoj të dalë njeri
të thotë se «Albania» lëvdon gjëra që s'janë për të lëvduarë. . .
Jo! Jo! këto vjersha gjithë shqipëtarët do t'i duan dhe do t'i tho-
në gojë për gojë. Të mir' e të liq do t'i lutenë Zotit t'i japë shén-
det e jetë atij shqipëtarit mbasë që di e na kënaq duke shkruarë
me një gjuhë që na vete mu ndë zemër dhe na bën të qeshim a të
qajmë si foshnje. Shqipëria do të japë ndjesë dhe uratë ati të bi-
rit saj që di e thotë këto fjalë.

O zana të perëndishme,
që këndoni trimërinë
dhe lumtësin e njerëzis',
Shqipërisë së tanishme
jipni edhe asaj dritë,
të shojë rezet e liris²⁾)

Tani besoj se Naim beu nukë vdiq. . . se vendi që la ai bosh
e zure ti. Ndaj dua të imbaroj këtë letër si e nisa:

Të lumtë! Të lumtë! Të lumtë! duke shtrënguar dorën si mik
dhe si vëlla.

A. ÇAKO

Të lutem dërgomë dhe 5 copë të tjera dorë më dorë dhe të
hollat do t'i miri me postë. Do të përpinqem me sa mund të përhap-
këtë librë, po mjerisht shqipëtarët duan t'i marrënë pa paguarë.
«Baba Tomorri» më kushtoi 18 lira dhe mora vetëm 25 franga!
Kam shpresë të kesh fat më të mirë.

1) Libri i parë i Asdrenit «REZE DJELLI».

2) Vargje t'Asdrenit.

Fort i dashtuni e i shtrenjti välla Atëdhetar!

Mora kartën e dashtun t'2/I; të falem me gjithë zemër. Sa për kanune mos t'kish frigë asnji grimë, se unë po i shkruej sot kryeparisë qì të çojmë nja 50 copë e ma qì t'i kesh atje. Kët letër po ta shkruej kah ana e eme, se kjo asht e para qì po çkëmbej vëcmas me ty; masi der njitash t'kam shkrue kah ana e Shoqnisë.

Nuk e di as un or välla se ç'do me thanë kjo punë! Tuj këndue vjershat e dashtuna tuejat, gxohem kaq, sa as un nuk di t'rëfej e dashtunija e tyne, qì hine në çfardo xemret shqiptarit, m'djeg xemren edhe ma fort e shpesh dishroshe m'u gjetë natën kur natyra t'gjith ka ra me fjetë, atje n'Bukuresht e me t'gjetë ty përparrë dritës kandilit e aty me ta puthë at dor aq t'dashtun, kushtuemun gjuhës amtare e atedheut. Kështu edhe mue xemra e eme m'digjet flakë dhe durimi m'shtohet ma shumë për me shkrue pa pushue për gjuhën t'onë të vorfun; kaq sa n'kohë të msimit, kur mësuesi asht tuj na msue e t'gjith djemt janë tuj vrejtë fjalën e tij, un jam tuj vjershue me mendime te tretuna herë te ata male, fusha e pylla t'blera t'atdheut, e herë te ato luma, proje e liqej t'argjenta, a tuj kujtue mjerimin e vorfninë e atedheut... Për vjershën tande e cila m'u pëlqye aq shumë, qita nji rame (mekame-turq. melodie) shumë të mallshme e masi un nuk jam hartues (komponist), e lashë pak prej nji profesorit m'e ndreqë. Po pate dishir qì t'i dërgoj notat për vjershën e dashtun tandem «Gjendja e jonë», më shkruani....

Vjershën tande po ja dërgoj vllaut tonë Nikolla B. Ivanajt. A e mer kush atje n'Bukuresht fletën e tij «Shpnesa e Shqypnis»? Vjershat e artikujt qì janë të nënshkrojtur «Lirijasi» janë të mijat; n'vend qì te «Albania» përdoroj emnin «Zog Dushmani». Emnin «Sakoli» e përdoroj nér punë të shoqnis, n'kujtim t'pseudonimit t'parshëm «Zog Sakoli» t'cili emën, sot dy vjet, kur ishe n'Shkodër, m'shterngoj ata i im m'e ndrue, pse policija m'kishte në sy e nji pulis m'u vete gjithmon mrapa. Kjo letër asht për ty. Tjetren po ta shkruej ka ana e shoqnis.

Po t'qafoj e po t'puthi me mall, un i dashtuni vlla i yt.

Hil Mosi.

MANASTIR dt 7 NËNDOR 1908

I DASHTUNI ATDHETAR¹⁾. Sot gjindem ketu si dërgimtar i Shoq. Gegëni ja në Shkodër; mbas kuvendit nisem në Korçë si mësonjës.

Të puth me mall
Hil Mosi

Të fala Shumë:
Mihal Grameno
Sotir Peçi
Çerciz Topulli
Bajo Topulli
Thoma Avrami

(Në një skaj të kësaj postaleje ka një shënim ku dallohet vetëm kaq «Me shumë mall të shkruej se jam me gjithë atdhetarët në mbledhje të Kongresit. Edhe shumë na erdhë keq se nuku të kemi në mes tonë. Po të kënduan këngën tënde *Ardhi koha* .»)

KAIRO me 12-5-1908

I vërtetë atdhetar.
Kohë ka shkuar që kur pushuam letër çkëmbimin në mes tonë dhe mbesonj të më kesh harruar në këtë kohë. Them mbesonj se çpalë «Rezet e Djellit» dhe as e kujtovë fare të mjerin Milo, që digjet për të kënduar çdo që të jetë shqip, jo pastaj vjersha si të tuat, po prap Zoti më ndihu edhe i këndova. . . jansë të bukura, shumë të bukura. Sa për vjershën e Dhespotit, është një kryepunë. Puno or vëlla pa prerë, puno pa u lodhur, puno për atëdhe, puno pa frikë, puno për lulëzimin e letërsisë tonë, puno! puno! Puno! E di që do humbësh kohë dhe të holla, e di që jo vetëm do mos kesh shpërbirim, por mund edhe të të shajnjë, po çë me këtë? Puno ti! dhe një ditë poshtërim (postérité) do të t'ë çpérblejnë n'Istori.

Po të dërgoj grishnin e një drame të re «Gjahu» dhe jam më tepër se sigur që do mundoresh përmua dhe do më ndihësh pranë miqve atjeshmë me sa të mundet. Gjatëjetime që tanë.

1) Kartë postale dërguar Asdrenit nga delegatët e Kongresit të Manastirit, ku u vendos alfabeti që përdorim sot.

Ç'po bëni ju atje? Si vete qarku dhe pse s'dëgjohet? Zotë-
rinjtë Dako dhe të tjerë?
Me mijë të fala Zotit Naço...
Të puth vëllazërisht dhe jes vëllai jyt.

MILO DUÇI

I NDERSHMI ZOTENI ASDREN

II 2450

NË BUKURESHT

Zotëni nukë mundni të ëndëroni fatbardhësinë që ndjenj tanë këtë orë, kur kam marrë unzën në dorë për t'i u drejtuar letrë njëj shqipëtari të dëgjuar, njëj atdhetari të flaktë, njëj shkrimtari të vlerëshëm, më në funt, një vjershëtari të çquar.

Veprat t'ueja, zotëni, kanë zgjeruar dhe zbukuruar tepër literaturën shqipe. «Endra e lote» e leçitur prej nji shqiptari i fundit, mbesohet vërtet si në ëndër dhe, duke u squar, me t'u parë i lirë, lëshon lote gazmore... dhe aq që mbaron së lëçituri «Reze djelli», ndodhet i çkathjtë dhe i ndritur n'ato.

Sa për veprat e tjera mbesonj të kenë gjith'atë vlerë; pranaj u lutem tepër Zotëni të më shkruani ç'kini shtypur prej ato dhe, duke patur marrë përgjigjen të dashur, mbesonj, qe t'ju bënji një të vogël komandë nga një copë të cilësdo libër t'uaj.

Gjith me këtë rast vij t'u lutem zotëni, ku mund të gjej, me anë të ca spjegimeve t'uaja, veprat të së çquarës shkrimtare Elena Gjilka (Dora d'Istria) dhe më tepër atë librë të asaj, që na përket ne shqiptarëvet «Albanesi in Rumania». Më ndjeni Zotëni që kuxoj t'u kërkonj një shërbim të këtillë, po duke ditur që përveç juve, asnjë tjetër shqiptar nuku munt të ketë leçitur veprat të njerëzve të çquar dhe të dijë më mirë mburimin t'atyneve.

Duke shpresuar se do kem një përgjigje të sigurt.

Mbetem Zotëni me më të fellat nderime shqiptari.

TOSKA

Ploeshti
21.V.1921

Besa Harbut

Lark, lark, rrugën hapni shqiptar
Se bëri s'qen e jan kalem
Ja tek diktet drejt-për-drejt
Pas me tisma t' arsim tuar.

Shik ftyura si-i shkollzën
Qytet i njëjnd edh' ar i u veshin
Shik se n'fryhet, n'difbas
Sikur është me kushtë, n'qejtuar
K' t'arrizj bej, e-hix
Të paragjimë i-trotne shumë
Sa t' qëndri kot pël bëme
Si përkthoj si pëlumb e hix
Qytet, besoni qërtit fisi mik
A bir mbarreti në fuge,
E do të marrë mos e ka marrë
Pët t' u përoftat vegjeli.
A se s' është aspak Harbut
Dhe n' është, "Besa e Madhe";
Kurra natën del kajdut
Çresh sa shkopu rrugës madhe?
Shkonë lark, re qëllë rra kësia
T' vënëben nga Vaspërije,
Vatës i mbet uji tot ka s'ra
Brofshi pra Fisnikeria!

Siguroj

Kat breth fjala që jetonte
Pun, ditarë mëndje-lelë,
Se ky Vëndi jep i qelte
Paresi ka qakabare
Gjë që s' është i must tojet

Si u biven dke dëshmorë
Chant t'ujqasë Leri, Leri,
Faj zëfallet, faj pa vlerë
Le kjo batë s'ka shënuarë
Kanë bëre dke t'fjëri!

Ishati jysrë, Ishati imbarë
është my shembull drejtësije
q'do që bën, s'e bën pa shijë
Ishkon shkëtet - s'ka t'ujqare
Në s'dhe punë qeveritje!

U-tant deti, briti loka.
Shqipëria Republikë!
Pun's buktur, them pa frille
bez Zyrtarët që uga Vokë:
Silitë Shqip as grammatikë!

1925

Fr. Dr. V.

Thaisa

Aysk rot edde n̄ kokerat e laadt
Spesk etja udjej par n̄j̄i bukurije
Gor merrim udjeyat flagi n̄merr kastta
Ues n̄i sef cas t̄ shkader lumi teipe.

Wallaiga Thais trap e me, vert hysjet
Kinis i Attines miret, ja kaste prisbu
She fellorofet hleg e plakett hysjet
S' ugapetum jith prane dat prisbu

I hadha leka, jat i opthe kate
Seshire past hay t̄ a kichta n̄ vete
Per dashurin i tij udaj mordje kate
S' uabey dake humbur dit e neta

Ner kupa t̄ arta vera ritte luan
Abi ilketrat n̄i t̄ betneyta n̄j̄i soipe
Te peggafar bijun spesk n̄ gume

Perk e valuar masei s'alo lirige

Ner kithetrat e pat kapin n̄ fegredé

S'olo cas n̄i t̄i, punktua goja-gaja

I liffet etkar t̄ a kate mibretarak
Ja koha yar t̄ fare persepojej

PASQYRË BIBLIOGRAFIKE E POEZIVE T'ASDRENIT
TË BOTUARA E TË PABOTUARA

I. REZE DIELLI

Bukuresht 1904

*Titulli i poezeve të këtij
vëllimi*

*Organet ku poezitë gjinden edhe të
botuara veçan*

Këngë lirije	
Flamuri kombëtar	Albania Nr. 11. Janar 1902 f. 64
»	» 28.XI.1919
Ardhi dita	» Nr. 11. 15.XI.1901 f. 172
Bota	
Këshillë	
Palla e Skënderbeut	» 25.VIII.1901 f. 119.
Besë dhe shpresë	» Fror 1902 f. 34
Dyshimi	
Dua	
Poshtë errësira	» 10. 15.X.1901 f. 149
Dëshirë	» 9 Tetor 1902 f. 214
Zëri i flamurit	
Tingëllim ✓	
Malli i Atdheut	Kalendarji kombiar 1903 f. 113
Mjajt	
Atje	
Shqipëtar i vërtetë	
Grekomanët	
Girolamo De Rades	
Detetar	«Demokratia» 1922 Nr. 120 f. 3
Nata e mbrame e Skënderbeut	«Albania» Mars 1903 Nr. 3 f. 40
Mallkimi	» Nr. 5. 31.V.1901 f. 74
»	» 2 Fror 1903.
Të fala	
Larg vatrës	
Thirrje zgjimi	
Pyetje dhe përgjigje	
Detyrë kini	
Ali Pash Tepeleña	
Lutje dhe mallkim	» Nr. 5. Qershori 1902 f. 147
Dhembkë	
Punoni pa prerë	» Nr. 10 Nëendor 1902 f. 231
Vajtim	

Për Shqipérinë
Shqipëtarëvet
Naim be Frashëri
Kasolles
Për Atdheun
Frori
Puntori i mirë
Ardhja e pranverës
Natyra
Pranvera
Shiu
Mbrananet ndër fusha
Flutura
Shelgjet
Bariu
Dimri

«Albania» 2 Fror 1903 f. 17

Mendimtare

Një ëndër
Mentime
Perëndia
Puna
Qetësia e zemrës
I burgosuri
Dheu i huaj
Lumturia
Përfytyrime
Vërtëtësia e gjërave
Feja e vërtetë

Dashurie

Dashuria
Një orë lumtësie
Malli i Lekes ✓
Dinakëri
Malli i Peshkatares
Pranë teje
Fuqija e dashurisë
Bëj një të mirë
Një zakon ✓
Harimi
S'ke ti faj
I vështirë është durimi

Së bukurës
 Kthime
 Mëshirë
 Djalëria
 Tingëllim
 Një dëshërim
 Shpirti i dhespotit
 Lop' e fshatarakut
 Gënjesht' e Nastradinit
 Krishti grek
 Rreth mesalles
 Trimësia e shqahut
 Lufta turko-greke
 Një këshillë
 Jeta e mirë
 Dumbëvica

II ENDRA DHE LOTE

Bukuresht 1912

Zonjës Edith Durham
 Dimrit
 Lutja e të humburvet
 Shqipërisë
 Pesëqind vjet
 Betimi mbi flamurin
 (hymn)

- «Kalendar kombiar» 1906 f. 54
- «Albania» Nr. 5. 1904 Prill f. 93
- 1) «Liri e Shqipërisë» Nr. 39. 21.IV.192 f. 3
- 2) «Përlindja e Shqipërisë» 15.XI.1913
- 3) «Dielli» 28.XI.1918
- 4) «Albania» 28.XI.1918
- 5) «Shqipëria e re» 1922. Nr. 107 f. 1
- 6) Zëri i Korçës» 1925 Nr. 39 f. 1
- 7) «Bisedimet» 1925 Nr. 42 f. 2
- 9) «Zëri i Korçës» 1926 Nr. 142 f. 1
- 9) «Bota» 1936 Nr. 19 f. 1
- 10) «Bota» 1937 Nr. 43. 43 f. 1
- 11) «Tomorri» 1942 Nr. 255 f. 3

Në mërgim

Gjendja e jonë	«Shpresa e Shqipërisë» V.III. Nr. 3. 1.II.1907 f. 2
Krerëve tradhëtarë ✓	«Shqipëria e re» 447. 28.XII.1930 » 503 23.VI.1932
Besa e jonë	«Liria e Shqipërisë» Nr. 14. 15.VII. 1911 f. 4
Vlesa e Atdheut	«Liri e Shqipërisë» Nr. 14-15 VII 1911
Prralla e plakut	1) «Kuvendi» 30.XI.1911
Lulja e vetëm	2) «Kuvendi» 30.XI.1919 Nr.40. f. 5
Mallëngjimi	3) «Shqipëria e re» Nr. 15; 28.XI.1932
Balashit	«Albania» 1904 Nr. 11 f. 201
Varri i haruar	«Kalendari kombiar» 105 f. 61
Lulëkuqja ✓	(E përkohëshme) «Lahuta e Malisë» Nr. 3. 1910 f. 15
Lutje e zanës	«Nazione albanese» Nr. 17, 15.9.1912
Shqiponja me dy krerë	1) «Liri e Sqpërisë» Nr. 47, 26.IV. 1912
Përpara	2) «Drita» Nr. 307, 1937 f. 19
Varri i Skënderbeut	3) «Drita» Nr. 613, 1938 f. 6
Bariu i parë ✓	1) «Nazionale Albanese» Nr. 21, 15.XI.1912
Nënës Shqipëri (gr)	2) «Shqipëria e re» Nr. 20, 29.I.1933
Cperblim ✓	3) «Gazeta Shqiptare» Nr. 8, III. 1933
Zani i Lahutës	4) «Vatra Shqiptare» 18-19 1942 f. 8
Tingëllime	
Të falura	
Koshtuta në Shqipëri	
Sami Pejanit	
Armët e Skenderbeut	
Zani i kryengritësve	
Kënga e bashkimit	
Krujës	
Kosovës	
Cilët jemi	
Dëshmorëve të kombit	

Natyra

Të korrat
 Perëndimi i diellit në verë
 Këndona bilbil
 Vjeshta
 Shpezët udhëtarë
 Ndë kishe
 Ditë prenverë
 Pamje vjeshte
 Shtëpija ime
 Eja prenverë
 Të puthurit e një nënë
 Ardhja e dimrit
 Lëndina
 Ditë prilli
 Ditë Maji

«Albania» Nr. 4, 1905 f. 74

✓
 «Liria» V.II. Nr. 60, 24.X.1909 f. 3

Mendime

Mendime qetësije
 Gjyqi i dytë
 Ylli i zjarrtë
 Mall i vonuar
 Mall nate ✓
 Thëllënza
 Lumtunija e shpirtit
 Tingëllime
 Këndoja
 Njeriu
 Gjykime
 Një zogut
 Caste hidhërimi
 Tingëllim
 Dëshira e ime
 Malli i nënës
 Lutja e çunavet
 Dita e vitit shkollor
 Ngjatjetimi i nxënësve
 E veja
 Druni i jetës

«Shqipëria e re» Nr. 417, 20.4.1930

Bukurija

E bukur e dheut	✓
Dashuro	
Malli im	
Te zanë janë zgjue	«Albania» Nr. 12 — 1904 f. 229
Ndën dritare	
Bukuria ✓	«Afrimi» Nr. 23, 21.IV.1926 f. 4
Kujtimi i saj	
Trandafili ✓	
Thëllënza e Lekës ✓	
Fli më nge (Adoptim)	
Tingëllim ✓	
Prej katundit	
Koha e humbur ✓	
Syt' e saj	
Tingëllima	
Në krua ✓ ✓	
Gjum të lehtë	
O ti me syt' e zinj	

Të ndryshme

Krimbat e Shqipërisë	
Gomari mësuar	
Godiva	Përkhthim «Lirija» VIII — Nr. 53, 14.VII.1909 f. 4.
Të pi	
Ngjyrat	
Epigonet ✓	
Vera	
Për gjah	
Me hapa plot	
Deshë të kem	

III PSALLME MURGU, Bukuresht, 1930

Vjershavë të mijë
Gjuha shqipe
Hymen kombëtar

1) «Shqipëria e re» N. 397. 28.XI.1929
» » Nr. 501. 26.V.1932

Mall vëllazërije	» »	Nr. 373. 9.VI.1929
»	» »	22.I.1933
»	«Kalendari kombiar»	1914 f. 106
»	«Gazeta Kosova»	Nr. 2 1932 f. 3
Adriatikut	«Shqypnia e re»	25.XII.1913
Maleve tanë	1) «Gazeta Kosova»	Nr. 7. dt.
	17.VII.1932	
	2) «Gazeta Shqiptare»	27.VII.1932
Flamur ti të rrrosh	«Leka»	1931 f. 352
Letër prej katundit tem	«Shqipëri e re»	507 — 6.VIII.1932
»	«Djalëria»	Nr. 4 — shkurt 1928 f. 3
Durrësi	«Djalëria»	Nr. 13 V. 1931
»	«Kuvëndi»	Nr. 76 1920 f. 4
Fjala e Dodonës	«Ylli i mëngjezit»	Prill 1920 f. 320
Apollonia	«Gazeta e re»	Nr. 24, 28.XI.1928
Hymni i festës ✓	«Shqiprija e re»	Nr. 485 26.X.1931
Vlorës	» »	V. XI. Nr. 397 1929
Marsh i djalërisë shqiptare	» »	394, 3.XI.1929
Të rijve	» »	505, 20. VII. 1932
»	» »	409, 23. II. 1930
	«Liri e Shqipërisë»	21.V.1914
Burri i dheut	1) «Liri e Shqipërisë»	426, 1.VII.1930
Luftari lypes ✓	2) Shqipëria e re»	497, 27.IV.1932
»	3) » »	226, 1.VII.1930
Vdekja Byronit		
Phyrus e Cineas		

Vallja e jetës

Ora e zemrës		
Excelsios		
Hyji i harruar	«Gazeta e re»	1928 — Nr. 33 f. 3
Afroditë ✓	«Shqipëria e re»	Nr. 338 — 9.9.1938
Fjalë n'erë	«Illyria»	28.XI.1935 Nr. 32 — f. 5
Mëma		
Lulja e zemrës		
Lutje		
Ballada e bariut ✓		
Lutja e vonuar		
Hija e keqe	«Shqiprija e re»	504 1.VII.1932
Mos humbni shpresë	» »	29.VII.1923
Kotësia		
Këndomë çun		

Shih si endet bota
Mister
Pendim egoisti
Juda i ri ✓
Lulet e gjirit
Rrugëtarët
Kënga e udhëtarit
Mëkati i fshehur
Shega ✓
Baresha
Fytyrën tënde
Dëshirë pagane
Kujtime të shuara
Venediku
Pagjes
Serenata e Shubertit
Paradokse

» » Nr. 5 Mars 1928 f. 16

«Ylli i mëngjezit» Shtater 1920 f. 333

«Gazeta e re» Nr. 17 v. I 1928 f. 3

«Demokratia» Nr. 456 6.IV.1935

Ngjyra ylberi

Mirse na erdhe prenverë
Pamje
Ylberi ✓
Shinat
Qyqja
Vegim perëndimi ✓
Rozullimi
Shi po bije
Lulja e këputur
Fyelli
Një udhëtim
Andje verore
Vaje pylli ✓
Merzi vjeshte
Trandafili

«Shqipëri e re» 317 26.V.1929

Lule dhe gjemba

Shqipëria më 1914
U vra Thomsoni
»
Mendjeshkurtët
»

«Shqipëri e re» Nr.447 28.XI.1930

» » » 508 14.VIII.1932

» » » 375 23.VI.1929

» » » 506 28.VII.1932

» » » 413 23.III.1930

Hymn hënës	»	»	»	447 28.XI.1930
Nakari	»	»	»	347 14.X.1928
Dasmë				
Fytyre				
Pasqyra				
Nusja e mbarë				

Nga bota e prallave

Burim i të këqijave	«Shqipria e re» Nr. 447 28.XI.19730
Syt' e Argusit	
Fyelli i Minerves	
Narsiqi	
Dënim i Prometheut	

Poëzi të botuara vetëm në shtypin e kohës, që nuk përfshihen nëpër vëlli-mët e Asdrenit

- | | |
|---|------------------------------|
| 1) a) «Shqypnija e re», Shkodër V. II.
Nr. 48; 22.XII.1913 | «Hymni mbretëror |
| b) «Ushtimi i Krujës», Durrës 7 Mars
1914 | » » |
| c) «Zgjimi Shkurt 1914. Nr. 236 | » » |
| 2) Atdheu V. I. Nr. 12 f. 3 1913 | «Me kot Shqiptarë» |
| 3) a) Kalendar kombiar 1915 f. 106 | «Shqipëria u lirua» |
| b) «Zgjimi Shkurt 1914. 245 | » » |
| 4) «Ylli i mëngjezit» Boston Nr. 7
f. 199; 16/IV/1917 | «Skënderbeu Kastrioti» |
| 5) «Kuvendi» 30 Nandor, 1 918, f. 5. | «Varri i harruar» |
| 6) «Ora» Tiranë, V. II. Nr. 483-84,
28.XI.1931 | «Vojava» |
| 7) a) «Kosova» 28 maj 1933 | «Lote robërije» |
| b) «Tomori» Tiranë 1 Maj 1941,
Nr. 112, f. 31. | «Lote robërije» |
| c) «Vatra shqiptare» Nr. 18-19 —
1941, f. 11 | «Lote robërije» |
| 8) «Kuvendi kombëtar» Nr. 38, f. 5;
28/XI/1934 | «Pellazget» |
| 9) «Kuvendi kombëtar» Nr. 34, f. 3;
8/X/1934 | «Njeriu mbikrijese» |
| 10) Kuvendi kombëtar Nr. 2, f. 2
17/XII/1933 | «Ora e rilindjes» |
| 11) «Kuvendi kombëtar» Nr. 34, f. 8
8/X/1934 | «Lulja ngushullimi» |
| 12) «Drita» Tiranë V II, Nr. 434 f. 1.
30/IV/1938 | «Martohet mbreti» |
| 13) «Drita» Tiranë V II, Nr. 335 f. 2.
1/I/1938 | «Me shpresë gjithmonë të ra» |

- 14) «Përpjekja Shqiptare» V. II. Nr. 14-15
 f. 77, II-III. 1938.
 15) «Përpjekja Shqiptare» V. Nr. 14-15
 f. 105, 1938
 16) «Përpjekja Shqiptare» V. Nr. 16, f. 217
 Prill 1938
 17) «Përpjekja Shqiptare» V. Nr. 17 f. 253
 Maj 1938
 18) «Përpjekja Shqiptare» III 25-27 f. 1,
 janar-mars 1939
 19) «Donika» Tiranë V. I. Nr. 1 f. 9;
 20/III/1939
 20) «Skëndija» Tiranë V. I. Nr. 2 f. Gusht
 1940
 21) «Shkëndija» Tiranë I. Nr. 10 f. 26-27
 Prill 1941
 22) «Tomori» Tiranë V. II. Nr. 292 f. 4,
 28/XI/1941
 23) «Tomori» Tiranë V. III. Nr. 286 f. 3.
 28/XI/1942
- «Flamurit Arbehoi»
 «Turtullesha e malit»
 «Jeta s'është e kotme»
 «Bukurisë së pavdekëshme»
 «Viti i Ri».
 «Butrinti»
 «Koha e re»
 «Leka i madh. dhe ushtarët»
 «Shqipëria e madhe»
 «Hymn lavdije».

POEZI DORESHKRIM, TE PABOTUARA

- 1) Gjaku i Stërgjyshërve. (Arkivi Shtetit Nr. 221)
- 2) Trashëgimi (A. Sh. Nr. 215).
- 3) Eñdra e pijanikut (A. Sh. Nr. 226).
- 4) Haj të dalim në lëndinë (vargu i parë i një poeziye pa titull) (A. Sh. Nr. 249).
- 5) Jam një bohem (A. Sh. Nr. 252).
- 6) Kënga e mesatarit gjashtëdhjetëvjeçar (A. Sh. Nr. 240).
- 7) Kënga e institutit femror (A. Sh. Nr. 236).
- 8) Numosje jetëmërzituri (A. Sh. Nr. 258).
- 9) Republika Shqipëtare (1925) (A. Sh. Nr. 248).
- 10) Vëllazërija Frashëri (A. Sh. Nr. 234).
- 11) Drithma dashurije (A. Sh. Nr. 231).
- 12) Kënga e të riut 23 vjeçar (A. Sh. Nr. 237, 238, 239).
- 13) Vojsava dhe Gjergji (A. Sh. Nr. 285).
- 14) Ballada e detarit (A. Sh. Nr. 265).
- 15) Fisnikët e Shqipërisë (A. Sh. Nr. 247).
- 16) Kenga e Musa Bej Qafëzezit (popullore e mbledhur nga Asdreni) (A. Sh. Nr. 228).
- 17) Gjinkalla dhe thnegla (përkthyer nga la Fontaine-i) (A. Sh. Nr. 233).
- 18) Martha (përkthim) (A. Sh. Nr. 230).
- 19) Thaisa (A. Sh. Nr. 253).
- 20) Pëllumbesha (A. Sh. Nr. 222).
- 21) Vegim nate qershori (A. SH. Nr. 272).

PÂŠQYRÂ È LENDÈS

F. J. S.

	Faqe		Faqe
— Aleksandér Stavre Drenova (Asdren) — nga Dh. Fullani	3	43) Ardhja e dimrit	103
Vjershavë të mijë	34	44) Pamje	105
Kendonj	25	45) Hymn henës	106
— Poezi patriotike dhe shoqërore		46) Mall nate	103
Vlesa e atëdhët	36	47) Dëshira ime	103
Përpara (marsh kombëtar)	36	48) Ora e zemrës	109
Betimi mi flamur (hymn patriotik)	37	49) Vegim perëndimi	110
Flamuri kombëtar	38	50) Letër prej katundit tem	111
Zëri i flamurit	39	51) Punëtori i mirë	114
Drinit	40	52) Puna	115
Ardhi dita	43	53) Nusja e mbare	116
Mjaft	44	54) Shpeset udhëtarë	117
Balashit	45	IV. — Poezi erotike	
Kënga e bashkimit	47	55) Prej katundit	119
Zani i lahatës	48	56) Shega	123
Poshitë errësira	49	57) Thëllënxa e Lekës	127
Palla e Skënderbeut	50	58) Në krua	128
Larg vatrës	52	59) Bukuria	130
Dhëmbkë	54	60) Një orë lumtësie	131
Koshtuta në Shqipëri	54	61) Ti me sy të zinj (këngë)	132
Tingllimë	59	62) Kthime	132
Tingllima	60	63) Malli i peshkëtares	133
Zëri i kryengritësve (të parave shqiptarë)	61	64) Fugja e dashurisë	133
Krerëve tradhëtarë	63	65) Dashuro	133
Çpërbëlimi	65	66) Kujtim i saj	133
Lulekuqeja	67	67) Ballada e bariut	133
Dëshmorëve të kombit	68	68) E bukur e dheut	134
Shqipëria u lirua	69	69) Tingllimë	135
Burri i dheut	69	70) Narqisi	135
Vlorës	79	71) Thaisa	137
Luftari lypës	81	V. — Motive të ndryshme	
Republika Shqiptare	83	72) Për gjah	138
Fisni kët e Shqipërisë	84	73) Qyqja	138
Trashëgimi	85	74) Fyelli	139
Të rinjve	91	75) Tingllimë	140
— Poezi për natyrën dhe punën		76) Kujtime të shkuara	141
Ditë prendvere	93	77) Kotësia	142
Prendvera	94	78) Pasqyra	144
Natyra	95	VI. — Artikuj, dokumente, kores-	
Dua	96	79) Dy tri fjale për oxhaksinë	145
erëndim dielli në verë	97	80) Parësia e Shqipërisë	145
Trandafili	98	81) Ëndër e vërtetë	147
Pamje vjeshtë	99	82) Korispondencë	147
Vjeshta	160	VII. — Pasqyrë bibliografike e poezive të Asdrenit	
Dimri	102	148	
		149	
		150	
		152	
		153	